

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS  
FAKULTETI I INXHINIERISE SE NDERTIMIT  
DEPARTAMENTI GJEODEZISË**

**COPYRIGHT**

**I**

**FITORE BAJRAMI LUBISHTANI**

**2021**

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS  
FAKULTETI I INXHINIERISE SE NDERTIMIT  
DEPARTAMENTI GJEODEZISË**

Bashkëudhëheqësit e Fitore Bajrami Lubishtanit vërtetojnë se ky është  
verzioni i miratuar i disertacionit të mëposhtëm:

**“ANALIZA E MODELEVE GLOBALE  
GJEOPOTENCIALE NË PËRCAKTIMIN E  
SIPËRFAQES REFERENTE TË LARTËSIVE PËR  
TERRITORIN E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË”**

Udhëheqësit shkencor: Prof.Asoc.Dr. Përparim AMETI

Prof.Asoc.Dr.Namik KOPLIKU

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS  
FAKULTETI I INXHINIERISE SE NDERTIMIT  
DEPARTAMENTI GJEODEZISË**

**“ANALIZA E MODELEVE GLOBALE GJEOPOTENCIALE  
NË PËRCAKTIMIN E SIPËRFAQES REFERENTE TË  
LARTËSIVE PËR TERRITORIN E REPUBLIKËS SË  
SHQIPËRISË”**

Përgatitur nga Grada e mëparshme  
Msc.Ing. Fitore BAJRAMI LUBISHTANI

Disertacioni i paraqitur në  
Fakulteti i Inxhinierisë së Ndërtimit  
Universiteti Politeknik i Tiranës  
Në përputhje të plotë  
Me kërkesat  
Për gradën Doktor

Universiteti Politeknik i Tiranës, Qershor 2021

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS  
FAKULTETI I INXHINIERISE SE NDERTIMIT  
DEPARTAMENTI GJEODEZISË**

## **DEDIKIM**

Këtë temë të doktoraturës u'a dedikoj dy prindërve të mi: Enver Bajrami dhe Shahadije Hoxha Bajrami, të cilët më motivuan dhe treguan interes të madh për punën time duke më inkurajuar të vazhdojë më tutje. Gjithashtu u'a dedikoj dy fëmijëve të mi Noar dhe Noa Lubishtani, të cilëve dua t'u kërkoj falje për mungesat e mia të shpeshta gjatë kohës kur kam qenë duke punuar në këtë disertacion dhe padyshim krahu tim të djathtë që edhe këtë rrugëtim e bë më të përbashkë Milot Lubishtanit, që më qëndroj afër dhe më motivoj për punë.

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS**  
**FAKULTETI I INXHINIERISE SE NDERTIMIT**  
**DEPARTAMENTI GJEODEZISË**

## **MIRËNJOHJE/FALËNDERIM**

Kjo temë e doktoraturës dhe hulumtimi themelor nuk do të ishin të mundshme pa ndihmën, përkrahjen dhe mbështetjen e shumë njerëzve. Së pari dua t'i falemnderoj dy bashkëudhëheqësit e mi: Prof. Asoc. Dr. Përparim Ameti dhe Prof. Asoc. Dr. Namik Kopliku, për ndihmën dhe udhëzimet e tyre gjatë periudhës së hulumtimit. Ata ishin gjithmonë në dispozicion për të më udhëzuar dhe diskutuar pavarësisht orarit të tyre të ngjeshur dhe arritën të më mbajnë në rrugën e duhur gjithashtu duke më dhënë lirinë për të ndjekur idetë e mia.

Dua t'i falemnderoj të gjithë profesorët e Departamentit të Gjeodezisë në Tiranë, së pari për mundësinë e dhënë për të filluar këtë studim të doktoraturës pranë Fakultetit të Inxhinierisë së Ndërtimit në Tiranë dhe pastaj duke më mbështetur gjatë gjithë viteve të studimit.

Gjithashtu dua t'u shpreh mirënjohje të gjithë profesorëve të Departamentit të Gjeodezisë në Prishtinë, për ndarjen e njohurive dhe komentet e tyre të vlefshme.

Natyrisht pa harruar Profesorin Reiner Jäger nga Universiteti Karlsruhe, Institut für Angewandte Forschung (IAF) në Gjermani për komentet dhe ndihmën e dhënë.

Dua ta falemnderoj Autoritetin Shtetëror për Informacion Gjeohapësinor-Drejtorinë Gjeodezisë dhe Hartografisë (ASIG) në Tiranë për ofrimin e të dhënave, të cilat janë përdorur në këtë hulumtim.

Në fund dua ta falemnderoj bashkëshortin tim Milotin, falë konsideratës dhe motivimit të vazhdueshëm për punë dhe për çfarëdolloj mbështetje që më duhej ai ishte krahu im i djathtë që të arrij këtu ku jam sot.

*Falemnderit!*

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS  
FAKULTETI I INXHINIERISE SE NDERTIMIT  
DEPARTAMENTI GJEODEZISË**

**DEKLARATË MBI ORIGJINALITETIN**

**Fitore BAJRAMI LUBISHTANI**

Deklaroj se kjo tezë përfaqëson punën time origjinale dhe nuk kam përdorur burime të tjera, përveç atyre të evidentuara nëpërmjet citimeve.

Të gjitha të dhënat, tabelat, figurat dhe citimet në tekst, të cilat janë riprodhuar prej ndonjë burimi tjetër, duke përfshirë dhe internetin, janë pranuar në mënyrë eksplicite sit ë tilla.

Jam e vetëdijshëme se në rast të mospërputhjeve, Senati i UPT-së është i ngarkuar të më revokojë gradën “Doktor”, që më është dhënë mbi bazën e kësaj teze, në përputhje me

“Rregulloren e Programeve të Ciklit të tretë (Doktoratë) në UPT”, dt.....neni 21.

Tiranë, 28.06.2021

\_\_\_\_\_

## **Tabela e përmbajtjes**

DEDIKIM .....	4
MIRËNJOHJE/FALËNDERIM .....	5
DEKLARATË MBI ORIGJINALITETIN .....	6
Lista e tabelave .....	10
Lista e figurave .....	10
Lista e diagrameve .....	13
Lista e organogrameve .....	14
Lista e shtojcave .....	14
Lista e shkurtesave .....	14
ABSTRAKT .....	16
<b>1 HYRJE.....</b>	<b>17</b>
1.1 Motivi.....	17
1.2 Objektivat e hulumtimit .....	19
1.3 Korniza konceptuale e tezës.....	19
<b>2 Historiku i ndërtimit të referencave koordinative gjeodezike në Republikën e Shqipërisë.....</b>	<b>25</b>
2.1 Të dhënat gjeodezike për Shqipërinë .....	25
2.2 Sistemi i referencës vertikale të Shqipërisë .....	40
<b>3 Fusha e gravitetit të Tokës .....</b>	<b>43</b>
3.1 Hyrje në teorinë e gravitetit .....	43
3.2 Fusha e gravitetit të Tokës .....	44
3.3 Ekuacioni themelor i gjeodezisë fizike .....	47
3.4 Potenciali i rëndesës.....	47
3.5 Sipërfaqja referente e lartësive.....	54
3.6 Niveli mesatar i detit.....	56
3.7 Sipërfaqja e elipsoidit .....	58
3.8 Sipërfaqja e gjeoidit .....	60
3.8.1 Formulimi i problemit të vlerës kufitare në sipërfaqen e Tokës .....	62

3.8.2	Vlerësimi i anomalisë së gravitetit të Helmertit .....	62
3.8.3	Vazhdimi në rënie i anomalive të gravitetit Helmert në gjeoid .....	63
3.8.4	Integrimi i Stoks-it në zgjidhjen e problemit të vlerës së kufirit .....	64
3.8.5	Shndërrimi i lartësive gjeoidale nga hapësira e Helmertit në hapësirën reale	65
3.8.6	Funksioni Stokes .....	65
3.8.7	Anomalia ajër – lirë .....	69
3.8.8	Anomalia Bouguer .....	70
3.8.9	Anomalitë e lartësive .....	73
3.9	Sipërfaqja e kuazi-gjeoidit .....	74
3.9.1	Teoria Molodensky .....	75
3.9.2	Teknika remove-restore (heqjes-rivendosjes) në përcaktimin e gjeoidit	76
3.9.3	Sipërfaqja referencë e lartësisë së elementeve të përcaktuara dixhitale (DFHRS).....	79
<b>4</b>	<b>Modelet globale gjeopotenciale.....</b>	<b>83</b>
4.1	Modelet globale gjeopotenciale .....	83
4.1.1	Modeli i Gravitetit të Tokës 1984 (EGM84) .....	83
4.1.2	Modeli i gravitetit të Tokës 1996 (EGM96) .....	84
4.1.3	Kuazi-gjeoidi i gravitetit evropian EGG97 .....	86
4.1.4	Modeli i gravitetit të Tokës 2008 (EGM08) .....	88
4.1.5	Modeli i gravitetit evropian i Tokës 6C4 (EIGEN 6c4) .....	90
<b>5</b>	<b>Shtetet rajonale në aspektin e përcaktimit të modelit të gjeoidit.....</b>	<b>91</b>
5.1	Vështrim i përgjithshëm.....	91
5.1.1	Modeli i gjeoidit për territorin e Republikës së Shqipërisë .....	91
5.1.2	Modeli i gjeoidit për territorin e Italisë.....	93
5.1.3	Modeli i gjeoidit për territorin e Greqisë .....	94
5.1.4	Modeli i gjeoidit për territorin e Maqedonisë së Veriut .....	95
5.1.5	Modeli i gjeoidit për territorin e Kosovës.....	95
5.1.6	Modeli i gjeoidit për territorin e Malit të Zi .....	96
5.1.7	Modeli i gjeoidit për territorin e Kroacisë .....	96
5.1.8	Modeli i gjeoidit për territorin e Latvisë.....	97



5.1.9	Modeli i gjeoidit për territorin e Hungarisë .....	99
5.1.10	Modeli i gjeoidit për territorin e Polonisë.....	100
<b>6</b>	<b>Modelimi i gjeoidit për territorin e Republikës së Shqipërisë sipas metodës DFHRS.....</b>	<b>100</b>
6.1	Të dhënat hyrëse, të cilat do të përdoren për adoptimin e modelit të gjeoidit	101
6.2	Modelimi i gjeoidit përmes metodës së elementeve finite (MEF).....	102
6.3	Kontrolluesi i të dhënave (ang. Data snooping).....	106
<b>7</b>	<b>Kriteret, analizat dhe rezultatet e arritura nga vëzhgimet e përzgjedhura për llogaritje .....</b>	<b>107</b>
<b>8</b>	<b>Përcaktimi i sipërfaqes referente të lartësive -modeli i gjeoidit për territorin e Republikës së Shqipërisë .....</b>	<b>116</b>
8.1	Përcaktimi i modelit të gjeoidit duke përdorur modelin global gjeopotencial EGM96.....	117
8.2	Përcaktimi i modelit të gjeoidit duke përdorur modelin global gjeopotencial EGG97 .....	118
8.3	Përcaktimi i modelit të gjeoidit duke përdorur modelin global gjeopotencial EGM2008.....	120
8.4	Përcaktimi i modelit të gjeoidit duke përdorur modelin global gjeopotencial EIGEN04.....	122
8.5	Përcaktimi i modelit të gjeoidit duke përdorur modelin global gjeopotencial EIGEN6c4.....	124
8.6	Ndërtimi i profileve nga rezultatet e arritura .....	126
8.7	Përzgjedhja definitive e modelit të gjeoidit të llogaritur me metodën DFHRS për territorin e Republikës së Shqipërisë .....	137
<b>9</b>	<b>Rezultatet dhe përfundimet .....</b>	<b>139</b>
<b>10</b>	<b>Summary.....</b>	<b>145</b>
<b>11</b>	<b>Literatura.....</b>	<b>151</b>
<b>12</b>	<b>Ueb faqet e përdorura .....</b>	<b>157</b>
<b>13</b>	<b>Shtojcat .....</b>	<b>158</b>

## **Lista e tabelave**

Tabela 2.1 Të dhënat koordinative gjeodezike nga IGUW (Nurçe, 2012): .....	26
Tabela 2.2 Të dhënat gjeodezike të kësaj reference koordinative janë (Nurçe, 2012).	28
Tabela 2.3 Të dhënat për bazën gjeodezike (Nurçe, 2012): .....	29
Tabela 2.4 Të dhënat koordinative gjeodezike nga IGUF (Nurçe, 2012).....	29
Tabela 2.5 Të dhënat gjeodezike nga ITU (Nurçe, 2012).....	34
Tabela 2.6 Parametrat e Helmertit të llogaritur për territorin e Shqipërisë (Nurçe, 2012). .....	39
Tabela 2.7 Paraqitja e pikave absolute gravimetrike në tre stacionet (ang. Absolut Gravity Measurements-Albania-Kosovo-Montenegro 2015). .....	41
Tabela 4.1 Llogaritja e modelit EGM96 për territore te ndryshme të Tokës( <a href="http://icgem.gfz-potsdam.de">http://icgem.gfz-potsdam.de</a> ) .....	85
Tabela 4.2 Llogaritja e modelit EGM2008 për territore të ndryshme të Tokës ( <a href="http://icgem.gfz-potsdam.de">http://icgem.gfz-potsdam.de</a> ).....	89
Tabela 4.3 Krahasimi i Goce dhe Champ sipas modeleve EGM2008 dhe EIGEN6C4 .....	90
Tabela 4.4 Gabimi i EIGEN6C4 sipas territoreve te caktuara.....	90
Tabela 5.1 Ndryshimi mes DFHRS dhe LV'98(Janpaule et al., 2013). .....	98
Tabela 7.1 Janë paraqitur të dhënat nga vlerat minimale dhe maksimale, mesatarja, devijmi standard dhe gabimi mesatar kuadratik për 5 modelet globale gjeopotenciale të llogaritura nga 151 vëzhgimet.....	108
Tabela 7.2 Paraqitja tabelare të vlerave minimale dhe maksimale, mesatarja, devijmi standard dhe gabimi mesatar kuadratik për 5 modelet globale gjeopotenciale të llogaritura për territorin e Republikës së Shqipërisë për 94 vëzhgime. ....	111
Tabela 7.3 Paraqitja tabelare e vlerave minimale dhe maksimale, mesatarja, devijmi standard dhe gabimi mesatar kuadratik për 5 modelet globale gjeopotenciale të llogaritura për territorin e Republikës së Shqipërisë për 98 vëzhgime. ....	115
Tabela 8.1 Vlerat minimale dhe maksimale të profileve .....	137
Tabela 8.2 Paraqitja e rezultateve nga 5 modelet globale gjeopotenciale të llogaritura .....	138

## **Lista e figurave**

Figura 1.1 Lidhja në mes të elipsoidit dhe gjeoidit.....	18
Figura 2.1. Matjet e para gjeodezike të kryera nga Perandoria Astro-Hungareze në Ballkan (Kovács & Timár, 2009).....	25
Figura 2.2. Rrjeti i Triangulacionit të rendit të I-rë sipas IGUW, 1868-98 (Nurçe, 2012) .....	26
Figura 2.3 Rrjeti i triangulacionit sipas Institutit Gjeografik Ushtarak të Vjenës (Nurçe et al., 2015) .....	27
Figura 2.4 Fragment hartë e brezit kufitar, shkalla 1: 50 000 (Nurçe, 2012) .....	27
Figura 2.5 Rrjeti i triangulacionit kufitar i rendit I, II, III sipas IGUF, 1922-25 (Nurçe, 2012) .....	28

Figura 2.6. Rrjeti i triangulacionit sipas Institutit Gjeografik Ushtarak të Firencës (Nurçe et al., 2015) .....	30
Figura 2.7. Paraqitja e rrjetit Kl.1 dhe lartësitë gjeoid-elipsoid (Nurçe, 2012) .....	31
Figura 2.8. Paraqitja e Rrjetit të Nivelimit 1930-32 & 1950-52 (Nurçe, 2012) .....	32
Figura 2.9. Rrjeti i Triangulacionit (majtas) dhe Nivelacionit shtetëror (djathtas) sipas IGUSH, 1970-1986 .....	33
Figura 2.10. Fushatat e matjeve satelitore në Shqipëri: 1994, 1998, 2002 (Nurçe, 2012) .....	35
Figura 2.11. Rrjeti kryesor RDN dhe dendësues RSN (Nurçe et al., 2015) .....	36
Figura 2.12. Përzgjedhja e zonës elipsoidike ndërmjet paraleleve dhe meridianeve për territorin shqiptar (Nurçe, 2012) .....	37
Figura 2.13. Paraqitja e lartësive elipsoid Gjeoid NEGM2008-GRS80 (Nurçe, 2012) .....	37
Figura 2.14. Diferencat ndërmjet (ETRF2000-ALB86) në gjerësi (majtas) dhe në gjatësi (djathtas) (Nurçe, 2012).....	38
Figura 2.15. Stacionet permanente të ALBPOS (Nurçe et al., 2015) .....	40
Figura 2.16. Rrjeti gravimetrik i Shqipërisë (Nurçe et al., 2015) .....	41
Figura 2.17. Paraqitja grafike e stacioneve gravimetrike në Republikën e Shqipërisë .....	42
Figura 3.1 Graviteti (Torge & Muller, 2012).....	44
Figura 3.2 Fuqia e fushës mbi sipërfaqen e Tokës (Cooper, 2002) .....	45
Figura 3.3 Grafiku i fushës së gravitetit (Cooper, 2002) .....	45
Figura 3.4 Sipërfaqet e nivelit dhe linjat pingule (Heiskanen & Moritz, 1967) .....	46
Figura 3.5 Forca centrifugale (Heiskanen & Moritz, 1967) .....	48
Figura 3.6 Koordinatat gjeocentrike dhe elipsoidale .....	49
Figura 3.7 Lartësia gjeoidale dhe anomalitë e lartësive (Ameti, 2006) .....	50
Figura 3.8 Gjeoidi dhe elipsoidi referent (Heiskanen & Moritz, 1967).....	52
Figura 3.9 Zgjerimi në harmonika sferike (Heiskanen & Moritz, 1967).....	53
Figura 3.10 Gjeoidi, niveli mesatar i detit, topografia kontinentale dhe sipërfaqja e detit (Torge, 2001) .....	56
Figura 3.11 Sipërfaqja e Tokës dhe dy sipërfaqet referente të përdorura për ta përafuar atë: gjeoidin dhe një elipsoid referimi. Devijimi midis gjeoidit dhe një elipsoidi referent quhet ndarje gjeoidale (N).(Knippers, 2009).....	56
Figura 3.12 Përdorimi i matësve të valës për monitorim të sipërfaqes së detit (Jason-2r, 2008).....	57
Figura 3.13 Përdorimi i altimetrisë satelitore për monitorim të sipërfaqes së detit (Jason-2r, 2008) .....	57
Figura 3.14 Elipsoidi referent dhe koordinatat gjeodezike (Moritz, 1980) .....	58
Figura 3.15 Lartësia ortometrike H (Moritz, 1980). .....	61
Figura 3.16 Valëzimi i gjeoidit në lidhje me elipsoidin referent (Dantor, 2006). .....	62
Figura 3.17 Elipsoid referencë dhe sfera e njësive(Moritz, 1980).....	66
Figura 3.18 Funkzioni origjinal dhe i modifikuar i Stokes (Torge, 2001).....	67
Figura 3.19 Gjeoid dhe bashkë-gjeoidi (Torge, 2001).....	68
Figura 3.20 Sasitë në hapësirën reale dhe në hapësirën e Helmertit (Tenzer & Janak, 2002) .....	69
Figura 3.21 Reduktimi i gravitetit (Heiskanen & Moritz, 1967) .....	70
Figura 3.22 Pllaka Bouguer (Heiskanen & Moritz, 1967).....	71
Figura 3.23 Korrigjimi i terrenit (Heiskanen & Moritz, 1967).....	72

Figura 3.24 Raporti në mes të elipsoidit, gjeoidit dhe anomalisë së lartësive $\zeta$ (Barthelmes, 2009).....	74
Figura 3.25 Pasqyrimi i topografisë sipas kuazi-gjeoidit (Heiskanen & Moritz, 1967). .....	74
Figura 3.26 Paraqitja e kuazi-gjeoidit, gjeoidin dhe elipsoidin(Tenzer& Foroughi, 2018) .....	75
Figura 3.27 Skema e heqjes-rivendosjes për llogaritjen e gjeoidit (Ameti, 2006) .....	78
Figura 3.28 Lidhja midis lartësisë ortometrike H, lartësive elipsoide h valëzimit të gjeoidit N (dfhbf). .....	80
Figura 3.29 Dizajni i llogaritjes së DFHRS_DB: FEM-Meshes (linja të hollë blu), pjesë (linja të trasha blu) dhe pika montimi (B, L, h   H) (trekëndëshat e gjelbër) (www.dfhbf.de/).....	81
Figura 3.30 Polinomet HRS N (p) në rrjete të vetme (shiko gjithashtu Figura 3.29) dhe si pjesë e një HRS të vazhdueshëm në një zonë arbitrare të madhe (www.dfhbf.de/)	82
Figura 4.1 Modeli gravimetrik i Tokës EGM96.( <a href="http://cddis.nasa.gov/926/egm96/egm96.html">http://cddis.nasa.gov/926/egm96/egm96.html</a> ) .....	84
Figura 4.2 Modeli gravimetrik i Tokës EGM96 sipas ndarjes 15' ( <a href="https://earth-info.nga.mil/GandG/wgs84/gravitymod/">https://earth-info.nga.mil/GandG/wgs84/gravitymod/</a> ).....	85
Figura 4.3 Modeli gravimetrik i Tokës EGM96 sipas ndarjes 30' ( <a href="https://cddis.nasa.gov/926/egm96/egm96.html">https://cddis.nasa.gov/926/egm96/egm96.html</a> ).....	86
Figura 4.4 Modeli i evropian gravimetrik i kuazigjeoidit EGG97. ( <a href="http://www.igik.edu.pl/pl/geodezja-i-geodynamika-modele-geoidy1">http://www.igik.edu.pl/pl/geodezja-i-geodynamika-modele-geoidy1</a> ). .....	87
Figura 4.5 EGM2008 me rezolucion 2.5 minuta (EGM2008-NGA <a href="https://earth-info.nga.mil/GandG///wgs84/gravitymod/egm2008/egm08_wgs84.html">https://earth-info.nga.mil/GandG///wgs84/gravitymod/egm2008/egm08_wgs84.html</a> ).....	88
Figura 4.6 Paraqitja gjeografike e disa prej karakteristikave të zonës 5 harkut-minutë nënkupton anomalitë e gravitetit në skedarin e shkrirë të përdorur për zhvillimin e modelit EGM2008: (a) Disponueshmëria e të dhënave. (b) Identifikimi i burimit të të dhënave. ( <a href="https://agupubs.onlinelibrary.wiley.com/doi/10.1029/2011JB008916">https://agupubs.onlinelibrary.wiley.com/doi/10.1029/2011JB008916</a> ).....	89
Figura 5.1 Majtas: Dizajni i Patching dhe Meshing për Shqipërinë. Djathtas, vijat e izohipseve të gjeoidit të përputhshëm me RTCM (1-5) cm për Shqipërinë (Owusu-Banahene, 2013). .....	91
Figura 5.2 Mbetjen në kuotë (Asig& Krgjsh, 2015).....	92
Figura 5.3 Grafiku i ndarjeve në kurben e vlerave të barabarta të lartësive gjeoid elipsoid(Asig & Krgjsh, 2015).....	93
Figura 5.4 Geoid italian i lëshuar në vitin 2009 (ITG2009) (Corchete, 2010). .....	94
Figura 5.5 GreekGeoid2010. ( <a href="https://www.isgeoid.polimi.it/Geoid/Europe/Greece/greece_g.html">https://www.isgeoid.polimi.it/Geoid/Europe/Greece/greece_g.html</a> ).....	95
Figura 5.6 Përcaktimi i modelit përfundimtar gjeoid i Kosovës nga koncepti DFHRS (Ameti & Jager, 2016). .....	96
Figura 5.7 Modeli i ri gjeoid me rezolucion të lartë HRG2009(Bašić & Bjelotomic, 2014). .....	97
Figura 5.8 Projektimi i llogaritjes për Letoninë DFHRS-DB(Janpaule et al., 2013)...	98
Figura 5.9 Diferenca midis tretjes LV'98 dhe DFHRS(Janpaule et al., 2013).....	98
Figura 5.10 Llogaritjet modeli gjeoid EGM2008 (Corchete, 2013). .....	99
Figura 5.11 Gjeoidi Gravimetrik Hungarez i lëshuar në 2013 (HGG2013). (Corchete, 2013). .....	99
Figura 5.12 Modeli gjeoid gravimetric I përcaktuar (në m). .....	100

Figura 6.1 Territori i Republikës së Shqipërisë me Shtetet në rajon (cia.gov/the-world-factbook)(The World Factbook 2020. Washington, DC: Central Intelligence Agency, 2020).	101
Figura 6.2 Rrjeti statik RGN (ASIG & KRGJSH, 2015).....	102
Figura 6.3w-test (Kontrollues i të dhënave) .....	107
Figura 7.1 Paraqitja e 151 vëzhgimeve të ndara në rrjeta të rregullta 5kmx5km dhe paraqitja e krijimit të 9 grupeve/regjioneve .....	109
Figura 7.2 Modeli i llogaritur nga 94 vëzhgime të përzgjedhura për llogaritje.....	112
Figura 7.3 Me ngjyrë të kaltër paraqitet integriti i 5 vëzhgimeve të cilat ishin eliminuar nga shpërndarja e gabimit dhe me ngjyrë vjollcë paraqitet largimi i një pike e cila rrit gabimet e vëzhgimeve fqinje.....	114
Figura 8.1 Paraqitja grafike e 98 vëzhgimeve në softuerin DFHRS të ndara në rrjetin e rregullt 5kmx5km dhe ndarja e regjioneve/ grupeve .....	116
Figura 8.2 Ndërtimi i hartës me të dhëna nga modeli global gjeopotencial EGM96 për territorin e Shqipërisë.....	118
Figura 8.3 Ndërtimi i hartës me të dhëna nga modeli global gjeopotencial EGG97 për territorin e Shqipërisë.....	120
Figura 8.4 Ndërtimi i hartës me të dhëna nga modeli global gjeopotencial EGM2008 për territorin e Shqipërisë.....	122
Figura 8.5 Ndërtimi i hartës me të dhëna nga modeli global gjeopotencial EIGEN04 për territorin e Shqipërisë.....	124
Figura 8.6 Ndërtimi i hartës me të dhëna nga modeli global gjeopotencial EIGEN6c4 për territorin e Shqipërisë.....	126
Figura 8.7 Paraqitja grafike e ndërtimit të hartës së profileve .....	127
Figura 9.1 Paraqitja e 98 vëzhgimeve të përdorura për llogaritje të modelit të gjeoidit të Shqipërisë.....	141
Figura 9.2 Paraqitja e vizuele e rezultateve të arritura ndërmejt modelit EGM2008 dhe EIGEN6c4.....	143

## **Lista e diagrameve**

Diagrami 7.1 Paraqitja grafike e devijimit standard në njësinë cm për 5 modelet e përdorura në llogaritje nga 151 vëzhgime. ....	108
Diagrami 7.2 Paraqitja grafike e devijimit standard në njësinë cm për 5 modelet e përdorura në llogaritje.....	111
Diagrami 7.3 Paraqitja grafike e devijimit standard në njësinë cm për 5 modelet e përdorura në llogaritje.....	115
Diagrami 8.1 Paraqitja e lartësive gjeoidale $N_{EGM96}$ .....	117
Diagrami 8.2 Paraqitja e lartësive gjeoidale $N_{EGG97}$ .....	119
Diagrami 8.3 Paraqitja e lartësive gjeoidale $N_{EGM2008}$ .....	121
Diagrami 8.4 Paraqitja e lartësive gjeoidale $N_{EIGEN04}$ .....	123
Diagrami 8.5 Paraqitja e vlerave të Lartësive gjeoidale $N_{EIGEN6C4}$ .....	125

Diagrami 8.6 Paraqitja e profileve dhe modelet digjitale të terrenit për të gjitha profilet duke filluar nga gjerësia gjeografike 42.45 <sup>0</sup> deri në shtrirjen e fundit të profilit që përfshinë gjerësinë gjeografike 39.90 <sup>0</sup> .....	127
Diagrami 9.1 Paraqitja e rezultateve ndërmejt modelit EGM2008 dhe EIGEN6c4..	142

## **Lista e organogrameve**

Organogrami 1.1 Korniza konceptuale .....	24
Organogrami 9.1 Aplikimi i 151 vëzhgimeve .....	145

## **Lista e shtojcave**

Shtojca 13.1 Me poshtë jepen koordinatat përfundimtare të të gjitha 151 pikave të përcaktuara, me treguesit e rrjetit të nisjes. Në shtojcën 13.1 janë hedhur koordinatat në sistemin ETRF2000, vlerat me të zeza ju referohen pikave që i përkasin rrjetit RDN (dinamik), të tjerat rrjetit RGN (Relacion i ASIG-ut, 2015).....	158
Shtojca 13.2 Janë përmbledhur koordinatat e të gjitha 151 pikave në sistemin Lokal ALB86, vlerat në sfond të kaltërt janë marrë nëpërmjet rrjetës, të tjerat janë përcaktuar me metodologjinë klasike dhe i përkasin katalogut zyrtar shqiptar(Relacion i ASIG-ut, 2015). .....	163
Shtojca 13.3 Përmbledhja e rezultateve të llogaritura nga 98 vëzhgimet për 5 modelet globale gjeopotenciale të përdorura EGM96, EGG97, EGM2008, EIGEN04 dhe EIGEN6C4 me metodën DFHRS në përcaktimin e Sipërfaqes Referente të Lartësive-modeli i gjeoidit. ....	168
Shtojca 13.4 Përmbledhja e rezultateve nga profilet e llogaritura për 5 modelet globale gjeopotenciale. ....	171

## **Lista e shkurtesave**

IGUW (Instituti Gjeografik Ushtarak i Vienës)  
IGUF (Instituti Gjeografik Ushtarak i Firencës)  
NGA ose NIMA (Agjencia Kombëtare e Inteligjencës Gjeohapësinore e SHBA)  
ASIG (Autoriteti Shtetëror për Informacion Gjeohapësinor)  
ALB86 (Referencë lokale koordinative)  
ITRF96 (Referencë globale koordinative)  
ITRF2005 (Sistemi Ndërkombëtar i Referencës Tokësore 2005)  
ITRF2000 (Korniza Ndërkombëtare e Referencës Tokësore 2000)  
ETRF2008 (Sistemi Ndërkombëtar i Referencës Tokësore 2008)  
ETRS89 (Sistemi Evropian i Referencës Tokësore 1989)  
ETRF2000 (Sistemi Ndërkombëtar i Referencës Tokësore 2000)  
WGS84 (Sistemi Gjeodezik Botëror 1984)

GPS (Sistemi i Pozicionimit GPS)  
GNSS (Sistemi satelitor global i navigimit)  
ZRPP (Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme)  
ALBPOS(Sistemi satelitor i pozicionimit Shqiptar-Albanian Positioning Satellite Service)  
RDN(Rrjeti dinamik)  
RGN (Rrjeti statik)  
HALB86 (Lartësia gjeoide lokale)  
BKG (Bundesamt für Kartographie und Geodäsie)  
IFE (Instituti për gjeodezi, Hanover )  
GRS80 (Sipërfaqja Globale referente)  
EGM84 (Modeli gjeopotencial i Tokës 1984)  
EGM96 (Modeli gjeopotencial i Tokës 1996)  
EGM2008 (Modeli gjeopotencial i Tokës 2008)  
EGG97 (Modeli i gjeoidit dhe kuazigjeoidit gravimetrik evropian 1997)  
EIGEN (Modelit gravimetrik evropian i Tokës)  
GRACE (Rigjenerimi i gravitetit dhe eksperimenti i klimës)  
CHAMP (Sfidimi i ngarkesës minimale satelitore)  
GOCE (Gravity field and steady-state ocean circulation Explorer)  
LAGEOS ( Laser Geometric Environmental Observation Survey)  
SLR (Satellite Laser Ranging)  
IERS (International Earth Rotation Service- Shërbimi Ndërkombëtar i Rotacionit të Tokës)  
DTM (Modeli dixhital i terrenit)  
DFHRS(Sipërfaqja e referencës së lartësisë së elementeve të përcaktuar dixhitale)  
HRS (Sipërfaqja referimit të lartësisë)  
MEF (Metoda e elementeve finite)  
EGGP (European Gravity and Geoid Projekt)

## **ABSTRAKT**

*Përcaktimi i sipërfaqes referente të lartësive -modeli i gjeoidit ka një rëndësi shumë të madhe për zhvillimin e detyrave të ndryshme gjeodezike në kuadër të një shteti. Duke u nis nga kjo, njëra nga detyrat kryesore të gjeodezisë është përcaktimi i gjeoidit, i cili përcaktohet si një sipërfaqe ekuipotenciale e fushës së gravitetit të Tokës, e cila përkon mesatarisht me nivelin mesatar të detit.*

*Në këtë studim, me qëllim të përcaktimit të sipërfaqes referente të lartësive (SRL), është përdorur metoda DFHRS (Digital Finite Element Height Reference Surface)(www.dfhb.de), e zhvilluar nga Universiteti i Shkencave të Zbatuara të Karlsruhe, Fakulteti i Gjeomatikës (Jäger, 1999). Baza e të dhënave e përdorur për llogaritje, përbëhet nga pikat me koordinata tredimensionale të përcaktuara me matje GPS në ETRF2000, si dhe lartësinë e përcaktuar me nivelim të saktë. Fokusi kryesor i këtij studimi është vendosur në llogaritjen e modelit më të përshtatshëm të gjeoidit për territorin e Shqipërisë duke përdorur 5 (pesë) modele globale gjeopotenciale (EGM96, EGG97, EGM2008, EIGEN04, EIGEN6c4).*

*Gjeoidi i parë i llogaritur me një precizitet shumë të lartë ( saktësi centimetri) për territorin e Republikës së Shqipërisë paraqitet në kuadër të kësaj teme të doktoraturës. Në përllogaritje të sipërfaqes referente të lartësive-modeli i gjeoidit janë përdorur 151 pika të rrjetit GPS dhe rrjetit të nivelimit.*

*Pas përfundimit të llogaritjeve është bërë analiza e rezultateve të nxjerra nga modelet globale gjeopotenciale të lartcekura, për të cilat janë ndërtuar diagrame, harta dhe profile. Pas nxjerrjes dhe analizimit të rezultateve dhe krahasimit të modeleve ndërmjet vete është bërë përzgjedhja e modelit EIGEN6c4 si modeli më i përshtatshëm për territorin e Shqipërisë. Ky model ka shpërndarje topografike dhe përshtatet mjaft mirë në territorin e Republikës së Shqipërisë. Sipërfaqja referente e lartësive (SRL) vlerësohet mjaft e saktë dhe mund të përdoret si një model referimi për lartësi në sistemin e pozicionimit të Shqipërisë (ALBPOS).*

**Fjalë kyçe:** *Sipërfaqja referente e lartësive, elipsoidi, gjeoidi, modelet globale gjeopotenciale, EGM96, EGG97, EGM2008, EIGEN04, EIGEN6c4, metoda DFHRS, Republika e Shqipërisë.*



# 1 HYRJE

Një nga detyrat kryesore të gjeodezisë është përcaktimi i gjeoidit, i cili përcaktohet si një sipërfaqe ekuipotenciale e fushës së gravitetit të Tokës, që përkon mesatarisht me nivelin mesatar të detit. Shumë metoda të ndryshme për përcaktimin e gjeoidit janë propozuar ndër vite. Secila metodë përdor teknikën dhe ka përmbajtjen e saj. Qëllimi i përbashkët i të gjithave metodave të propozuara është përcaktimi i një modeli të gjeoidit me saktësi të lartë (centimetrike). Një model gjeoidi me saktësi të lartë kërkon të dhëna të sakta dhe të dendura. Përcaktimi, shfrytëzimi dhe posedimi i një modeli të gjeoidit me saktësi të lartë dhe të saktë, është një domosdoshmëri në disa gjeo-shkenca.

Në gjeodezi, inxhinieri dhe në fusha të ngjashme është i nevojshëm përcaktimi i koordinatave me saktësi të lartë, për këtë arsye teknologjia GNSS luan një rol të rëndësishëm. Transformimi i lartësive elipsoidale GNSS në lartësi ortometrike ose në lartësi normale kërkon një model gjeoidi me saktësi të lartë dhe të saktë. Kështuqë, një nga qëllimet kryesore të gjeodezisë është të zhvillojë një model gjeoidi, i cili më pas mund të përdoret për llogaritjen e lartësive ortometrike.

Qasja e propozuar në këtë hulumtim është zbatuar me sukses dhe rezultatet janë krahasuar me lartësitë aktuale normale dhe në profilet e zgjedhura të sipërfaqes referuese të ngritjes dixhitale të llogaritur nga rrjeti kombëtar i kontrollit. Vëmendje e veçantë i është kushtuar zgjedhjes së modelit global gjeopotencial dhe përgjedhjes së vëzhgimeve, të cilat do të marrin pjesë në llogaritjen e modelit të gjeoidit për aplikim të mëtutjeshëm.


Baza e këtij hulumtimi ishte përcaktimi i sipërfaqes referente të lartësive, krijimi i modelit të gjeoidit për territorin e Republikës së Shqipërisë, gjithashtu edhe analizimi i modelit të gjeoidit për sipërfaqen e përzgjedhur në mënyrë arbitrare. Llogaritja e modelit të gjeoidit me saktësi të lartë është një detyrë e vështirë, e cila kërkon kujdes të veçantë dhe hulumtim të plotë në të gjitha fazat e llogaritjes, në mënyrë që të prodhojë rezultate sa më të mira.

Sipërfaqja referente e lartësive konsiderohet mjaft e saktë me një përputhje maksimale me territorin përkatës dhe mund të përdoret si model referimi për lartësi në sistemin e pozicionimit të Shqipërisë (ALBPOS).

## 1.1 Motivi

Fjala lartësi nuk ka kuptim të veçantë. Në mënyrë ideale, lartësia kuptimplotë fizike duhet t'i referohet gjeoidit që është një sipërfaqe ekuipotenciale e fushës së gravitetit të Tokës dhe përafrohet me nivelin mesatar të detit. Duke qenë një sipërfaqe ekuipotenciale, gjeoidi është një sipërfaqe në të cilën forca e gravitetit është kudo pingul. Sipas C.F. Gauss, i cili e përshkroi gjeoidin për herë të parë si, "është figura matematikore e Tokës" (ang. It is the mathematical figure of the Earth), një sipërfaqe e lëmuar por e parregullt që nuk korrespondon me sipërfaqen aktuale të kores së Tokës, por me një sipërfaqe, e cila mund të dihet vetëm përmes matjeve dhe llogaritjeve të

gjera gravitacionale. Shpesh përshkruhet si figura e vërtetë fizike e Tokës, në kontrast me figurën e idealizuar gjeometrike të një elipsoidi referimi. Në mënyrë praktike, është shumë e vështirë të vendoset një sipërfaqe e tillë për shkak të ndërlikimeve të përfshira. Por në të gjitha projektet e zhvillimit dhe inxhinierisë, kërkohen lartësi të bazuara në nivelin mesatar të detit, siç edhe shihet në figurën 1.1. Lartësitë që rezultojnë nga përpunimi i të dhënave GNSS quhen lartësi elipsoidale ( $h$ ). Kjo gjë ka krijuar një dëshirë të ngutshme për një përcaktim po aq të shpejtë dhe të saktë të lartësive ortometrike ( $H$ ). Detyra e shndërrimit të lartësisë elipsoidale ( $h$ ) të marrë nga pozicionimi GNSS në lartësinë ortometrike ( $H$ ), ka shtyrë gjeodetët në të gjithë botën të përcaktojnë modelin e gjeoidit me një saktësi dhe precizitet të lartë.



**Figura 1.1 Lidhja në mes të elipsoidit dhe gjeoidit**

Gjatë dekadës së fundit, nevoja për model të saktë gjeoidi ka fituar vulltin për të minimizuar/eliminuar detyrën e mundimshme, që kërkon kohë për realizim të nivelimit. Në mënyrë që të bëhet shndërrimi nga lartësitë elipsoide në lartësitë ortometrike, duhet të llogaritet një model i gjeoidit.

Kohët e fundit jemi dëshmitarë të një progresi të madh që po bëhet në cilësinë dhe zgjedhjen e modeleve globale gjeopotenciale me qëllim të vetëm përcaktimin e një modeli të gjeoidit. Krijimi dhe zhvillimi i modeleve globale gjeopotenciale me cilësi të lartë, si funksione matematikore që përafrojnë fushën e gravitetit të Tokës në hapësirën 3D, është shumë i rëndësishme në shumë aspekte. Këto modele mund të konsiderohen si një referencë për vetë gjeodezinë (Barthelmes, 2014), ndër të tjera edhe sigurojnë mundësinë e llogaritjes së lartësive ortometrike dhe ndryshimeve në lartësi në kombinim me pozicionimin GNSS (Pavlis et al., 2012). Ekziston gjithashtu një mundësi që në të ardhmen të kemi një model unik global gjeoidal i nxjerrë/marrë nga një model global gjeopotencial me saktësi të lartë dhe me rezolucion të lartë, që mund të shërbejë si një sipërfaqe referimi për krijimin dhe realizimin e një të dhëne globale vertikale (Balasubramania, 1994; Schwarz et al., 1987; Ihde & Sanchez, 2005). Gjeodezia përballet me një detyrë të rëndësishme për të siguruar modelin global gjeopotencial dhe të gjitha produktet e tij. Një nga produktet e modeleve globale gjeopotenciale është gjeoidi, i cili zakonisht shpërndahet në formë të një modeli. Shumë vende në të gjithë botën tashmë e kanë zhvilluar modelin e tyre të gjeoidit, i cili shërben si mjet për nxjerrjen e lartësive ortometrike nga vëzhgimet GNSS.

Mbi bazë të të gjithave të përmendura më lartë, ekziston një nevojë e qartë për llogaritjen e një modeli të gjeoidit edhe Shqipërinë me qëllim që të bëhet i mundshëm shndërrimi i lartësive elipsoidale në lartësi ortometrike, që do të mund të shërbente për punë dhe nevoja të tjera në kuadër të shkencës së gjeodezisë.

## **1.2 Objektivat e hulumtimit**

Sistemi GNSS është themeluar si mjet kryesor gjeodezik në shumicën e aktiviteteve gjeodezike. Objektivi kryesor i praktikës dhe shkencës gjeodezike ka qenë gjithmonë një saktësi e lartë dhe besueshmëri e të dhënave me shpenzime minimale të kostos. Përgjigjja ndaj këtyre aspiratave është zgjidhur duke përdorur sistemin GNSS. Me kombinimin e matjeve të diferencës së lartësive dhe matjeve të gravitetit, është e mundur që të përfitohen vlerat përfundimtare të lartësive që janë të njohur si lartësi ortometrike dhe janë të lidhura me sipërfaqen e nivelit zero (nivelit të detit).

Duke u nisur nga kjo kërkesë është paraqitur nevoja që të kemi një model të gjeoidit dhe ky do të jetë objektivi kryesor i këtij hulumtimi: përcaktimi i një sipërfaqeje zero të lartësive (modeli gjeoidit) duke përdorur modelet globale gjeopotenciale dhe të dhëna të tjera tokësore në dispozicion, kryesisht nga GPS dhe nivelimi i saktë. Metoda e zgjedhur është quajtur metoda e Sipërfaqes Referencë të Lartësive të Elementeve Finite Dixhitale (DFHRS). Kjo qasje është e bazuar në modelimin parametrik dhe llogaritjen e sipërfaqes referente të lartësive (SRL) nga komponentët gjeometrikë dhe fizikë të vëzhgimit në një qasje të përshtatjes hibride (ang. hybrid). Qasja në modelin parametrik SRL është mundësuar nga bazat e të dhënave të metodës DFHRS, të cilat lejojnë shndërrimin e drejtpërdrejtë të lartësive GNSS (elipsoidale) në lartësi fizike (ortometrike, normale). Bazat e të dhënave të DFHRS-së si të tilla mund të përdoren për matje të lartësive (ang. GNSS online) në rrjetet CORS (Jäger et al., 2006) duke i lejuar përdoruesit për të marrë lartësi normale gjatë matjes në kohë reale.

Objektivi kryesor i këtij disertacioni ka qenë të zhvillojë një qasje të integruar për llogaritjen e sipërfaqes referente së lartësive (SLR) në kontekstin e pozicionimit të GNSS. Për këtë qëllim, është përdorur metoda DFHRS (ang. Digital Reference Element Height Reference Surface), duke lejuar përdorimin e vëzhgimeve fizike përveç llojeve të vëzhgimeve gjeometrike. Metoda DFHRS përdor një gamë të gjerë të të dhënave hyrëse (gjeometrike dhe fizike) dhe në rastin tonë kishte 151 të dhëna me lartësi GPS/nivelim, si dhe derivate fizike nga modelet e ndryshme globale gjeopotenciale, që në rastin e Shqipërisë janë përdorur për testim modelet globale EGM96, EGG97, EGM2008, EIGEN04 dhe EIGEN6c4. Të dhënat e përcaktuara janë ofruar si rezultat i llogaritjeve, por edhe eksperimenteve të shumta që është kërkimi i të dhënave përsëritëse (ang. SNOOPING ITERATIVE DATA). Kjo metodë është përdorur për të përcaktuar sipërfaqen referente të lartësive, me qëllim të definimit të saj si Datum Kombëtar Vertikal, dhe shndërrimit të lartësive elipsoidale të përcaktuara nga GPS në lartësi ortometrike, të cilat i referohen sipërfaqes referente të lartësive (SRL) dhe të njëjtat mund të përdoren për qëllime të ndryshme gjeodezike apo hartografike.

## **1.3 Korniza konceptuale e tezës**

Hulumtimi i kësaj teze të doktoratës është i ndarë në 8 kapituj të cilat përshkruhen shkurtimisht në skicën e tezës, në të cilën tregohen se si janë të lidhur kapitujt njëra me

tjetrën. Gjithashtu është dhënë edhe paraqitja grafike e kornizës konceptuale të tezës, e cila është e vendosur në organogramin 1.1.

## Kapitulli 1 – Historiku i ndërtimit të referencave të koordinatave gjeodezike në Republikën e Shqipërisë

Historia e ndërtimit të referencave të koordinatave gjeodezike që datojnë nga shekulli XIX të përpiluara nga Perandoria Astro-Hungareze e deri te ndërtimi i referencave të koordinatave gjeodezike, të cilat përdoren në ditët e sotme. Gjithashtu është bërë edhe një përshkrim i sistemit të referencës vertikale të Shqipërisë.

## Kapitulli 2 – Fusha e gravitetit të Tokës

Për arritjen e rezultateve përfundimtare duhet të kalohen disa procedura bazë. Kapitulli i dytë është ndarë dhe është shtjelluar se si ndikon fusha e gravitetit të Tokës. Në nënseksionin e parë është shtjelluar teoria e gravitetit dhe cilat problematika duhet të trajtohen edhe si vlera të gravitetit, që ndikojnë në llogaritjen e masës së densitetit mesatar të Tokës. Në nënseksionin e dytë paraqitet fusha e gravitetit të Tokës, ku gravitetin e shënojmë me  $g$ , pastaj është bërë paraqitja se si fusha paraqet një hapësirë ku ne mund të zbulojmë një forcë. Në vazhdim paraqitet vektori i gravitetit se si ndikon në masë, dhe po ashtu ndikimi i linjës pingule. Në nënseksionin e tretë është bërë paraqitja e ekuacionit themelor të gjeodezisë fizike. Në nënseksionin e katërt është paraqitur potenciali i rëndesës dhe ndikimi i forcës së gravitetit dhe forcës centrifugale, pastaj është paraqitur valëzimi i gjeoidit dhe arritja deri tek anomalia e gravitetit. Në nënseksionin e pestë është sipërfaqja referente e lartësive, e cila përcaktohet me ndonjë model gjeopotencial, po ashtu bëhet paraqitja edhe e gravitetit teorik, i cili bazohet në një elipsoid të revolucionit, ku elipsoidi paraqet sipërfaqe tjetër të referencës. Në nënseksionin e gjashtë paraqitet niveli mesatar i detit dhe matësit e nivelit të detit, si dhe llojet, të cilat përdoren për matje. Në nënseksionin e shtatë paraqitet sipërfaqja e elipsoidit. Në nënseksionin e tetë paraqitet sipërfaqja e gjeoidit, e cila përfshin formulimin e problemit të vlerës kufitare në sipërfaqen e Tokës, vlerësimin e anomalisë së gravitetit të Helmertit, vazhdimi në rënie i anomalive të gravitetit Helmert në gjeoid, integrimi i Stoks-it në zgjidhjen e problemit të vlerës së kufirit, shndërrimin e lartësive gjeoidale nga hapësira e Helmertit në hapësirën reale, funksioni i Stokes, anomalia ajër – lirë, anomalia Bouguer dhe anomalitë e lartësive. Në nënseksionin e nëntë paraqitet sipërfaqja e kuazi-gjeoidit, e cila përfshin teorinë Molodensky, teknikën (ang. Remove-restore) heq-rivendos në përcaktimin e gjeoidit, sipërfaqen e referencës së lartësive të elementeve të përcaktuar dixhitale DFHRS.

## Kapitulli 3 – Modelet globale gjeopotenciale

Ky seksion paraqet modelet globale gjeopotenciale, metodat e matjeve dhe teknikave të zgjidhjes. Modelet globale janë zhvilluar në masë të madhe dhe janë gjithnjë e më të sakta, të cilët kanë gjetur përdorim të gjerë në zgjidhjen dhe përcaktimin e modelit të gjeoidit të një vendi. Në Botë janë të njohura disa modele globale gjeopotenciale, të cilat përdorin të dhëna tokësore, këto modele i kemi përdorur gjatë llogaritjes për territorin e Shqipërisë siç janë: Modeli i gravitetit të Tokës 1984 (EGM84), Modeli i gravitetit të Tokës 1996 (EGM96), Kuazi-gjeoidi i gravitetit evropian EGG97, Modeli i gravitetit të Tokës 2008 (EGM08), Modelit gravimetrik evropian i Tokës 04 (EIGEN 04), Modeli i gravitetit evropian i Tokës 6c4 (EIGEN 6c4).

#### Kapitulli 4 – Shtetet rajonale në aspektin e përcaktimit të modelit të gjeoidit

Në këtë seksion paraqitet një pasqyrë e shkurtër e përcaktimit të modelit të gjeoidit për territoret fqinje të Shqipërisë dhe më gjerë, si dhe paraqitjen e gjendjes së tanishme të Shqipërisë në aspektin e përcaktimit të modelit të gjeoidit. Gjithashtu vëmendje të veçantë i është kushtuar metodave të përdorura si dhe saktësisë së arritur për modelin e përzgjedhur.

#### Kapitulli 5 – Modelimi i gjeoidit për territorin e Republikës së Shqipërisë sipas metodës DFHRS

Në seksionin e parë paraqiten të dhënat hyrëse, të cilat do të përdoren për adoptimin e modelit të gjeoidit për të vazhduar me seksionin e dytë për modelimin e gjeoidit përmes metodës së elementeve finite (MEF) dhe kërkuesi i të dhënave të përsëritura (ang. Snooping Iterative Data).

#### Kapitulli 6 – Kriteret, analizat dhe rezultatet e arritura nga vëzhgimet e përzgjedhura për llogaritje


Në këtë seksion paraqiten kriteret e parashtruara dhe metodat e përdorura me qëllim të përcaktimit të vëzhgimeve të cilat do të marrin pjesë në testimin e 5 modeleve globale gjeopotenciale. Gjithashtu janë ndërtuar harta dhe diagrame për testimet e realizuara, të cilat janë të shoqëruara edhe me llogaritjen e devijimit standard dhe vlerave minimale dhe maksimale për modelet e testuara


#### Kapitulli 7 – Përcaktimi i modelit të gjeoidit më të përshtatshëm për territorin e Republikës së Shqipërisë


Në këtë seksion janë paraqitur të dhënat detaje për 5 modelet globale gjeopotenciale të përdorura. Është bërë përshkrimi veç e veç i 5 modeleve, si dhe janë paraqitur hartat dhe diagramet për secilin model global gjeopotencial. Gjithashtu është paraqitur edhe ndërtimi i profileve nga rezultatet e arritura. Profilet janë ndërtuar me një shtrirje të gjerësisë gjeografike çdo  $15^0$ , nga të cilat na kanë rezultuar gjithsej 18 profile me të dhënat e të gjitha modeleve të llogaritura si dhe paraqitjen e diagrameve. Dhe në fund, në bazë të rezultateve të arritura dhe analizave të bëra në kuadër të këtij kapitulli, është bërë përzgjedhja e modelit të gjeoidit më të përshtatshëm për territorin e Republikës së Shqipërisë.

#### Kapitulli 8 – Rezultatet dhe përfundimet

Në këtë kapitull është bërë një analizë e rezultateve të arritura në lidhje me saktësinë e modelit të gjeoidit të përzgjedhur.








Organogrami 1.1 Korniza konceptuale



## **2 Historiku i ndërtimit të referencave koordinative gjeodezike në Republikën e Shqipërisë**


### **2.1 Të dhënat gjeodezike për Shqipërinë**

Që nga shekulli XIX në territorin e Republikës së Shqipërisë janë kryer matje për ndërtimin e referencave koordinative gjeodezike. Matjet e para që lidhen me ndërtimin e referencës së parë koordinative janë matjet e kryera nga Perandoria Astro-Hungareze gjatë viteve 1853-1875 në gjithë territorin e Gadishullit Ballkanik, me qëllim krijimin e një baze gjeodezike të përshtatshme për krijimin e hartave në shkallë: 1:75 000 dhe 1: 200 000. Gjatë viteve 1871-1875 ekipeve gjeodezike austriake iu bashkuan edhe ekipet osmane për matjet e kryera në territoret ku shtrihen sot Bosnje-Hercegovina, Kosova, Rumania, Mali i Zi, Shqipëria, Maqedonia e Veriut, Serbia dhe Greqia. Si rezultat i këtyre matjeve të zhvilluara në atë kohë kemi mbulim me pika gjeodezike në të gjithë Ballkanin, siç shihet edhe në figurën 2.1.



**Figura 2.1. Matjet e para gjeodezike të kryera nga Perandoria Astro-Hungareze në Ballkan (Kovács & Timár, 2009)**

Gjatë periudhës kohore 1913-1918 IGUW (Instituti Gjeografik Ushtarak i Vjenës) ka kryer një tjetër etapë të matjeve gjeodezike me synim krijimin e bazës gjeodezike të përshtatshme për hartografinë e territorit (prej veriut deri në afërsi të lumit Vjosa) në shkallën 1:50 000. Ky triangulacion u shtrua me një dendësi 1 pikë/40km<sup>2</sup> dhe u zhvillua në tre rinde dhe u mbështet në disa baza rombrike të dyfishta të cilat janë paraqitur në figurën 2.2., ku njëra nga të cilat ishte baza e Shkodrës e matur në vitin 1869.



**Figura 2.2. Rrjeti i Triangulacionit të rendit të I-rë sipas IGUW, 1868-98 (Nurçe, 2012)**

Përveç triangulacionit u ndërtuan dhe realizuan disa vija të nivelimit, në sistemin e lartësive me pikënisje në Trieste, Itali siç edhe vërehet në figurën 2.3. Të dhënat gjeodezike të kësaj baze koordinative të krijuar janë (Nurçe, 2012):

**Tabela 2.1 Të dhënat koordinative gjeodezike nga IGUW (Nurçe, 2012):**

Elipsoidi	Bessel 1841
Origjina elipsoidike e veriut	$\varphi = 0^0$
Origjina elipsoidike e lindjes	$\lambda_{\text{Ferro}} = 17^{\circ} 30' 46.5''$
Projeksioni	Gauss- Krüger
Origjina fallco kënddrejtë e veriut	0.000 m
Origjina kënddrejtë e lindjes	0.000 m




Figura 2.3 Rrjeti i triangulacionit sipas Institutit Gjeografik Ushtarak të Vjenës (Nurçe et al., 2015)

Gjatë periudhës 1922-25, Instituti Gjeografik Ushtarak i Firencës (IGUF), ndërtoi bazën koordinative gjeodezike mbështetëse në formë triangulacioni (figura 2.4.), për rilevimin dhe krijimin e hartës së brezit kufitar shqiptar (me gjatësi 734km dhe gjerësi të brezit kufitar 2km) në shkallën 1:50 000.




Figura 2.4 Fragment hartë e brezit kufitar, shkalla 1: 50 000 (Nurçe, 2012)

Këto harta janë të detajuara dhe qartësisht të lexueshme siç edhe vërehet në figurën 2.5., relievi paraqitet me izohipse me baras lartësi 20m. Fletët e hartave kanë kornizën gjeografike dhe nuk kanë rrjetin e koordinatave kënddrejta të projeksionit (Nurçe, 2012).

**Tabela 2.2 Të dhënat gjeodezike të kësaj reference koordinative janë (Nurçe, 2012).**

Elipsoidi	Klark
Origjina elipsoidike e veriut	$\varphi = 0^0$
Origjina elipsoidike e lindjes	$\lambda_{\text{Ferro}} = 17^{\circ} 39' 09''$
Projeksioni	Polikonik ekuivalent i Bonit
Origjina fallco kënddrejtë e veriut	0.000 m
Origjina kënddrejtë e lindjes	0.000 m



**Figura 2.5 Rrjeti i triangulacionit kufitar i rendit I, II, III sipas IGUF, 1922-25 (Nurçe, 2012)**

Në periudhën kohore 1927-1934 IGUF (Instituti Gjeografik Ushtarak i Firences), Itali u angazhua në punimet që lidheshin me monometalizmin, matjet e nevojshme gjeodezike dhe kompensimin e një rrjeti të ri të triangulacionit. Ky rrjet ishte i përbërë nga katër rende, gjë që mundësoi hartografimin e territorit të Shqipërisë në shkallën:

1:50 000. Ky triangulacion u shtrua me një dendësi 1175 pika, 45 prej të cilave ishin të rendit të parë, u mbështet në dy baza të dyfishta rombrike, në bazën veriore të Shkodrës dhe atë jugore të Dukatit, Vlorë e matur më 1917 prej Observatorit Astronomik të Triestes. Dendësia ishte 1 pikë / 25km<sup>2</sup>. Të dhënat për bazën e re gjeodezike janë të paraqitura në tabelën 1.3 (Nurçe, 2012).

**Tabela 2.3 Të dhënat për bazën gjeodezike (Nurçe, 2012):**

Rendi	Gjatësia mesatare e brinjës (km)	Saktësia e matjes së këndeve horizontale (‘‘)	Forma
I	25	± 1.55	Rrjet trekëndëshash
II	16	± 2.10	Rrjet trekëndëshash
III	11	± 3.80	Pjesërisht rrjet trekëndëshash
IV	2-4	-	Ndërprerje gjeodezike

Baza koordinative e të dhënave gjeodezike e krijuar nga IGUF, ku janë paraqitur të dhënat e kësaj baze mund të shihen në tabelën 1.4. (Nurçe, 2012):

**Tabela 2.4 Të dhënat koordinative gjeodezike nga IGUF (Nurçe, 2012).**

Elipsoidi	Bessel 1841
Origjina elipsoidike e veriut	$\varphi = 0^{\circ}$
Origjina elipsoidike e lindjes	$\lambda_0 = 20^{\circ}$
Projeksioni	Gauss- Boaga
Origjina fallco kënddrejtë e veriut	0.000 m
Origjina kënddrejtë e lindjes	0.000 m

Me qëllim të unifikimit të sistemit të koordinatave, triangulacioni i Shqipërisë u lidh me atë të Italisë nëpërmjet katërkëndëshit gjeodezik Vlorë-Bari. Shtrimi i këtij rrjeti u mbështet në dy baza të dyfishta rombrike, njëra në bazën veriore të Shkodrës dhe tjetra në bazën jugore të Dukatit të Vlorës.

Gjatë periudhës kohore 1930-1932 krahas punimeve në rrjetin e triangulacionit ky institut u angazhua edhe në krijimin e referencës vertikale për territorin e Shqipërisë, të paraqitur në figurën 2.6., e cila do t’i referohej nivelit mesatar të detit Adriatik të matur në portin e Durrësit.






Figura 2.6. Rrjeti i triangulacionit sipas Institutit Gjeografik Ushtarak të Firencës (Nurçe et al., 2015)

Një tjetër periudhë e rëndësishme u shënuar në vitet 1934–1942, IGUF, Itali, kreu nivelim gjeometrik të saktësisë së lartë në vijën e nivelimit Durrës–Fier, rreth 128 km dhe në vijën Durrës–Tiranë. U matën gjithashtu, edhe disa vija nivelimi të rendit të dytë sipas rrugëve automobilistike Vorë-Shkodër-Pukë, Rrogozhinë-Elbasan dhe Lushnjë-Berat. Lartësitë e pikave të këtyre vijave u llogaritën në sistemin e lartësive ortometrike të përafërta. Gjithashtu edhe disa vija të tjera më të shkurtra nivelimi, por me saktësi më të ulët (Nurçe, 2012).

Zero e lartësive u përcaktua me vëzhgimet njëmuajore në mareografinë e portit në Durrës. Sistemi i lartësive i kësaj periudhe ishte sistemi i lartësive të përafërta, që nënkupton korrigjim vetëm për gravitet normal në mungesë të vlerave reale të gravitetit.


Në periudhën 1950 - 1955 baza koordinative italiane (në plan) u transformua në elipsoidin Krassowsky dhe meridian qendror  $\lambda_0 = 21^\circ$

Gjatë viteve 1950-1955, Instituti CNIGA Moskë, transformoi rrjetin horizontal ekzistues të ndërtuar nga IGUF gjatë periudhës 1930 -1932 në sistemin e koordinatave të vitit 1942 (elipsoidi Krasovskiy, zona e 4 koordinatave  $6^\circ$ , me meridian qendror  $\lambda_0 = 21^\circ$ ), por nuk ka informacion rreth transformimit të kryer! (Nurçe, 2012).

Gjithashtu më 1955, në brinjët e hyrjeve të bazave të Shkodrës dhe Vlorës u kryen vëzhgime astronomike, ku u përcaktuan:

- Gjerësia astronomike
- Gjatësia astronomike
- Azimuti astronomik

Janë bazuar në katalogun Yjor FK-3, duke marrë parasysh korrigjimet për nutacionin periodë-shkurtër, lëvizjen e polit dhe korrigjimin për reduktim në nivelin e detit (për gjerësinë dhe gjatësinë astronomike) (Nurçe, 2012) të cilat janë të paraqitura në figurën 2.7.



**Figura 2.7. Paraqitja e rrjetit Kl.1 dhe lartësitë gjeoid-elipsoid (Nurçe, 2012)**

Në periudhën kohore 1950-52, Sektori Topografik i Ministrisë së Bujqësisë, ndërtoi dhe i kreu matjet e vijave të nivelimit Fier-Delvinë 148.6km dhe Vorë-Koplik 122.6km me nivela me saktësi të horizontimit të boshtit të vizimit  $\pm 5''$ .6 sipas metodikës së nivelimit të kl. 3., të paraqitura në figurën 2.8.




Figura 2.8. Paraqitja e Rrjetit të Nivelimit 1930-32 & 1950-52 (Nurçe, 2012)

Nga Instituti Topografik i Ushtrisë u kryen matje në periudhën kohore 1970 -1987, mandej u angazhua në matjet që lidheshin me monometalizmin, matjet e nevojshme dhe kompensimin e një rrjeti të ri të triangulacionit dhe nivelacionit me parametra teknik më të avancuara se rrjetet paraardhëse të ndërtuara nga të huajt. Ky rrjet i ndërtuar është i përbërë nga tre rrede, ku në rrjetin e trekëndëshave (triangulacionit) janë matur të gjitha këndet horizontale dhe zenitale (Nurçe, 2012).

Gjithashtu u caktua edhe një pikë origjinë në Kamëz – 8814, e cila ka këto koordinata (Nurçe et al., 2015):

$$\varphi_0 = 41^\circ 21' 29.69''$$

$$\lambda_0 = 19^\circ 45' 58.215''$$

Në kuadër të këtyre matjeve janë bërë disa nga këto përcaktime:

- 7-përcaktime astronomike (gjerësi, gjatësi dhe azimuti astronomik) në 7-sistemet rombike të rrjetit.
- Janë krijuar 7-baza të triangulacionit të matura me saktësi relative 1/1 000 000, të cilat, nëpërmjet sistemeve rombike, përcaktojnë 7-brinjë hyrje rrjeti me saktësi relative 1/350 000.




- Nuk janë kryer matje gravimetrike, rrjedhimisht nuk janë kryer korrigjime gravimetrike si në pikën fillestare, ashtu dhe në pikat e rrjetit të trekëndëshave. Brinjët e hyrjes nuk mund të jenë reduktuar në elipsoid për arsye të mungesës së lartësive gjeoid-elipsoid (N), pra dhe të lartësive elipsoidike.
- Lartësitë absolute (të nivelimit) në pikat fundore të brinjëve të hyrjes janë përdorur për reduktimin e tyre, në nivelin mesatar të detit e jo në elipsoid. Reduktimi i brinjëve të hyrjes në projeksionin Gauss ka qenë i mundur të bëhej.
- Gjithashtu është përcaktuar edhe niveli mesatar i detit në bazë të vrojttimeve të pandërprera 18-vjeçare (1957-1975).

Në pikat e rrjetit “zero” dhe të nivelimit nuk janë matur vlerat e gravitetit real  $g$ , duke sjellë një sistem lartësie jokorrekt. Disnivelet e matura janë korrigjuar vetëm për gravitet normal  $\gamma$ , prandaj sistemi i lartësive të fituara mund të klasifikohet si ortometrik me korrigjim normal. (Nurçe, 2012).

$$\gamma_{\varphi, 0} = 978.0327(1 + 0.0053024 \sin^2 \varphi_m - 0.0000058 \sin^2 2\varphi_m) \text{ gal}$$

Mungesa e matjeve gravimetrike bën të pamundur llogaritjen e lartësive elipsoid- gjeoid (N), gjithashtu edhe të lartësive elipsoidike. (Nurçe, 2012).

Një paraqitje grafike e Rrjetit të Triangulacionit (majtas) dhe Nivelacionit shtetëror (djathtas) sipas IGUSH, 1970-1986 mund të shihet në figurën 2.9.



**Figura 2.9. Rrjeti i Triangulacionit (majtas) dhe Nivelacionit shtetëror (djathtas) sipas IGUSH, 1970-1986**

Ndërsa të dhënat gjeodezike të kësaj baze koordinative u formuluan në këtë formë:

**Tabela 2.5 Të dhënat gjeodezike nga ITU (Nurçe, 2012)**

Elipsoidi	Krassowsky 1940
Origjina elipsoidike e veriut	$\varphi = 0^0$
Origjina elipsoidike e lindjes	$\lambda_0 = 21^0$
Projeksioni	Gauss-Krüger (TM)
Origjina fallco kënddrejtë e veriut	0.000 m
Origjina kënddrejtë e lindjes	4 500 000 m
Shkalla e shformimit në MQ	$s_0 = 1$

Tani fillon një periudhë e re për sistemet referente gjeodezike në të gjithë botën, njësoj ndodhi edhe me Shqipërinë. Kornizat referente gjeodezike “klasike” duhet të kalonin në korniza “moderne” në mënyrë që t’i përshtateshin trendeve të zhvillimit të hovshëm të teknologjisë. Kështu në Shqipëri janë bërë disa fushata të transformimit të referencave koordinative si:

Në tetor të vitit 1994, në bashkëpunim me DMA (sot NIMA) u kryhen vërtetimet GPS me qëllim të transformimit të referencës lokale ALB86 (Krasowsky) në referencën e re koordinative globale ITRF96 (WGS84). Në atë fushatë matjesh janë matur gjithsej 35 pika, prej këtyre 24 pika të triangulacionit dhe 11 pika të nivelacionit shtetëror.

Në shkurt të vitit 1998, si rezultat i bashkëpunimit me Universitetin Wiskonsini, USA, u kryhen vërtetime të tjera GPS me qëllim të testimit të marrësëve Corvallis GPS, si dhe lidhjen e rrjetit gjeodezik shtetëror me Sistemin Referues Ndërkombëtar, ITRF. Vërtetimet u kryen në tre stacione, 8814 (Kamzë), 6339 (Shkodër) dhe 12602 (Korçë) për më shumë se 14 orë. Devijimet standarde për koordinatat e llogaritura (X, Y, Z) dhe koordinatat elipsoidike ( $\varphi$ ,  $\lambda$ , h) në WGS 84, ITRF96, Epoch 1998 janë në rangun 1-2cm, ndërsa për pikat e rillogaritura deri 10cm. (Nurçe, 2012). Paraqitja e fushatës së matjeve të Shqipërisë për periudhat: 1994, 1998, 2002 mund të shihet në figurën 2.10.



**Figura 2.10. Fushatat e matjeve satelitore në Shqipëri: 1994, 1998, 2002 (Nurçe, 2012)**

Në shtator të vitit 1998 një bashkëpunim në mes BKG (Bundesamt für Kartographie und Geodäsie) Frankfurt, Gjermani dhe personelit të ITU, u kryen vërtetime të tjera GPS me qëllim të lidhjes së Rrjetit Gjeodezik Shtetëror me Sistemin Referencë, kështu që në atë kohe u bë i mundur transformimi i pozicioneve lokale të Referencës ALB86 (Krasowsky) në Evropiane, ETRS89. Vërtimet u kryen në pesë (5) seksione, në 24 orësh janë kryer në nëntë (9) stacione (5 pika të triangulacionit shtetëror dhe 4 të rrjetit gjeodinamik). (Nurçe, 2012).

Me qëllim të gjetjes së parametrave të transformimit ndërmjet dy sistemeve të referencës ETRF2000 dhe ALB86 (vjeshtë 2007 – pranverë 2008) u zhvillua edhe një fushatë matjesh. Qëllimi kryesor i saj ishte gjetja e parametrave të rrjetit gjeodezik, i cili u organizua në dy nivele të ndryshme. Rrjeti RDN i projektuar përbëhej nga 14 stacione GPS në distancë mesatare 100km, gjashtë (6) stacione të Shërbimit Sizmologjik dhe tetë (8) stacione të reja. Rrjeti statik (RSN) ka qenë projektuar si një rrjet me rreth 150 pika (triangulacion + nivelim) së bashku në distancë mesatare të pikave 35 - 40km, siç edhe mund të shihet në figurën 2.11., (Nurçe, 2012).



**Figura 2.11. Rrjeti kryesor RDN dhe dendësues RSN (Nurçe et al., 2015)**

Transformimi i koordinatave ITRF2005 në sistemin ETRF2000, Epoka 2008.0 është bërë nëpërmjet dy hapave: së pari kalimi nga ITRF2005 në ITRF2000 dhe pastaj kalimi nga ITRF2000 në ETRF2000.


$$X (ITRF2005,2008.0) = X (ITRF2005,2000.0) + X (ITRF2005,2000.0) (2008.0 - 2000.0)$$

Nga 136 pika të rrjetit RSN, 7 pika janë hequr nga lista sepse nuk korrespondojnë, prej këtyre 90 pika janë të triangulacionit dhe 39 pika të nivelimit.


Për të filtruar matjet prej gabimeve të mëdha dhe për të realizuar përshtatjen lokale të elipsoidit global EGM2008 për territorin shqiptar, ishte i nevojshëm të bëhej edhe transformimi i lartësive nga  $h_{GRS80} \rightarrow H_{ALB86}$ , për të arritur këtë paraprakisht është kryer një transformim hapësinor 7P Helmert, me sistem nisje ETRF2000, me kuota elipsoidike të korrigjuara për modelin EGM2008 dhe sistem mbërritje ALB86. Pas transformimit Helmert, janë përjashtuar tetë (8) pika që kishin ndryshime  $\geq 70$  cm në gjerësi, gjatësi, si dhe në lartësi. (Nurçe, 2012).

Për t'u realizuar ky transformim u bë një përshtatje lokale e gjeoidit global EGM2008 me një transformim 7P Helmert në 125 pika të përbashkëta: Sistem "nisje" ETRF2008 (me lartësi  $h_{GRS80}$  dhe  $H_{EGM2008}$ ) dhe sistem "mbërritje" përsëri ETRF2008 me lartësi gjeoidike të vërteta (nivelimi ALB86). Për të përmirësuar besueshmërinë e llogaritjes së mëtejshme të lartësive, u përjashtuan edhe tetë (8) pika të tjera me mospërputhje hapësinore  $\geq 50$  cm (Nurçe, 2012).

Për 10753 kulmet e gridës me përmasa qelizash  $2'.5 \times 2'.5$  të zonës elipsoidike ndërmjet paraleleve  $39^\circ$ - $43^\circ.5$  dhe meridianeve  $18^\circ$ - $22^\circ$ , të përshtatura lokalisht me 7-parametrat e transformimit Helmert me modelin e gjeoidit global EGM2008, janë llogaritur valëzimet e gjeoidit N. Si rezultat i gjithë kësaj u arrit një përafrim i mirë i gjeoidit EGM2008 për territorin shqiptar (Nurçe, 2012). Paraqitja grafike e saj është bërë në figurat 2.12. dhe 2.13.



**Figura 2.12. Përzgjedhja e zonës elipsoidike ndërmjet paraleleve dhe meridianeve për territorin shqiptar (Nurçe, 2012)**



**Figura 2.13. Paraqitja e lartësive elipsoid Gjeoid NEGM2008-GRS80 (Nurçe, 2012)**



Lartësia gjeoidike ( $H_{ALB86}$ ) është llogaritur prej lartësive elipsoidike  $h_{GRS80}$  të çdo pike të territorit të Shqipërisë, në bazë të relacionit (Nurçe, 2012), siç edhe mund të shihet në figurën 2.13.

$$H_{ALB86} = h_{GRS80} + N_{EGM2008} - GRS80$$

Transformimi i lartësive elipsoidike u realizua nëpërmjet programit ALBGEO3, i cili llogarit lartësitë gjeoidale duke u nisur nga lartësitë elipsoidike. Saktësia e llogaritjes së lartësive ALB86 shkon deri 20cm (me nivel sigurie 68%) dhe deri 40cm (me nivel sigurie 85%). Në rrethanat e mungesës së matjeve të gravitetit, rezultati i arritur konsiderohet i mirë. Një përmirësim themelor i saktësisë mund të arrihet vetëm duke futur në llogaritje një numër të mjaftueshëm matjesh gravimetrike dhe një model të saktë dixhital të terrenit.

Për transformimin e pozicioneve planimetricke ndërmjet referencave, ETRF2000, 2008  $\leftrightarrow$  ALB86, janë përzgjedhur 90-pika me koordinata planimetricke të përbashkëta, ku për çdo pikë janë vlerësuar ndryshimet: (Nurçe, 2012), siç edhe mund të shihet në figurën 2.14.

$$\Delta\varphi = \varphi_{ALB86} - \varphi_{ETRF2000}$$

$$\Delta\lambda = \lambda_{ALB86} - \lambda_{ETRF2000}$$




Figura 2.14. Diferencat ndërmjet (ETRF2000-ALB86) në gjerësi (majtas) dhe në gjatësi (djathtas) (Nurçe, 2012)

Për 90 pikat e përbashkëta të përdorura për gridat, u llogaritën 7-parametrat e Helmertit për gjithë territorin e Shqipërisë (Nurçe, 2012):

**Tabela 2.6 Parametrat e Helmertit të llogaritur për territorin e Shqipërisë (Nurçe, 2012).**

Elipsoidi fillestar:	GRS80
a = 6378137; f = 0.003352811	
Elipsoidi i mbërritjes:	Krassovsky 1940
a = 6378245; f = 0.00335233	

Edhe pse janë eliminuar prej llogaritjeve pikat me ndryshime koordinatash më të mëdha se 50cm, shmangia mesatare kuadratike për njësi të peshës nuk është më e vogël se nën 18cm. Atëherë si rrjedhojë e gjithë kësaj, u krye fushata prej IGM, me rezultatet më të mira të arritura deri tani, gjë që vendosi marrëdhëniet matematike më të mira të mundshme ndërmjet referencave ETRF2000, 2008.0 ↔ ALB86.

Ndërtimi i sistemit GNSS, pozicionimi për Shqipërinë u quajt ALBPOS. Punimet për ndërtimin e ALBPOS u mbikëqyrën nga Instituti Gjeografik Ushtarak, Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe nga Departamenti i Gjeodezisë-Fakulteti i Inxhinierisë së Ndërtimit. Procesi i matjeve u krye në vitin 2010 duke përdorur Bernese GNSS Softuer Versioni 5.0 në përputhje me rekomandimet e EPN (ang. Analysis Centre). Koordinatat e përfituara në IGS05, Epoka 2009.9 u transformuan në ETRF 2000, Epoka 2008.0 dhe ETRF 2000 në Epoka 1989.0. ALBPOS përbëhet nga 16 stacione permanente GNSS dhe Qendra e Kontrollit, një paraqitje grafike e të cilave mund të shihet në figurën 2.15.



Figura 2.15. Stacionet permanente të ALBPOS (Nurçe et al., 2015)

## 2.2 Sistemi i referencës vertikale të Shqipërisë

Punimet gravimetrike në Shqipëri datojnë që pas çlirimit të vendit, vetëm për kërkime minerare dhe gjeofizike. Punimet e vetme gravimetrike për qëllime gjeodezike janë kryer në pikat e poligonit të nivelimit të rendit të parë, në zonën veriore të Shqipërisë, por ato kanë qenë relative dhe të palidhura me ndonjë vlerë absolute.

Mungesa e matjeve gravimetrike absolute dhe relative bënë të pamundur llogaritjen e lartësive elipsoid –gjeoid (N). Paraqitja grafike e rrjetit gravimetrik të Shqipërisë mund të shihet në figurën 2.16.






**Figura 2.16. Rrjeti gravimetrik i Shqipërisë (Nurçe et al., 2015)**

Vetëm në vitin 2015 u arrit që me ndihmën e autoritetit norvegjez Statens Kartverk të bëhet i mundur zhvillimi i matjeve absolute gravimetrike për tre vende të rajonit: Shqipërinë, Kosovën dhe Malin e Zi. Në Republikën e Shqipërisë janë bërë matje gravimetrike absolute në tri pika për gjithë territorin (Shkodër, Tiranë dhe Sarandë) duke marrë si bazë stacionin në pikën e Tiranës siç edhe mund të shihet në figurën 2.17.

**Tabela 2.7 Paraqitja e pikave absolute gravimetrike në tre stacionet (ang. Absolut Gravity Measurements-Albania-Kosovo-Montenegro 2015).**

Stacioni	Qyteti	Gjerësia	Gjatësia	Pozicioni referent	Lartësia [m]	Lartësia referente
Albania_1	Shkodër	42°03'02.04"	19°29'46.89"	ETRS89	24.63	Niveli i detit
Albania_2	Tirana	41°20'49.98"	19°51'48.17"	ETRS90	197.73	Niveli i detit
Albania_3	Saranda	39°52'41.82"	20°00'19.01"	ETRS91	48.72	Niveli i detit

Si rezultat i këtyre matjeve gravimetrike absolute të bëra në këto tri stacione janë shfaqur vlerat e matura për tre pikat absolute gravimetrike për Shqipërinë.



**Figura 2.17. Paraqitja grafike e stacioneve gravimetrike në Republikën e Shqipërisë**

Vlera e gravitetit të matur i referohet lartësisë 1.22 mbi markën e vendosur në bllokun e betonit. Matjet janë kryer me gravimetër absolut FG5/242. Gradienti vertikal është matur me gravimetër relativ Scintrex CG5, në tre (3) lartësi të ndryshme 25, 70 dhe 125cm sensor mbi dysheme). Për përpunimin e llogaritjeve të gravitetit absolut u përdor softueri G9 (version 9.12).

### **3 Fusha e gravitetit të Tokës**

#### **3.1 Hyrje në teorinë e gravitetit**

Në gjeodezi luan një rol të madh fusha e gravitetit të Tokës. Bazat e teorisë së fushës së gravitetit qëndrojnë në përkufizimin se një trup në sipërfaqen e Tokës përjeton forcën e gravitetit të masës së Tokës, si dhe forca centrifugale për shkak të rrotullimit të Tokës dhe këtë e quajmë gravitet. Teoritë mbi fushën e gravitetit janë trajtuar në gjeodezi e në librat e gjeografisë, ku janë marrë: (Heiskanen & Moritz, 1967), (Moritz, 1980), (Hofman-Wellenhof & Moritz, 2005), (Jeffreys, 1970), (Lowrie, 2007).

Për përcaktimin e fushës së gravitetit të Tokës është e nevojshme të trajtohen disa problematika shkencore siç janë:

- Teoria e potencialit
- Funksionet matematikore
- Vlerat kufitare
- Trajtimi i sinjalit etj.

Përafrimi i parë i Tokës ishte që Toka mund të shihet si sferë me strukturën e dendësisë qendrore simetrike, ku për llogaritjen e brendshme dhe të jashtme të mbulesës përdorim sistemin koordinativ të sferës që janë:  $r$ ,  $v$ ,  $\lambda$ .

Me rrotullimin e tokës rreth boshtit çdo objekt që ndikohet nga forca centrifugale, si dhe shpejtësia këndore ( $\omega$ ) e vazhdueshme paraqitet me saktësi të lartë nga astronomia:

$$\omega = 7.292\ 115 \times 10^{-5} \text{ rad s}^{-1} \quad (3.1)$$

Sipas ligjeve të Newton-it për Gravitetin, masa e dy -pikave  $m_1$  e  $m_2$  tërheqin njëra tjetrën me forcën gravitacionale (forca tërheqëse) (Torge & Muller, 2012).

$$K = G \frac{m_1 m_2}{l^2} \quad (3.2)$$

ku:

G paraqet konstantën gravitacionale me një pasiguri relative  $1 \times 10^{-4}$  dhe e paraqesim si mëposhtë (CODATA, 2006; Mohr et al., 2008).

$$G = (6.674\ 28 \pm 0.000\ 67) \times 10^{-11} \text{ m}^3 \text{ kg}^{-1} \text{ s}^{-2} \quad (3.3)$$

ose ( $\text{N} \cdot \text{m}^2 \cdot \text{kg}^{-2}$ )

Vlera G është sipas konventave të IERS, (Petit dhe Luzum, 2010) dhe e paraqet largësinë në mes të masave. Duhet të theksohet se pasiguria G ndikon në llogaritjen e masës dhe densitetit mesatar të Tokës dhe në momentet e saj të inercisë (Torge & Muller, 2012), siç edhe shihet në figurën 3.1. (Graviteti).




Figura 3.1 Graviteti (Torge & Muller, 2012)

$$l = |\mathbf{l}| = \sqrt{(X - X')^2 + (Y - Y')^2 + (Z - Z')^2} \quad (3.4)$$

ku:

$l$  paraqet pozicionin e vektorëve  $r$  dhe  $r'$  në sistemin global karteziqan  $X, Y, Z$ .

Ku pozicionet e vektorëve janë  $r^T = (X, Y, Z)$  dhe  $r'^T = (X', Y', Z')$

### 3.2 Fusha e gravitetit të Tokës

Fusha paraqet një hapësirë ku ne mund të zbulojmë një forcë por për të gjetur një fushë gravitacionale të një pike, duhet vendosur një masë  $m$  në një pikë dhe të matet forca  $F$ . Fuqia e fushës gravitacionale e paraqitur në figurën 3.2., përcaktohet të jetë fuqia për kilogram (kg):

$$F = mg \quad (3.5)$$

siç dhe është paraqitur ndikimi i masës me gravitetin e Tokës.




Figura 3.2 Fuqia e fushës mbi sipërfaqen e Tokës (Cooper, 2002)

Sipas Newton-it, të cilin e kemi cekur në (ekuacioni 3.2), ku dy trupa me të njëjtën magnitudë, por që veprojnë në drejtime të kundërta, si dhe përgjatë një vije duke u bashkuar me qendrat e masës së dy trupave dhe duke qenë gjithmonë tërheqës, paraqesin forcën gravitacionale. Duke pasur parasysh (ekuacioni 3.3) që në të shumtën e rasteve e marrim si 9.81, kjo paraqitet si e saktë vetëm në ose afër sipërfaqes së Tokës siç paraqitet edhe në figurën 3.3.




Figura 3.3 Grafiku i fushës së gravitetit (Cooper, 2002)

Gjeometria e fushës së gravitetit është veçanërisht e rëndësishme për aplikimet lokale, tek sa zgjerimi i harmonikës sferike siguron një mjet i fuqishëm për përfaqësimin e fushës së gravitetit global.

Vektori gradient i potencialit të gravitetit quhet vektori i gravitetit  $\bar{g}$ , ku forca centrifugale plus ajo gravitacionale veprojnë në njësi masë. Ku si një vektor ka magnitudë dhe drejtim.

$$g = \sqrt{g_x^2 + g_y^2 + g_z^2} = \|\bar{g}\| \quad (3.6)$$

Pasi që gradienti  $W$  jep  $\bar{g}$  vektorin e gradientit atëherë do të kemi:

$$\bar{g} = \text{grad } W = \begin{pmatrix} W_x \\ W_y \\ W_z \end{pmatrix} \quad (3.7)$$

Me komponentët të cilat janë dhënë sipas (Heiskanen & Moritz, 1967):

$$\begin{aligned} g_x &= \frac{\partial W}{\partial x} = -k \iiint_v \frac{x-\xi}{l^3} \rho \, dv + \omega^2 x \\ g_y &= \frac{\partial W}{\partial y} = -k \iiint_v \frac{y-\eta}{l^3} \rho \, dv + \omega^2 y \\ g_z &= \frac{\partial W}{\partial z} = -k \iiint_v \frac{z-\zeta}{l^3} \rho \, dv \end{aligned} \quad (3.8)$$


Përbërësit e tij janë derivate të pjesshme të W duke i respektuar x, y, z, që është rezultati i forcës gravitacionale V dhe forcës centrifugale.

Derivatet e pjesshme të rendit të dytë V paraqiten nga një matricë simetrike:

$$\begin{pmatrix} V_{xx} & V_{xy} & V_{xz} \\ V_{yx} & V_{yy} & V_{yz} \\ V_{zx} & V_{zy} & V_{zz} \end{pmatrix}$$

i cili quhet tensori i gradientit të gravitetit (të rendit të dytë). Në mënyrë të ngjashme, derivatet e rendit të dytë W formojnë tensorin e gradientit të gravitetit (Moritz, 1980).

Drejtimi i vektorit të gravitetit është drejtimi i linjës pingule ose vertikale, ku çdo linjë që ndërpret të gjitha sipërfaqet ekuipotenciale, normal që nuk janë saktësisht të drejta por pak të lakuara, quhen linja pingule, siç edhe janë paraqitur në figurën 3.4.



**Figura 3.4** Sipërfaqet e nivelit dhe linjat pingule (Heiskanen & Moritz, 1967)

Madhësia g quhet gravitet në kuptim më të ngushtë. Ka dimensionin fizik të një përsheptimi dhe matet me gals (1gal = 1cm sec<sup>-2</sup>), njësia ka marrë emrin në nder të Galile Galileos. Vlera numerike e g është 978gals në ekuator dhe 983gals në pole. Kurse në gjeodezi është më i përshtatshëm miligal që është mgal (1mgal = 10<sup>-3</sup> gal) (Heiskanen & Moritz, 1967).

$$\begin{aligned} 1Gal &= 10^{-2}m/s^2 = 1cm/s^2 \\ 1mGal &= 10^{-5}m/s^2 \\ 1\mu Gal &= 10^{-8}m/s^2 \end{aligned} \quad (3.9)$$

### 3.3 Ekuacioni themelor i gjeodezisë fizike

Ekuacioni themelor i gjeodezisë fizike mund të shkruhet (Moritz, 1980):

$$\Delta_g = -\frac{\partial T}{\partial h} + \frac{1}{\gamma} \frac{\partial \gamma}{\partial h} T \quad (3.10)$$

Në përafrimin sferik formula e mësipërme mund të shkruhet edhe në formën (Moritz, 1980):

$$\Delta_g = -\frac{\partial T}{\partial h} - \frac{2}{R} T \quad (3.11)$$

ku:

R - është rrezja mesatare e Tokës.

### 3.4 Potenciali i rëndesës

Në bazë të parametrave të potencialit të trupit të ngurtë supozohet se masat e një pike shpërndahen vazhdimisht mbi një vëllim  $v$  me densitet, ku  $dv$  paraqet elementin e volumit dhe  $dm$  paraqet elementin e masës (Heiskanen & Moritz, 1967).

$$\rho = \frac{dm}{dv} \quad (3.11)$$

Si dhe shuma e një sistemi të masave të disa pikave  $m_1, m_2, \dots, m_n$ , ku potenciali i sistemit është shuma e kontribuesit individual që ndërlihet me funksionin skalar.

$$V = \frac{km_1}{l_1} + \frac{km_2}{l_2} + \dots + \frac{km_n}{l_n} = k \sum_{i=1}^n \frac{m_i}{l_i} \quad (3.12)$$

si funksion skalar paraqesim:


$$V = \frac{km}{l} \quad (3.13)$$

Por nga shuma (ekuacioni. 3.12) fitohet forca gravitacionale potenciale e cila definohet:

$$V_p = G \iiint_{Earth} \frac{dM}{l} \quad (3.14)$$

Ku  $dM$  është element i masës, i paraqet distancën në mes pikës së llogaritur dhe pikës së lëvizshme, si dhe konstanta e Newton-it për gravitetin (ekuacioni 3.3).  $\omega$  është shpejtësia mesatare këndore e rrotullimit të Tokës e paraqitur (ekuacioni 2.1) dhe potenciali i forcës centrifugale është  $\varphi$  (Heiskanen & Moritz, 1967) të paraqitura në figurën 3.5.

$$\varphi = \frac{1}{2} \omega^2 (x^2 + y^2) \quad (3.15)$$




**Figura 3.5** Forca centrifugale (Heiskanen & Moritz, 1967)

ku:

$x$  dhe  $y$  janë koordinata gjeocentrike të pikës së dhënë  $P$  në kuadër të sistemit referent siç edhe mund të shihen në figurën 3.6.





**Figura 3.6 Koordinatat gjeocentrike dhe elipsoidale**

Kështu në bazë të shumës së potencialit të forcës së gravitetit  $V$  dhe forcës centrifugale  $\varphi$  paraqitet potenciali i gravitetit  $W$  (Heiskanen & Moritz, 1967):


$$\begin{aligned} W &= W(x, y, z) = V + \varphi \\ W(x, y, z) &= V(x, y, z) + \varphi(x, y, z) \end{aligned} \quad (3.16)$$

ku:

integrimi shtrihet mbi Tokë.

Dallimi në mes të potencialit aktual të gravitetit  $W$  dhe potenciali normal i gravitetit  $U$  përcaktohet nga anomalia e potencialit  $T$ , siç edhe mund të vërehet në figuën 3.7.

$$\begin{aligned} W(x, y, z) &= U(x, y, z) + T(x, y, z) \\ W(x, y, z) &= W_0 = \text{const} \\ \text{Gjeoidi: } W(x, y, z) &= W_0 \\ \text{Elipsoidi referent: } U(x, y, z) &= W_0 \end{aligned} \quad (3.17)$$



**Figura 3.7** Lartësia gjeoidale dhe anomalitë e lartësive (Ameti, 2006)

E ndajmë potencialin  $W$  në potencialin normal  $U$  dhe potencialin shqetësues  $T$  (ekuacioni 3.17), kjo është e rëndësishme për të përcaktuar koordinatat elipsoidale ( $\varphi$ ,  $\lambda$ ,  $h$ ) në lidhje me këtë nivel të elipsoidit:  $U(h=0)=U_0=W_0$ .

ku:

$h$ -është lartësia mbi elipsoid (e matur përgjatë elipsoidit normal),

$\lambda$ -është gjatësia elipsoidale,

$\varphi$ -është gjerësia elipsoidale,

nga ekuacioni (3.17) mund të shkruajmë (Barthelmes, 2009):

$$W(h, \lambda, \varphi) = U(h, \varphi) + T(h, \lambda, \varphi) \quad (3.18)$$

dhe gjeoidi në koordinatat elipsoidale është sipërfaqja ekuipotenciale (Barthelmes, 2009):

$$W(h = N(\lambda, \varphi), \lambda, \varphi) = U(h = 0, \varphi) = U_0 \quad (3.19)$$

ku:

$N(\lambda, \varphi)$  - është përfaqësim i zakonshëm i gjeoidit si largësi  $N$  në lidhje me elipsoidin ( $U=U_0$ ), si funksion i koordinatave  $\lambda$  dhe  $\varphi$ .

Kështu që  $N$  është valëzim i sipërfaqes gjeoidale në lidhje me elipsoidin. Tani me elipsoidin dhe gjeoidin, kemi dy sipërfaqe referente në lidhje me të cilat mund të jepet lartësia e një pike. Për të treguar lartësinë e sipërfaqes së Tokës, përkatësisht lartësinë

e topografisë në lidhje me elipsoidin  $h_t$  dhe në lidhje me gjeoidin  $H$ , do të kemi (Barthelmes, 2009):

$$h_t(\lambda, \varphi) = N(\lambda, \varphi) + H(\lambda, \varphi) \quad (3.20)$$

si potenciali  $W$  (ekuacioni 3.17) potenciali normal gjithashtu përbënë një pjesë atraktive  $U_a$  dhe potenciali centrifugal (Barthelmes, 2009):

$$U = U_a + \varphi \quad (3.21)$$

padysim potenciali shqetësues (Barthelmes, 2009):

$$T(h, \lambda, \varphi) = W_a(h, \lambda, \varphi) - U_a(h, \varphi) \quad (3.22)$$

nuk përmban potencialin centrifugal dhe është harmonik jashtë masave. Gradienti i potencialit normal (Barthelmes, 2009):

$$\vec{\gamma} = \nabla W \quad (3.23)$$

është quajtur graviteti normal vektor dhe madhësia (Barthelmes, 2009):

$$\gamma = |\nabla W| \quad (3.24)$$

është graviteti normal.

Nëse ne krahasojmë gjeoidin me elipsoidin referent në të njëjtin potencial  $U_0 = W_0$ , ku pika  $P$  e gjeoidit është projektuar në pikën  $Q$  të elipsoidit, në anë të elipsës normale. Distanca ndërmjet gjeoidit dhe elipsoidit  $PQ$  quhet lartësi e gjeoidit ose valëzim i gjeoidit (Heiskanen & Moritz, 1967). Paraqitja grafike e të cilës jepet në figurën 3.8.




Figura 3.8 Gjeoidi dhe elipsoidi referent (Heiskanen & Moritz, 1967).

Mbas valëzimit, për llogaritjen e anomalisë së gravitetit ajo është diferenca ndërmjet magnitudës dhe drejtimit. Nëse e konsiderojmë që vektori i gravitetit  $g$  në pikën  $P$  dhe normalja e vektorit të gravitetit  $\gamma$  në pikën  $Q$  atëherë do të kemi: (Heiskanen & Moritz, 1967)

$$\Delta g = g_p - \gamma_Q \quad (3.25)$$

Si dhe nëse krahasojmë vektorët  $g$  dhe  $\gamma$  në të njëjtën pikë  $P$  e fitojmë.

$$\delta g = g_p - \gamma_p \quad (3.26)$$

ku diferencën në magnitudë e quajmë gravitet shqetësues.

$$\delta g = g_p - \gamma_p \quad (3.27)$$

Tjetër e konsiderojmë shqetësimin e gravitetit (Heiskanen & Moritz, 1967),

ku:

$$g = \text{grad } W, \quad \gamma = \text{grad } U \quad (3.28)$$

dhe vektori shqetësues i gravitetit do të marrë formën:

$$\delta g = \text{grad } (W - U) = \text{grad } T = \left( \frac{\partial T}{\partial x}, \frac{\partial T}{\partial y}, \frac{\partial T}{\partial z} \right) \quad (3.29)$$

atëherë:


$$g = -\frac{\partial W}{\partial n}, \quad g = -\frac{\partial U}{\partial n'} = -\frac{\partial U}{\partial n} \quad (3.30)$$

pasi që normalët  $n$  dhe  $n'$  pothuajse përkojnë, atëherë shqetësimi i gravitetit jepet si në figurën 3.9.

$$\delta g = g_p - \gamma_p = -\left(\frac{\partial W}{\partial n} - \frac{\partial U}{\partial n'}\right) = -\left(\frac{\partial W}{\partial n} - \frac{\partial U}{\partial n}\right) \quad (3.31)$$

ose

$$\delta g = -\frac{\partial T}{\partial n}, \quad (3.32)$$



**Figura 3.9** Zgjerimi në harmonika sferike (Heiskanen & Moritz, 1967)

Funksioni i potencialit gravitacional  $V$  shprehet me zgjerim sferik harmonik si në vijim:

$$V = \frac{GM}{r} \left( 1 + \sum_{l=2}^{l_{max}} \sum_{m=0}^l \left(\frac{a}{r}\right)^l \bar{P}_{lm}(\sin\Phi') (\bar{C}_{lm} \cos m\lambda + \bar{S}_{lm} \sin m\lambda) \right) \quad (3.33)$$

ku paraqesin:

- $V$  – Potenciali gravitacional ( $\frac{m^2}{s^2}$ ),
- $GM$  – Konstanta e gravitetit të Tokës,
- $r$  – Distanca nga qendra e masës së Tokës,
- $a$  – Gjysmë boshti kryesor i elipsoidit referent,
- $l, m$  – Shkalla dhe rendi,

$\varphi'$  – Gjerësia gjeocentrike

$\lambda$  – Gjatësi gjeocentrike, gjatësi gjeodezike,

$\bar{C}_{lm}, \bar{S}_{lm}$  – Koeficientet e normalizuar të gravitetit.

$\bar{P}_{lm}(\sin\Phi')$  – Funkzioni i normalizuar i shoqëruar Lazhandrian (Legendre):

$$= \left[ \frac{(l-m)!(2l+1)k}{(l+m)!} \right]^{1/2} \bar{P}_{lm}(\sin\Phi') \quad (3.34)$$

$\bar{P}_{lm}(\sin\Phi')$  – Funkzioni i shoqëruar Legendre:

$$= (\cos\Phi')^m \frac{d^m}{d(\sin\Phi')^l} [\bar{P}_{lm}(\sin\Phi')] \quad (3.35)$$

$P_l(\sin\Phi')$  – Polinom Lazhandrian (Legendre):

$$= \frac{1}{2^l l!} \frac{d^l}{d(\sin\Phi')^l} (\sin\Phi' - 1)^l \quad (3.36)$$

$$= \begin{vmatrix} \bar{C}_{lm} \\ \bar{S}_{lm} \end{vmatrix} = \left[ \frac{(l+m)!}{(l-m)!(2l+1)k} \right]^{1/2} \begin{vmatrix} C_{lm} \\ S_{lm} \end{vmatrix} \quad (3.37)$$

ku:

$C_{lm}, S_{lm}$  – Koeficientet e harmonikës sferike.

Për  $m = 0, k = 1$

$m \neq 0, k = 2$

Si dhe potenciali i gravitetit normal  $U$  është ndërtuar duke përpunuar elipsoidin referent GRS80 me sipërfaqen ekuipotenciale (ekuacioni 3.17).

Dallimi në mes potencialit të gravitetit  $W$  dhe potencialit të gravitetit normal  $U$  në pikën  $P$  quhet potencial anomalik ose potencial shqetësues  $T$ , i cili luan rol të rëndësishëm (Heiskanen & Moritz, 1967):

$$T = W - U \quad (3.38)$$

### 3.5 Sipërfaqja referente e lartësive

Niveli mesatar i detit përafrohet gjeoidin, atë sipërfaqe të veçantë ekuipotenciale të fushës së gravitetit të Tokës që duhet të shërbejë si sipërfaqe referente globale e lartësisë.

Sipërfaqja referente mund të përcaktohet si një sipërfaqe mesatare me rezolucion që korrespondon me një model Global Gjeopotencial (p.sh.EGM96), një sipërfaqe e llogaritur nga filtrimi i thjeshtë i lartësive lokale të terrenit ose një sferë me lartësi përkatëse (Ameti, 2006).

Përdorimi i elipsoidit si sipërfaqe referuese për fushën e gravitetit është relativisht i kohëve të fundit. Nuk u përdor zyrtarisht deri në vitin 1930, kur Asambleja e Shoqatës Ndërkombëtare të Gjeodezisë në Stokholm miratoi formulën e gravitetit teorik (ekuacioni 3.39), i cili bazohet në një elipsoid të revolucionit (Heiskanen & Moritz, 1967).

Me poshtë paraqesim formulën internacionale të gravitetit të miratuar si më lartë:

$$\gamma=978.0490(1+0.005\ 2884\ \sin^2\phi-0.000\ 0059\ \sin^22\phi)\ \text{gal} \quad (3.39)$$

Sipërfaqet korresponduese të sipërfaqes referente  $U = U_0$  quhen sferoidet e Tokës.

Në sipërfaqe:

$$U'(x, y, z) = U_0 \quad (3.40)$$

që dihet si sferoid i Brunsit, kurse sipërfaqja:

$$U''(x, y, z) = U_0 \quad (3.41)$$

është sferoidi i Helmertit.

Gjeoid është përdorur për të përshkruar lartësitë, për të vendosur gjeoidin si referencë për lartësitë, niveli i ujit të oqeanit është regjistruar në vendet bregdetare gjatë disa viteve duke përdorur matëset e valëve (mareografët). Mesatarja e regjistrimeve eliminon kryesisht ndryshimet e nivelit të detit me kohën. Niveli i ujit që rezulton përfaqëson një përafrim me gjeoidin dhe quhet niveli mesatar i detit (Knippers, 2009).

Gjeoidi, si një sipërfaqe referimi e përcaktuar fizikisht për lartësitë. Është me interes themelor për gjeo-shkencat dhe inxhinierinë. Përdoret për përshkrimin e topografisë kontinentale dhe të sipërfaqes së detit.

Pika P mund t'i atribuohet një sipërfaqeje të caktuar të nivelit nga potenciali i saj i gravitetit W (Figura 3.10). Në lidhje me gjeoidin potencialin  $W_0$ , "lartësia" P jepet nga diferenca potenciale negative e gjeoidit, i cili quhet numri gjeopotencial C (Torge, 2001) siç edhe mund të shihen në figurën 3.10.

$$C = W_0 - W_p \quad (3.42)$$




Figura 3.10 Gjeoidi, niveli mesatar i detit, topografia kontinentale dhe sipërfaqja e detit (Torge, 2001)

Integrali është i pavarur nga rruga, prandaj PQ është një pikë arbitrare në gjeoid. C mund të përcaktohet nga nivelimi gjeometrik dhe matjet e gravitetit përgjatë çdo shtegu midis  $P_0$  dhe P (Torge, 2001).

$$C = \int_{P_0}^P dW = \int gdn \quad (3.43)$$

Një sipërfaqe referimi quhet gjeoid, ndërsa sipërfaqja tjetër e referencës është elipsoidi. Këto janë të ilustruara në figurën 3.11.




Figura 3.11 Sipërfaqja e Tokës dhe dy sipërfaqet referente të përdorura për ta përafëruar atë: gjeoidin dhe një elipsoid referent. Devijimi midis gjeoidit dhe një elipsoid referent quhet ndarje gjeoidale (N). (Knippers, 2009)


### 3.6 Niveli mesatar i detit

Siç dihet nga oqeanografia, niveli mesatar i detit nuk është një sipërfaqe ekuilibër në fushën e gravitetit të Tokës, për shkak të rrymave të oqeanit dhe efekteve të tjera kuazistacionare. Për më tepër, ndryshimet në sipërfaqen e detit me kohë mund të reduktohen vetëm pjesërisht nga mesatarja me kalimin e kohës ose nga modelimi. Prandaj, niveli mesatar i detit akoma ndryshon për një kohë më të gjatë dhe përkufizimi gjeoid duhet t'i referohet një epoke të caktuar të nivelit mesatar të detit (Torge & Muller, 2012). Mesatarja e sipërfaqes së oqeanit me kalimin e kohës (të paktën mbi një vit) ose




modelimi i baticave të oqeanit siguron nivelin mesatar të detit (MSL). Kurse r.m.s. ndryshimi i kësaj topografie mesatare dinamike të oqeanit është  $\pm 0.6\text{m}$  në  $\pm 0.7\text{m}$ , përveçse devijimi maksimal nga gjeoidi është rreth  $\pm 1\text{m}$  ose më shumë (Bosch et al., 2010). Niveli mesatar i detit mund të rrjedhë nga regjistrimet e matësve të valëve, altimetria satelitore dhe metodat oqeanografike (Torge & Muller, 2012).

Matësit e valëve (baticës-mareografët) regjistrojnë vazhdimisht lartësinë e nivelit të ujit në lidhje me një sipërfaqe referente të lartësive afër gjeoidit. Mesatarja e rezultateve në intervalet e gjata kohore (muaj, vit) eliminon shumicën e variacioneve me kohën. Në figuën 3.12, janë paraqitur të dhënat për matësin e valëve që janë të disponueshme për mbi 2000 stacione në të gjithë botën, por vetëm disa stacione mbulojnë një hapësirë kohore prej disa shekujsh (në regjistrimet e Amsterdemit kthehen në 1700).



**Figura 3.12** Përdorimi i matësve të valës për monitorim të sipërfaqes së detit (Jason-2r, 2008)

Altimetria satelitore siguron drejtpërdrejt topografinë e sipërfaqes së detit në lidhje me një sipërfaqe të referencës elipsoide, të cilat janë të ilustruara në figurën 3.13.



**Figura 3.13** Përdorimi i altimetrisë satelitore për monitorim të sipërfaqes së detit (Jason-2r, 2008)

Metodat oqeanografike nxjerrin topografinë e sipërfaqes së detit nga matjet në det (Rummel & Ilk, 1995). Nivelimi sterik supozon se sipërfaqet ekuipotenciale dhe izobarike përkojnë në një thellësi të caktuar (p.sh., 2000m): “nivel pa lëvizje”.

### 3.7 Sipërfaqja e elipsoidit

Nëse e zëvendësojmë gjeoidin me një elipsoid, atëherë koordinatat natyrale  $\varphi$ ,  $\lambda$ ,  $H$  janë zëvendësuar nga koordinatat gjeodezike  $\varphi$ ,  $\lambda$ ,  $h$ , të cilat janë definuar si në figurën 3.14 (Moritz, 1980).




Figura 3.14 Elipsoidi referent dhe koordinatat gjeodezike (Moritz, 1980)

Një elipsoid i revolucionit, është i gjeneruar nga rrotullimi i një elipsoidi rreth gjysmë boshteve a dhe b në lidhje me boshtin e vogël është i vendosur në qendrën e saj në gjeoqendër në atë mënyrë që boshti i vogël përkon me aksin z. Një pikë hapësinore P është projektuar me anë të vijës së drejtë normale në elipsoid, në elipsoid kjo jep pikën Q. Segmenti i drejtë QP paraqet lartësinë gjeodezike h, si dhe koordinatat gjeografike elipsoidale të pikës Q janë gjerësia gjeodezike  $\varphi$  dhe gjatësia gjeodezike  $\lambda$  e pikës P (Moritz, 1980).

Sistemi  $(\varphi, \lambda, h)$  është i lidhur me sistemin  $(x, y, z)$  sipas formulave (Moritz, 1980):

$$x = (v + h) \cos\varphi \cos\lambda \quad (3.44)$$

$$y = (v + h) \cos\varphi \sin\lambda \quad (3.45)$$

$$z = \left( \frac{b^2}{a^2} v + h \right) \sin \varphi \quad (3.46)$$

ku:

$$v = \frac{c}{\sqrt{1 + e'^2 \cos^2 \varphi}} \quad (3.47)$$

$$c = \frac{a^2}{b} \quad (3.48)$$

$$e'^2 = \frac{a^2 - b^2}{b^2} \quad (3.49)$$

ku:

v – është rrezja transversale e lakimit të elipsoidit

c - është rrezja polare e lakimit,

$e'^2$  – quhet ekscentriciteti i dytë (numerik).

Gjerësa potenciali i gravitetit paraqitet (ekuacioni 3.17), është sipërfaqe ekuipotenciale W, është e qartë se edhe elipsoidi mund të jetë sipërfaqe ekuipotenciale për U:

$$U(x, y, z) = U_0 = \text{const} \quad (3.50)$$

në mënyrë që elipsoidi të bëhet elipsoid ekuipotencial, ose elipsoidi i nivelit.

ku:

U- duhet të jetë shuma:

$$U(x, y, z) = V(x, y, z) + \frac{1}{2} \omega^2 (x^2 + y^2) \quad (3.51)$$

e potencialit normal gravitacional V dhe potenciali centrifugal. V duhet të plotësojë ekuacionin e Laplace (Moritz, 1980).

$$\Delta V = 0 \quad (3.52)$$

jashtë elipsoidit dhe sillet përafërsisht në pafundësi si një pikë masë:

$$V = \frac{G\bar{M}}{r} + O\left(\frac{1}{r^2}\right) \text{ si } r \rightarrow \infty \quad (3.53)$$

ku:

$\bar{M}$  – duke shënuar masën totale të mbyllur nga elipsoidi.

Masën e elipsoidit e shprehim si:

$$G\bar{M} = \frac{E}{\arctang e'} \left( U_0 - \frac{1}{3} \omega^2 a^2 \right) \quad (3.54)$$

ku:

$$E = \sqrt{a^2 - b^2} \quad (3.55)$$

është ekscentriciteti linear:

$$e' = \frac{E}{b} \quad (3.56)$$

është ekscentriciteti i dytë (numerik) i elipsoidit (Moritz, 1980).


### **3.8 Sipërfaqja e gjeoidit**

Sipërfaqja e gjeoidit është definuar nga Gauss në vitin 1828 si sipërfaqe ekuipotenciale e fushës së gravitetit të Tokës në përputhshmëri me mesataren e nivelit të detit të oqeanëve. Si gjeoid ka marrë emrin nga Listing në vitin 1873. Sipërfaqja e gjeoidit përdoret më së shumti në sipërfaqen referente të lartësive për përshkrim kontinental, si dhe sipërfaqen topografike të detit (Torge & Muller, 2012). Gjeoidi është forma që sipërfaqja e oqeanit do të merrte nën ndikimin e gravitetit dhe rrotullimit të Tokës, vetëm nëse ndikimet e tjera të tilla si erërat dhe baticat do të mungonin. Sipërfaqja e gjeoidit është e parregullt, ndryshe nga elipsoidi referent (i cili është një përfaqësim matematikor i idealizuar i Tokës). Në një sipërfaqe të gjeoidit të gjitha pikat kanë të njëjtin potencial efektiv (shuma e energjisë potenciale gravitacionale dhe energjia potenciale centrifugale), ku forca e gravitetit vepron kudo pingul në gjeoid. Edhe pse ne përvetësojmë një përkufizim, kjo nuk do të thotë se jemi të përsosur në realizimin e këtij përkufizimi. Për shembull, lartësia shpesh përdoret për të përcaktuar "nivelin mesatar të detit" në oqeanë, por lartësia nuk është globale (mungojnë rajonet polare të afërta). Si e tillë, përshtatja midis nivelit "global" të nivelit të detit dhe gjeoidëve nuk është plotësisht e konfirmuar. Gjithashtu, mund të ketë ndryshime jo periodike në nivelin e detit (për shembull: si një rritje e vazhdueshme e nivelit të detit). Nëse është

kështu, atëherë "mesatarja e nivelit të detit" ndryshon në kohë dhe për këtë arsye edhe gjeoidi duhet të ndryshojë në kohë. Këto janë vetëm disa shembuj të vështirësisë në përcaktimin e "gjeoidit" (NOAA, 2001).

Sipërfaqja që më së shumti përdoret për përafrimin e formës së gjeoidit është harmonia sferike, si dhe grupi më i mirë i koeficienteve janë ato të EGM96 ( modeli i gravitetit të Tokës 1996), i cili është i përcaktuar nga një projekt i NGA dhe formulat që përdoren në këtë model janë të paraqitura (ekuacioni 3.33).

Le të jetë P një pikë e sipërfaqes së dukshme të Tokës, të cilën e quajmë sipërfaqe topografike ose sipërfaqe fizike të Tokës (Moritz, 1980), e cila është paraqitur në figurën 3.15.



**Figura 3.15 Lartësia ortometrike H (Moritz, 1980).**

Vija e forcës që kalon përmes P kryqëzon gjeoidin në një pikë  $P_0$ . Gjatësinë e segmentit të vijës pingule (pak e lakuar)  $P_0P$  e quajmë lartësi ortometrike H.

Koordinatat  $(\varphi, \lambda, H)$  paraqesin koordinatat natyrale të pikës P, të cilat formojnë një sistem të koordinatave të vijave të lakuara të përcaktuara në lidhje me fushën e gravitetit.

Një definicion i koordinatave natyrale është  $(\varphi, \lambda, W)$ , pasi që potenciali W i pikës P mund të vlerësohet si masë fizike e lartësisë së pikës P. Kjo është veçanërisht e dukshme nëse marrim parasysh numrin gjeo-potencial:

$$C = W_0 - W \quad (3.57)$$

që lidhet lehtësisht me H, por është konceptuali më i thjeshtë (Moritz, 1980).

Distanca në mes të pikës  $P_G$  në gjeoid dhe pikës projektuese  $P_Q$  në elipsoid përmes vektorit  $(\gamma)$  normal është quajtur valëzim i gjeoidit (Figura 3.16).




Figura 3.16 Valëzimi i gjeoidit në lidhje me elipsoidin referent (Dantor, 2006).

Valëzimi i gjeoidit është i lidhur me potencialin shqetësues  $T$  në bazë të formulës së Brunssit (Heiskanen & Moritz, 1967):

$$N = \frac{T_{(geoid)}}{\gamma_{(EU)}} \quad (3.58)$$

### 3.8.1 Formulimi i problemit të vlerës kufitare në sipërfaqen e Tokës

Problemi i vlerës së kufirit gjeodezik përfshin përcaktimin e sipërfaqes së Tokës dhe të gravitetit të saj të jashtëm nga vëzhgimet në ose afër sipërfaqes së Tokës. Sipërfaqja që do të përcaktohet është ose gjeoidi (problemi Stokes) ose sipërfaqja fizike e Tokës dhe kuazi-gjeoidi (problemi Molodensky), (Torge & Muller, 2012).

Problemet e Stokes dhe Molodensky kanë të bëjnë me të dhënat e dhëna në një sipërfaqe (gjeoidi dhe sipërfaqja fizike e Tokës), e cila është një kufi për rajonin jashtë kësaj sipërfaqeje. Këto janë probleme me vlera kufitare gjeodezike (Moritz, 1980).

Në gjeodezinë moderne, kur kemi të bëjmë me matje që mund të jenë jashtë dhe/ose në sipërfaqen e Tokës, problemet e vlerës së kufirit gjeodezik kanë të bëjnë me përcaktimin e potencialit të gravitetit brenda dhe jashtë sipërfaqes së Tokës nga të dhënat e parformuara brenda dhe jashtë sipërfaqes së Tokës (Ameti, 2006).

### 3.8.2 Vlerësimi i anomalisë së gravitetit të Helmertit

Graviteti i Helmertit në gjeoidin  $g_g^h$ , i nevojshëm për të mbledhur anomalinë e Helmertit, merret duke shndërruar fillimisht gravitetin sipërfaqësor të vëzhguar në modelin Helmert dhe pastaj duke e zvogëluar atë (akoma në modelin Helmert) mbi gjeoidin. Matematikisht, transformimi i gravitetit aktual, i korrigjuar për efektin e

tërheqjes atmosferike, në gravitetin e Helmertit  $g_g^h$  arrihet duke marrë gradientin e ekuacionit (3.59), domethënë (Vanicek & Martinec, 1994).

$$W^h = W - \square T^* - V \quad (3.59)$$

ku  $\square T^*$  është ndryshimi midis T dhe T\*, d.m.th., potenciali i gravitetit të atmosferës.

$$g_g^h \square \square \square \text{grad} \square W \square \square \square T^* \square V \square \square \square \quad (3.60)$$

Kjo është e barabartë me:

$$g_g^h \square \square g^* \square \frac{\partial V}{\partial H} \square \square O\left(\frac{1}{2} \text{grad}^2 \frac{V}{g^*}\right) \quad (3.61)$$

ku:

termi i fundit në anën e djathtë do të jetë patjetër më i vogël se 1  $\mu\text{Gal}$  sepse  $|\text{grad}(V)|$  është sigurisht më i vogël se 40 mGal. Termi i fundit atëherë mund të neglizhohet në mënyrë të sigurtë. Për transformimin e gravitetit sipërfaqesor, derivati në këtë ekuacion vlerësohet qartë në sipërfaqen e Tokës, ku më pas quhet efekti i drejtpërdrejtë topografik mbi gravitetin (Heiskanen & Moritz, 1967).

Reduktimi i gravitetit të Helmertit në sipërfaqen  $g_t^h$  mbi gjeoidin (bërë në modelin e Helmertit) mund të arrihet duke zhvilluar gravitetin sipërfaqesor në një seri Taylor:

$$g_g^h \square \square g_t^{h*} \square \frac{\partial^2 W^h}{\partial H^2} \Big|_H + \frac{\partial^3 W^h}{\partial H^3} \Big|_H + \dots \quad (3.62)$$

Në literaturë ky proces quhet vazhdimi në rënie i gravitetit (Helmert) (Vanicek & Martinec, 1994).

### 3.8.3 Vazhdimi në rënie i anomalive të gravitetit Helmert në gjeoid

Anomalitë e gravitetit në gjeoid janë të nevojshme si hyrje për llogaritjen e gjeoidit. Pas transformimit të anomalive të gravitetit në sipërfaqen topografike nga hapësira reale në hapësirën Helmert, duhet të vazhdojnë deri në gjeoide në hapësirën e Helmertit. Vazhdimi lart është përshkruar nga integruesi Poisson (Heiskanen & Moritz, 1967). Kjo është një formulë për vazhdimin lart të funksioneve harmonike nga një sferë me rrezin R. Integrali Poisson për anomalitë e gravitetit është dhënë (Kellogg, 1929):

$$\Delta g^h(r_t, \Omega) = \frac{R}{4\pi r_t(\Omega)} \iint K[r_t(\Omega), \psi(\Omega, \Omega'), R] \Delta g^h(r_g, \Omega') d\Omega' \quad (3.63)$$

ku:

$K[r_t(\Omega), \psi(\Omega, \Omega'), R]$ -është bërthama integrale sferike Poisson.

Kur kërkohet një vazhdim në rënie, ekuacioni (3.63) është përmbysur, duke dhënë një integral të (eng. Fredholm) llojit të parë. Mund të rishkruhet si një ekuacion integral, zgjidhja e të cilit kërkohet përmes diskretizimit që çon në një sistem ekuacionesh lineare. Në formën e matrica-vektorit, mund të paraqitet si mëposhtë (Klu, 2015):

$$\Delta g^h(r_t, \Omega) = K[r_t(\Omega), \psi(\Omega, \Omega'), R] \Delta g^h(r_g, \Omega') \quad (3.64)$$

ku:

$\Delta g^h(r_t, \Omega)$  - është vektori i anomalive të gravitetit referuar sipërfaqes së tokës,  $\Delta g^h(r_g, \Omega')$  - vektori i anomalive të gravitetit referuar sipërfaqes gjeoide dhe  $K[r_t(\Omega), \psi(\Omega, \Omega'), R]$  - është matrica e vlerave të bërthamës integrale Poisson shumëzuar me elementet e mbetur në anën e djathtë të ekuacionit (3.63) (Klu, 2015).

Kështu vazhdimi në rënie anasjelltas i ekuacionit (3.63), d.m.th. siguron vlerat e anomalive të gravitetit në gjeoide duke pasur parasysh anomalitë e gravitetit në topografi. Si rezultat, nga operacioni i anasjelltë, vazhdimi në rënie i Poisson-it duhet të jetë numerikisht i paqëndrueshëm (Klu, 2015).

### **3.8.4 Integrimi i Stoks-it në zgjidhjen e problemit të vlerës së kufirit**

Pas transformimit të anomalive të gravitetit (Helmert) nga sipërfaqja e tokës në gjeoide, anomalitë e gravitetit shndërrohen në (Helmert) potencial shqetësues T. Potenciali shqetësues Helmert është ndryshimi midis potencialit të gravitetit Helmert në bashkë-gjeoid dhe potencial normal në elipsoidin e referencës. Anomalitë e gravitetit shndërrohen në potenciale shqetësuese përmes ekuacionit themelor të gravimetrisë. Ky potencial shqetësues shndërrohet në lartësi gjeoidale përmes formulës së Brunsit treguar në ekuacionin (3.58). (Klu, 2015).

Ky përafrim nga formula e Brunsit tregon që N mund të llogaritet nëse mund të gjendet një shprehje për T. Një zgjidhje e saktë sferike gjendet duke përdorur funksionet e gjelbërta për një sferë, e cila zëvendësohet në integralin e Stokes, japin anomali të gravitetit transformues në gjeoid në potencial shqetësues duke përdorur integralin e Stokes si në ekuacionin (3.66) (Heiskanen & Moritz, 1967).



### 3.8.5 Shndërrimi i lartësive gjeoidale nga hapësira e Helmertit në hapësirën reale

Vlerësimi i problemit të vlerës së kufirit të Stokes në hapësirën Helmert rezulton në një sipërfaqe ekuipotenciale të quajtur bashkë-gjeoide Helmert. Për të gjetur gjeoidin në hapësirën reale do të kërkoj një vlerësim të efektit primar indirekt topografik (PITE) dhe efektit primar indirekt atmosferik (PIAE). Transformimi arrihet duke shtuar PITE dhe PIAE në bashkë-gjeoidin e Helmertit si (Klu, 2015):

$$N = \text{Helmert } C_0 - \text{geoid} + \frac{SV'(R, \Omega)}{\gamma_0(\Phi)} + SN^a(\Omega_g) \quad (3.65)$$

ku:

$$\frac{SV'(R, \Omega)}{\gamma_0(\Phi)} - \text{është PITE}$$

$$SN^a(\Omega_g) - \text{është PIAE}$$

N - është ndarja gjeoide.

### 3.8.6 Funkzioni Stokes

Përcaktimi i gjeoidit duke përdorur formulën e Stokes kërkon që të gjitha masat topografike të hiqen në një shtresë mbi ose poshtë gjeoidit. Për të përmbushur këtë gjendje që anomalitë e gravitetit duhet t'i referohen gjeoidit, është e nevojshme të zvogëlohen anomalitë e gravitetit tokësor nga sipërfaqja e Tokës në gjeoid (Guo et al., 2019).

Përcaktimi i formulës së Stokes bëhet në bazë të zgjedhjes së ekuacionit të Laplace  $\Delta T=0$  subjekt i kushtit kufitar:

$$T_P = \frac{R}{4\pi} \iint_{\sigma} \Delta g_Q S(\psi) d\sigma \quad (3.66)$$

ku:

pika P është pika në të cilën llogaritet pika T dhe pika Q është pikë variabël në të cilën i referohet  $\Delta g$  (Moritz, 1980), siç edhe mund të shihet sipas paraqitjes grafike në figurën 3.17.




Figura 3.17 Elipsoid referencë dhe sfera e njësive (Moritz, 1980)

Simboli  $\sigma$  tregon një sferë njësi, qendra e së cilës mund të merret që të përkojë me qendrën e elipsoidit. Pikat P dhe Q janë të hartuara në pikat  $\bar{P}$  dhe  $\bar{Q}$  në sferën  $\sigma$  në atë mënyrë që rrezet në pikë  $\bar{P}$  dhe  $\bar{Q}$  janë paralele me pikat normale elipsoidale në P dhe Q. Koordinatat sferike (gjatësia dhe gjerësia) e pikës  $\bar{P}$  dhe  $\bar{Q}$  janë identike si koordinata gjeodezike  $\varphi, \lambda$  të P dhe  $\varphi', \lambda'$  të Q. Elementi i sipërfaqes  $d\sigma$  të sferës së njësive jepet si ekuacioni i mëposhtëm: (Moritz, 1980).

$$d\sigma = \cos\Phi' d\Phi' d\lambda' \quad (3.67)$$

Kurse funksioni  $S(\psi)$  ka këtë formë:

$$S(\psi) = \left(\sin\frac{\psi}{2}\right)^{-1} - 6\sin\frac{\psi}{2} + 1 - 5\cos\psi - 3\cos\psi \ln\left(\sin\frac{\psi}{2} + \sin^2\frac{\psi}{2}\right) \quad (3.68)$$

ku sipas formulave të Stokes rezultojnë që lartësia gjeoidale paraqitet në këtë formë:

$$N_P = \frac{R}{4\pi\gamma} \iint_{\sigma} \Delta g_Q S(\psi) d\sigma \quad (3.69)$$

ku:


$\gamma$  mund të zhvendoset nga një vlerë mesatare globale siç është 980 gal dhe  $S(\psi)$  është integrali thelbësor Kerneli Stokes.

Formula e Stokes ose Integrali Stokes është formula më e rëndësishme në gjeodezinë fizike, për arsye që e bën të mundur përcaktimin e gjeoidit nga të dhënat e gravitetit.

Formula e Stokes supozon se anomalia e gravitetit  $\Delta g_Q$  të jepet në çdo pikë të elipsoidit. Gjithashtu mund të nxirret si një zgjidhje e ekuacionit integral nëse aplikohet në gjeoid.

Funksioni Stokes  $S(\psi)$  vepron si një funksion peshimi në anomalitë e gravitetit. Varet nga distanca sferike  $\psi$  midis pikës së llogaritjes dhe elementit sipërfaqësor të  $d\sigma$  me anomalinë e gravitetit  $\Delta g$ .  $S(\psi)$  zvogëlohet me  $\psi$  deri në një zero të parë në  $\psi = 39^\circ$ ,

dhe pastaj lëkundet me vlera të mëdha deri  $\psi=180^\circ$  (Figura 3.18). Lagjja e pikës (ang. neighborhood points) së llogaritur kërkon vëmendje të veçantë, pasi  $S(\psi)$  bëhet i pafund në  $\psi=0^\circ$  (Torge, 2001), siç edhe tregohet në figurën 3.18.



**Figura 3.18** Funksioni original dhe i modifikuar i Stokes (Torge, 2001).

Në (ekuacionin 3.37) janë paraqitur edhe koeficientet e Stokes të harmonikës sferike (Torge, 2001):

$$C_{l0} = C_l = \frac{1}{M} \iiint_{earth} \left(\frac{r}{a}\right)^l P_l(\cos \vartheta) dm \text{ për } m = 0 \text{ dhe} \quad (3.70)$$

$$\begin{cases} C_{lm} \\ S_{lm} \end{cases} = \frac{2}{M} \frac{(l-m)!}{(l+m)!} \iiint_{earth} \left(\frac{r}{a}\right)^l P_{lm}(\cos \vartheta) \begin{cases} \cos m\lambda' \\ \sin m\lambda' \end{cases} dm \text{ për } m \neq 0$$

Duke krahasuar me formulën e Stokes ne gjejmë që funksioni i Stokes mund të shprehet si një seri polinomesh Lazhandrian (Legendre).

$$S(\psi) = \sum_{n=2}^{\infty} \frac{2n+1}{n-1} P_n(\cos \psi) \quad (3.71)$$

Për të fituar gjeoidin, lartësia ko-gjeoide duhet të shndërrohet nga hapësira e Helmeritit përsëri në hapësirën reale. Ky transformim bëhet duke vlerësuar efektin primar indirekt topografik në lartësinë gjeoide sipas ekuacionit të mëposhtëm (Torge & Muller, 2012):

$$\delta N = \frac{\delta V}{\gamma} \quad (3.72)$$

Ku  $\delta V$  është potenciali i mbetur gravitacional i masave topografike, i cili llogaritet në gjeoid. Paraqitja grafike e të cilës është dhënë në figurën 3.19.




Figura 3.19 Gjeoid dhe bashkë-gjeoidi (Torge, 2001)

Atëherë mund të llogaritet gjeoidi (Torge, 2001):

$$N = N_c + \delta N \quad (3.73)$$

ku:

$\delta N$  paraqet distancën vertikale në mes gjeoidit dhe bashkë-gjeoidin duke iu referuar teorisë Bruns (ekuacioni 3.58).


Dhe  $N_c$  paraqet llogaritjen e lartësisë së bashkë-gjeoidit sipër elipsoidit, si një zgjidhje e problemit me vlerën e kufirit gravimetrik.

Kurse anomalia e gravitetit  $\Delta g^H(r_t, \Omega)$  sipas Helmertit duke iu referuar sipërfaqes së Tokës është dhënë nga:

$$\Delta g^H(r_t, \Omega) = g^H(r_t, \Omega) - \gamma(H^H(\Omega)) \quad (3.74)$$

ku:

$\gamma(H^H(\Omega))$ - është graviteti normal në telluroid në hapësirën e Helmertit. Edhe graviteti i Helmertit  $g^H(r_t, \Omega)$  në sipërfaqen e Tokës është përfituar nga graviteti i vrojtuar  $g(r_t, \Omega)$  duke shtuar efektin e drejtpërdrejtë topografik dhe efektin e drejtpërdrejtë atmosferik (Tenzer & Janak, 2002), siç edhe mund të shihet në figurën 3.20.



**Figura 3.20** Sasitë në hapësirën reale dhe në hapësirën e Helmertit (Tenzer & Janak, 2002)

### 3.8.7 Anomalia ajër – lirë

Anomalia e gravitetit të ajrit të lirë, shpesh e quajtur thjesht anomali e ajrit të lirë, është anomali e gravitetit të matur pasi të bëhet një korrigjim i ajrit të lirë për të korrigjuar për lartësimin, në të cilin bëhet një matje. Korrigjimi i ajrit të lirë e bën këtë duke rregulluar këto matje të gravitetit në atë që do të ishte matur në një nivel reference. Për Tokën, ky nivel referencë zakonisht merret si niveli mesatar i detit.

Për një ulje teorikisht korrekte të gravitetit në gjeoid, na duhet gradienti vertikal i gravitetit. Nëse  $g$  është vlera e vëzhguar në sipërfaqen e tokës, atëherë vlera  $g_0$  në gjeoid mund të merret si një zgjerim i Taylor-it (Hofman-Wellenhof & Moritz, 2005):

$$g_0 = g - \frac{\partial g}{\partial H} H \dots \quad (3.75)$$

ku:


$H$  - është lartësia në mes stacionit të gravitetit mbi gjeoid  $P$  dhe pika përkatëse në gjeoide  $P_0$ . Supozimi se nuk ka masë mbi gjeoid dhe duke lënë pas dore të gjitha termat, përveç asaj lineare, atëherë kemi:

$$g_0 = g + F \quad (3.76)$$

ku:

$$F = -\frac{\partial g}{\partial H} H \quad (3.77)$$

është reduktimi i “ajër të lirë” në gjeoid. Paraqitja grafike e reduktimit të gravitetit mund të shihet në figurën 3.21.



**Figura 3.21 Reduktimi i gravitetit (Heiskanen & Moritz, 1967)**

Nëse në vend të gradientit normal të gravitetit  $\frac{\partial g}{\partial H}$  lidhet me lartësinë elipsoidale  $h$ , përfitojmë  $\frac{\partial \gamma}{\partial h}$  (Hofman-Wellenhof & Moritz, 2005):

$$F = -\frac{\partial \gamma}{\partial h} H = +0.3086H \text{ [mgal]} \quad (3.78)$$

Anomalia e gravitetit të ajrit të lirë  $g_F$  jepet nga ekuacioni (Fowler, 2005):

$$g_F = g_{obs} - g_\lambda - \delta_{gF} \quad (3.79)$$


Kurse korrigjimi i ajrit të lirë është sasia që duhet t'i shtohet një matje në lartësinë  $h$  për ta korrigjuar atë në nivelin e referencës (Fowler, 2005):

$$\delta_{gF} = \frac{2g}{R} \times h \quad (3.80)$$

### 3.8.8 Anomalia Bouguer

Objektivi Bouguer është zvogëlimi i gravitetit që është heqja e plotë e masave topografike, d.m.th., masat jashtë gjeoidit (Heiskanen & Moritz, 1967).

Sipas (Heiskanen & Moritz, 1967) pllaka Bouguer paraqitet si në vazhdim. Duke supozuar që zona përreth stacionit të gravitetit P të jetë plotësisht e sheshtë dhe horizontale dhe lejon që masat midis gjeoidit dhe sipërfaqes së Tokës të kenë një dendësi konstante  $\rho=2.67\text{g/cm}^3$ . Atëherë tërheqja A e kësaj pllake Bouguer të shoqëruar fitohet duke lënë  $a \rightarrow \infty$ , siç edhe mund të shihet në figurën 3.22, pasi pllaka mund të konsiderohet si një cilindër rrethor me trashësi  $b=h$  dhe rreze të pafundme.



**Figura 3.22 Pllaka Bouguer (Heiskanen & Moritz, 1967).**

Nga rregullat e njohura të llogaritjes e marrim si tërheqja e një pllake të pafund Bouguer, ku G paraqet konstantën e gravitetit,  $\rho$  është dendësia e pllakës së pafundme të shkëmbit midis lartësisë h dhe nivelit të detit, marrim G nga (ekuacioni 3.3) dhe duke supozuar një dendësi konstante, korigjimi i Bouguer-it është  $1.1 \times 10^{-6} \text{ m/s}^2$  për metër lartësi (Geology.cwu.edu).

$$A_B = 0.1119h \text{ mgal} = 0.1119 \text{ mGal } m^{-1} \quad (3.82)$$

Për të përfunduar uljen e gravitetit, duhet të ulim stacionin e gravitetit nga P në gjeoid, në Po. Kjo bëhet duke aplikuar uljen e ajrit të lirë sepse pas heqjes së topografisë, stacioni P është në “ajër të lirë”. Dhe këtë e quajmë reduktim i kompletuar i Bouguer-it (Heiskanen & Moritz, 1967).

Rezultati është graviteti i Bouguer-it në gjeoid:

$$g_B = g - A_B + F \quad (3.83)$$

Sipas vlerave të supozuara numerike:

$$g_B = g + 0.1967H \quad (3.83)$$

Anomalitë Bouguer janë të përdorura për kërkime rajonale dhe lokale, pasi ato janë të lira nga efekti i topografisë. Ato kryesisht reflektojnë anomali të densitetit në koren dhe mantelin e sipërme dhe mund të lidhen me struktura tektonike siç janë kreshtat e oqeanit, kanalet e detit të thellë, malet e reja dhe me strukturat e sipërme të mantelit (Torge, 2001), siç edhe mund të shihet në figurën 3.23.




Figura 3.23 Korrigjimi i terrenit (Heiskanen & Moritz, 1967).

Anomalia Bouguer paraqet tërheqjen gravitacionale të materialit nën nivelin e detit. Anomalia Bouguer  $g_B$  është e lidhur me gravitetin e vërtetuar  $g_{obs}$  si në vazhdim (Bernard & Helmut, 2005):

$$g_B = g_{obs} - g_\lambda - \delta_{gF} - \delta_{gB} + \delta_{gT} \quad (3.84)$$

$$g_B = g_F - \delta_{gB} \quad (3.85)$$

ku:

$g_B$ - anomalia e Bouguer,

$g_{obs}$  - graviteti i vërtetuar,

$g_\lambda$  - korrigjimi i gjerësisë (sepse Toka nuk është një sferë e përsosur),

$\delta_{gF}$ - korrigjimi i ajrit të lirë,

$\delta_{gB}$ - korrigjimi Bouguer, i cili lejon tërheqjen gravitacionale të shkëmbinjve midis pikës së matjes dhe nivelit të detit,

$\delta_{gT}$  - është një korrigjim i terrenit, i cili lejon devijime të sipërfaqes nga një plan i pafundmë horizontal,

$g_F$  - anomalia e gravitetit të ajrit të lirë.



### 3.8.9 Anomalitë e lartësive

Anomalia e lartësive  $\zeta(\lambda, \varphi)$  përafrim i njohur i valëzimit të gjeoidit duke u bazuar sipas teorisë së Molodensky-it mund të përcaktohet distanca nga sipërfaqja e Tokës deri te pika  $U$ , ku potenciali normal ka të njëjtën vlerë si gjeopotenciali  $W$  në sipërfaqen e Tokës (Molodensky et al., 1962; Hofmann-Wellenhof & Moritz, 2005; Moritz, 1989):

$$W(h_t, \lambda, \varphi) = U(h_t - \zeta, \lambda, \varphi) \quad (3.86)$$

ku:

$h_t$  – është lartësia elipsoidale në sipërfaqen e Tokës.

Në figurën 3.24. është paraqitur pozicioni gjeometrik. Sipërfaqja me lartësinë  $\zeta = \zeta(\lambda, \varphi)$  në lidhje me elipsoidin është quajtur shpesh kuazi-gjeoid dhe sipërfaqja  $h_t$  është quajtur telluroid. Duke theksuar që kuazi-gjeoidi nuk ka kuptim fizik, por është një përafrim i gjeoidit.

Në sipërfaqen ku:  $h_t = N$  (ose  $H = 0$ ) do të thotë mbi sipërfaqen e detit, kuazi-gjeoidi përkon me gjeoidin siç mund të shihet nga ekuacioni (3.67). Nëse do të përdorim (ekuacioni. 3.20) (Barthelmes, 2009):

$$W(N + H, \lambda, \varphi) = U(N + H - \zeta, \lambda, \varphi) \quad (3.87)$$

Shënojmë  $H = 0$ , atëherë do të kemi (Barthelmes, 2009):

$$W(N, \lambda, \varphi) = U(N - \zeta, \varphi) \quad (3.88)$$

Nëse përdorim ekuacionin:

$$W(h=N(\lambda, \varphi), \lambda, \varphi) = U((h=0, \varphi) = U_0 \quad (3.89)$$

atëherë përcaktimi i gjeoidit do të jetë (Barthelmes, 2009):

$$U(0, \varphi) = U(N - \zeta, \varphi) \quad (3.90)$$

nga e cila do të kemi (Barthelmes, 2009):

$$N = \zeta \text{ për } H = 0 \quad (3.91)$$




Figura 3.24 Raporti në mes të elipsoidit, gjeoidit dhe anomalisë së lartësive  $\zeta$  (Barthelmes, 2009).

Ekuacioni (3.86) nuk është i kufizuar në lartësi  $h=h_t$  në sipërfaqen e Tokës, kështu që një anomali e lartësisë e përgjithësuar:  $\zeta_g = \zeta_g(h, \lambda, \varphi)$  për lartësitë arbitrare  $h$  mund të përcaktohet si (Barthelmes, 2009), siç edhe mund të shihen në figurën 3.24.

$$W(h, \lambda, \varphi) = U(N - \zeta_g, \varphi) \quad (3.92)$$

### 3.9 Sipërfaqja e kuazi-gjeoidit

Fakti që dendësia topografike nuk njihej me një saktësi adekuate që në vitet 1960 (dhe ky problem vazhdon të mbetet edhe sot) bëri që Molodensky ta deklarojë gjeoidin të pamundur për të përcaktuar në një saktësi të mjaftueshme dhe për të futur një sasi alternative të njohur si kuazi-gjeoid (Molodenskii et al., 1960; Vanicek et al., 2012). Një paraqitje e pasqyrimin të topografisë sipas kuazi-gjeoidit është dhënë në figurën 3.25.




Figura 3.25 Pasqyrimi i topografisë sipas kuazi-gjeoidit (Heiskanen & Moritz, 1967).

### 3.9.1 Teoria Molodensky

Molodensky prezantoi kuazi-gjeoidin si një sipërfaqe referimi në lartësi që mund të përcaktohet nga graviteti i vërejtur pa miratuar asnjë hipotezë në lidhje me densitetin topografik. Ky koncept është përdorur gjerësisht në aplikimet gjeodezike sepse ndryshimet midis gjeoidit dhe kuazi-gjeoidit janë kryesisht deri në disa centimetra, përveç rajoneve malore (Tenzer & Foroughi, 2018).

Zgjatja e lartësive normale poshtë nga sipërfaqja e Tokës jep kuazi-gjeoidin, siç edhe mund të shihen në figurën 3.26.




Figura 3.26 Paraqitja e kuazi-gjeoidit, gjeoidin dhe elipsoidin (Tenzer & Foroughi, 2018)

Sipas teorisë Bruns lartësia e gjeoidit  $N$  është definuar (ekuacioni 3.58). Kurse Molodensky e definoi lartësinë e kuazi-gjeoidit si në vazhdim:

$$\zeta = \frac{T_t}{\gamma_Q} \quad (3.93)$$

ku:

$T_t$  është potenciali shqetësues në sipërfaqen topografike dhe  $\gamma_Q$  është graviteti normal në telluroid.

Telluroidi është sipërfaqja ku potenciali normal  $U$  në çdo moment  $Q$  është e barabartë me potencial aktual  $W$  në pikën korresponduese  $P$ , kështu që  $U_Q = W_P$ , pikat përkatëse  $P$  dhe  $Q$  janë të vendosura në të njëjtin elipsoid normal.

Përcaktimi i sipërfaqes së Tokës nga anomalitë e gravitetit mbi të janë një problem derivativ i zhdrejtë i quajtur problemi i Molodensky-t.

Reduktimi i gravitetit dhe masat që zhvendosen në gjeoide do të ndikojnë ose ndryshojnë vetë gjeoidin, i cili quhet efekt indirekt. Kështu që gjeoidi që llogaritet nga

integrali i Stokes është me pak ndryshim nga vetë gjeoidi, por do të marrim një sipërfaqe, e cila quhet bashkë-gjeoide (Kahar, 2004).

Për të zgjidhur problemin e zvogëlimit të gravitetit, Molodensky propozoi një qasje që valëzimi i gjeoidit përcaktohet duke përdorur të dhëna të anomalive të gravitetit në sipërfaqen e Tokës.

### **3.9.2 Teknika remove-restore (heqjes-rivendosjes) në përcaktimin e gjeoidit**

Modelet e gjeoidit dhe kuazi-gjeoidit janë dhënë në formën e rrjetit të valëzimit. Llogaritja e valëzimit është bërë duke përdorur gravitetin dhe të dhënat e terrenit, si dhe një shkallë të lartë globale në modelin harmonik sferik sipas procedurës apo teknikës remove-restore.

Teknika e heqjes-rivendosjes ka gjetur aplikim në atë moment kur modelet globale gjeopotenciale sigurojnë pjesë me valë të gjatë të fushës së gravitetit dhe të dhënat e gravitetit të dendur në shumë rajone, si dhe modelet e lartësisë dixhitale me rezolucion të lartë (Torge, 2001).

Aplikimi i teknikës së heqjes-rivendosjes përfshin këto etapa (Forsberg&Tscherning, 1981; DENKER et al. 1986),:

Reduktimi i anomalive të gravitetit  $\Delta g$  nga pjesa anomali e modelit global  $\Delta g_M$ ,

Zbutja e anomalive nga një lloj zvogëlimi i terrenit  $\Delta g_T$ ,

Gridi i anomalive të gravitetit të mbetur:

$$\Delta g_{res} = \Delta g - \Delta g_M - \Delta g_T \quad (3.94)$$

Zbatimi i formulës së Stokes (3.69) në anomalitë e gravitetit të mbetur, duke rezultuar në lartësitë e mbetura gjeoide  $N_{res}$ .

Rivendosja e efekteve të modelit global dhe terrenit në lartësitë e mbetura gjeoide:

$$N = N_{res} + N_M + N_T \quad (3.95)$$

Teknika e heqjes-rivendosjes gjithashtu mund të aplikohet në devijimet e vertikalitetit ose të ndonjë sasive tjetër të fushës së gravitetit. Është përdorur me sukses edhe me kolokimin më pak të shesheve por për modelimin e gjeoidit në shkallë të gjerë, formulat integrale së bashku me FFT (Transformimi i shpejtë i Furierit) është e vetmja teknikë e zbatueshme deri më tani.

Kuazi-gjeoidi gjithashtu mund të përcaktohet me teknikën e heqjes-rivendosjes, e cila shkon përsëri në metodën e dwc (mbledhja e ujit të thellë) analitik të anomalisë së gravitetit në nivelin e detit (Bjerhammar, 1962 & 1963). Dallimi kryesor në përcaktimin gjeoid është që formula e Stokes zëvendësohet me formulën e zgjatur të Stokes S ( $r_p$ ,  $\psi$ ) (Heiskanen & Moritz, 1967). Formula që rezulton për anomalinë e lartësisë ( $\zeta$ ) bëhet:

$$\begin{aligned} \zeta^{L,M} = & \frac{R}{4\pi\gamma} \iint_{\sigma_0} S^L(r_p, \psi) [\Delta g^M + \delta\Delta g_{dir}^T + \delta\Delta g_{dir}^a \\ & + \delta\Delta g^{dwc} + \delta\Delta g_{dir}^e] d\sigma \\ & + c \sum_{n=0}^M \left(\frac{2}{n-1}\right) \left(\frac{R}{r_p}\right)^{n+2} \Delta g_n^{EGM} + \delta\zeta_{dir}^{T,M} \\ & + \delta\zeta_l^T + \delta\zeta_l^a + \delta\zeta_l^e \end{aligned} \quad (3.96)$$

ku:

S, L ( $r_p$ ,  $\psi$ ) është formula e zgjatur, e modifikuar e Stokes (Sjöberg, 2013).

Lartësia e gjeoidit është e ndarë në tre (3) komponentë (Ameti, 2006).

$$N = \delta N^{GM} + \delta N^{Stokes} + \delta N^{DTM} \quad (3.97)$$

Por para aplikimit të Stokes, anomalia e gravitetit duhet të reduktohet për arsye të modelit gjeopotencial, si dhe të efektit topografik.

$$\Delta g = \Delta g^{GM} + \Delta g^{Stokes} + \Delta g^{DTM} \quad (3.98)$$

Teknika e heqjes-rivendosjes për përcaktimin e gjeoidit mund të formulohet si më poshtë:

$$N = \delta N^{GM} + \delta N^{RES} + \delta N^{DTM} \quad (3.99)$$

ku:

N valëzimin total të gjeoidit,

$\delta N^{GM}$  kontributi i modelit gjeopotencial global,

$\delta N^{RES}$  kontributi i fushës së mbetur,

$\delta N^{TOP}$  kontributi i efektit topografik.




Figura 3.27 Skema e heqjes-rivendosjes për llogaritjen e gjeoidit (Ameti, 2006)

Kontribut të madh në valëzimin e gjeoidit jep pjesa gjeopotenciale  $\delta N^{EGM}$ , e cila përaftron gjeoidin në shumicën e zonave të botës me një saktësi prej  $\approx \pm 1\text{m}$  në gjatësi vale deri në 100km (Ameti, 2006). Një paraqitje e saj edhe mund të shihet në figurën 3.27.

Principi i heqjes-rivendosjes ka vetëm dy kërkesa (Hofman-Wellenhop & Moritz, 2005):

1. Potencialet ndihmës të heqjes duhet të jenë harmonike, të paracaktuar dhe të përdoren në mënyrë të qëndrueshme matematike: ajo që hiqet në hyrje duhet të rivendoset në dalje.
2. Në rastin e zakonshëm të linearitetit, dy ose më shumë potenciale ndihmëse të ndryshme mund të përdoren (hiqen-rivendosen) njëkohësisht.

### **3.9.3 Sipërfaqja referencë e lartësisë së elementeve të përcaktuara dixhitale (DFHRS)**

Metoda e elementit të përcaktuar është përdorur për modelimin e një sipërfaqeje të referimit të lartësisë (HRS) në sipërfaqen e referencës së lartësisë së elementeve të përcaktuar dixhitale (DFHRS).

Projekti hulumtues i DFHRS në IAF i Hochschule Karlsruhe - Universiteti i Shkencave të Aplikuara synon të implementojë një modelim parametrik dhe llogaritjen e sipërfaqeve të referencës së lartësisë për përbërësit gjeometrikë dhe fizikë të vëzhgimit, në një qasje rregulluese hibride (DFHRS). Qasja në modelin parametrik HRS mundësohet nga bazat e të dhënave DFHRS (DFHRS-DB), të cilat lejojnë shndërrimin e drejtpërdrejtë të lartësive GNSS (h) në lartësi fizike (H). Bazat e të dhënave DFHRS përdoren për matjet në lartësi. Teknika e marrjes së të dhënave në kohë reale GNSS në rrjetet DGNSS (SAPOS, AXIONET etj.) dhe në Sistemet e Informacionit Gjeografik (GIS). DFHRS-DB janë llogaritur për shtete të ndryshme po ashtu edhe në Gjermani, si dhe për shumë kombe dhe rajone në Evropë, Afrikë dhe SHBA. Saktësia e rezultateve të marra ndryshon nga 0.01-0.1 metër (Jäger et al., 2006).

Shndërrimi i drejtpërdrejtë i lartësisë elipsoidale GNSS, lartësisë h (të përcaktuar në topografinë tokësore), e përcaktuar në sipërfaqen e Tokës, në fushën fizike të gravitetit të Tokës e bazuar në lartësinë fizike H (niveli i detit), është e nevojshme për matjet e lartësisë së bazuar në GNSS në shërbimet moderne të pozicionimit të GNSS (Ghilani & Wolf, 2008). Lidhja themelore midis lartësisë h e bazuar në GNSS dhe lartësia standarde (lartësia ortometrike H) është paraqitur në figurën 3.28.

Sipas shndërrimit të drejtpërdrejtë kemi:

$$H=h-N \quad (3.100)$$




Figura 3.28 Lidhja midis lartësisë ortometrike H, lartësisë elipsoide h valëzimit të gjeoidit N (dfhbf).

Në DFHRS, N përfaqësohet nga metoda e elementeve të përcaktuar (FEM) me parametra polinomial p. Këto përshkruajnë një element të përcaktuar HRS të quajtur  $N_{FEM}(p | \lambda, \varphi, h)$ . Nëse një ndryshim në shkallë  $\Delta m$  konsiderohet për sistemet e vjetra të lartësisë, atëherë HRS përfaqësohet nga  $N_{FEM}(p, \Delta m | \lambda, \varphi, h)$  (Jäger & Schneid, 2002). Ekuacioni (3.100) mund të shkruhet si:

$$H = h - N = h - DFHRS(p, \Delta m | \lambda, \varphi, h) \quad (3.101)$$

ose

$$H = h - (N_{FEM}(p | \lambda, \varphi) + \Delta m * h) \quad (3.102)$$

Përfaqësimi i elementeve të përcaktuar  $N_{FEM}(p | x, y)$  kryhet nga polinomet dypalëshe të shkallës n, të cilët janë vendosur në rrjeta të rregullta ose të çrregullta (Jäger & Kälber, 2000). Parimi i DFHRS është të ndajë një zonë ose rajon të një HRS të vazhdueshëm në një numër copëzash, me secilën copëz të ndarë më tej në një numër rrjetash siç tregohet në figurën 3.29, ku secila copëz ka një datum dhe parametrat e transformimit të shoqëruar (d) dhe secili rrjet ka parametra HRS (p) (Younis, 2013).






Figura 3.29 Dizajni i llogaritjes së DFHRS\_DB: FEM-Meshes (linja të hollë blu), pjesë (linja të trasha blu) dhe pika montimi (B, L, h | H) (trekëndëshat e gjelbër) (www.dfhbf.de/)

Vëzhgime të lartësisë elipsoidale  $h$ . Paraqitet matrica e kovariancës:

$$h + v = H + h\Delta m + f(x, y)^T p$$

ku

$$Ch = \text{diag}(\sigma^2 h_i).$$
(3.103)

si dhe parametrat e ruajtur në DFHRS-DB janë ( $p$ ,  $\Delta m$ ) dhe të lidhura me koordinatat e parashikuara ( $x, y$ ). Përfaqësimi polinom i DFHRS është shkruar në drejtim të matricës së projektimit  $f$  dhe vektorit të parametrevë  $p$ .

$$N_{FEM}(p|x, y) = f(x, y)^T p$$
(3.104)

Vëzhgimet e lartësisë gjeoidale.

Me matricë të vërtetë të kovariancës CNG ose vlerësuar nga një funksion sintetik i kovariancës paraqitet formula si në vazhdim:

$$NG(\lambda, \varphi)^j + v = f(x, y)^T \cdot p + \partial NG(d^j)$$
(3.105)

Kurse defektet nga vertikalja ( $\eta, \xi$ ) të vëzhguar me një aparat fotografik zenit ose që rrjedhin nga një model potencial graviteti janë:

$$\begin{aligned} \xi_j + v &= \frac{-f_{\phi}^T}{M(\lambda) + h} \cdot p + \partial\xi(dj_{\xi,\eta}) \\ \eta_j + v &= \frac{-f_L^T}{(N(\lambda) + h) \cdot \cos(\lambda)} \cdot p + \partial\eta(dj_{\xi,\eta}) \end{aligned} \quad (3.106)$$

ku:


$\partial\xi(d)$  dhe  $\partial\eta(d)$  - janë datume të parametrizuara të shformimeve të vertikales, ku  $f$  është derivat i pjesshëm i  $f(x,y)$  në lidhje me gjerësinë, kurse  $f_L$  është derivat i pjesshëm i  $f(x,y)$  në lidhje me gjatësinë.

Ekuacionin e vëzhgimit për lartësitë fizike  $H$  (ortometrike ose normale) e llogarisim:

$$\begin{aligned} CH &= \text{diag}(\sigma^2 H_i). \\ H + v &= H \end{aligned} \quad (3.107)$$

Kushtet e vazhdimësisë midis rrjeteve fqinje të ndryshme konsiderohen si ekuacione shtesë të vëzhgimit, siç edhe mund të shihen në figurën 3.30.

$$C + v = C(p) \quad (3.108)$$



**Figura 3.30** Polinomet HRS  $N(p)$  në rrjete të vetme (shiko gjithashtu Figura 3.29) dhe si pjesë e një HRS të vazhdueshëm në një zonë arbitrare të madhe ([www.dfhb.de/](http://www.dfhb.de/))

## **4 Modelet globale gjeopotenciale**

### **4.1 Modelet globale gjeopotenciale**

Metodat e ndryshme të matjes dhe teknikat e zgjidhjes janë zhvilluar për të marrë njohuritë e fushës së gravitetit të Tokës.

Modeli global ndryshon nga të tjerët për shkak të karakteristikave të tij siç është shkalla e burimit të të dhënave dhe metoda e analizës. Prandaj, është e mundur që modelet e mundshme globale të ndahen në klasa të ndryshme.

Modelet me bazë satelitore merren duke përcaktuar fushën e gravitetit duke ndjekur orbitat e satelitëve artificialë. Modelet e kombinuara merren me përzgjedhjen e satelitit, të dhënat altimetrike dhe të dhënat nga gravitetit tokësor.

Si rezultat i mungesës së rrjetit gravimetrik absolut dhe relativ të një vendi, shpeshherë përdoren modelet globale gjeopotenciale, të cilët përfshijnë të dhëna për të gjitha sipërfaqet e Botës. Duke marrë për bazë që modelet globale janë zhvilluar në masë të madhe dhe janë gjithnjë e më të sakta, kanë gjetur përdorim të gjerë në zgjidhjen dhe përcaktimin e gjeoidit të një vendi.

Modelet moderne mund të sigurojnë lartësitë gjeoide të çdo pike në sipërfaqen e Tokës me një saktësi që ndryshon nga 30cm deri në disa metra (Rapp, 1997; Yong-qi & Zhan-ji, 2001). Përveç përdorimit të gjerë të GPS-ve për qëllime gjeodezike, gjithashtu është rritur interesi i përcaktimit të saktë të gjeoidit lokal/rajonal me qëllim të zëvendësimit të matjeve të nivelimit nga marrësit GPS.

Në Botë janë të njohura shumë modele globale gjeopotenciale, ndërsa ne do të paraqesim një përshkrim të shkurtër të disa prej modeleve më të njohura, natyrisht të cilët edhe do të jenë pjesë e llogaritjeve të kësaj teze: EGM84, EGM96; EGG97; EGM08; EIGEN 0x etj.

#### **4.1.1 Modeli i Gravitetit të Tokës 1984 (EGM84)**

Gjeoidi EGM84 është një datum vertikale dhe i përcaktuar për herë të parë në vitin 1987. EGM84 bazohet në një zgjerim sferik harmonik të potencialit shqetësues në shkallë dhe rend 180 të aplikuar në elipsoidin WGS84. Gjeoidi EGM84 është një bazë e të dhënave vertikale për gjeodezinë. Është përcaktuar me informacione nga Agjencia Kombëtare e Inteligjencës Gjeohapësinore e SHBA (NGA). Ky model gravitacioni është i plotë në shkallën harmonike sferike dhe rendin 180 ([georepository.com/datum\\_5203/EGM84-geoid.html](http://georepository.com/datum_5203/EGM84-geoid.html)).

Të dhënat e EGM84 sot kanë rëndësi historike, pa përdorim praktik. Dallimet midis lartësive gjeoide të EGM84 me dy modele më të reja EGM96 dhe EGM08 janë tre deri në dhjetë herë më të larta se ndryshimet midis EGM96 dhe EGM08.

## 4.1.2 Modeli i gravitetit të Tokës 1996 (EGM96)

Modeli i gravitetit të Tokës EGM96 (kodi 5773) është një model gjeopotencial i përbërë nga koeficientet harmonikë sferikë të plotë në shkallë të rendit 360. Kjo është një zgjidhje e përbërë nga një zgjidhje kombinim për shkallën dhe rendit 70, një zgjidhje bllok diagonale prej 71 deri 359 shkallësh dhe zgjidhja kuadraturë në shkallën 360. Përcaktimi i modelit EGM96 është si rezultat i bashkëpunimit ndërmjet: Agjencisë Kombëtare të Imazheve dhe Hartave (NIMA) në SHBA, sot Agjencia Kombëtare Gjeohapësinore (NGA), Agjencia Kombëtare për Administrimin e Komunikacionit Ajror dhe të Hapësirës (NASA) në SHBA, Qendra e Fluturimit Hapësinor Goddard (GSFC) dhe Universiteti i Shtetit të Ohio (OSU) ([https://en.wikipedia.org/wiki/Earth\\_Gravitational\\_Model](https://en.wikipedia.org/wiki/Earth_Gravitational_Model)), parqitja grafike e modelit EGM96 është bërë në figurën 4.1.





Figura 4.1 Modeli gravimetrik i Tokës EGM96. (<http://cddis.nasa.gov/926/egm96/egm96.html>)

Saktësia e gjeoidit në modelin EGM96 është më e mirë se një metër në përjashtim të sipërfaqeve të zbrazëta të dendura dhe sipërfaqeve të sakta me të dhëna të gravitetit. Modeli EGM96 është llogaritur si një rrjet me ndarje 15' x 15' dhe një rrjet tjetër me ndarje 30' x 30' (Smith & Milbert, 1999) siç edhe mund të vërehet në figurën 4.2.





**Figura 4.2 Modeli gravimetrik i Tokës EGM96 sipas ndarjes 15’ (<https://earth-info.nga.mil/GandG/wgs84/gravitymod/>).**

Projekti i përbashkët mori avantazhin e të dhënave të reja të gravitetit nga rajone të ndryshme të globit. Këto projekte kanë përmirësuar grumbullimin e të dhënave mbi shumë sipërfaqe tokësore të Botës duke përfshirë Afrikën, Kanadanë, pjesë të Amerikës së Jugut dhe Afrikës, Azisë Juglindore, Evropën Lindore dhe ish-Bashkimin Sovjetik. Përveç kësaj, ka pasur përpjekje të mëdha për të përmirësuar anomalitë ekzistuese bazë të të dhënave përmes kontributeve mbi vende të ndryshme në Azi.

Ky model i ri gjeopotencial do të përdoret si një referencë gjeodezike për të rinovuar WGS84. Përveç kësaj, do të shërbejë si modeli i artit për orbitën e saktë, oqeanografike dhe studimet gjeofizike, siç edhe mund të shihet në figurën 4.3 paraqitja vizuale e tij.

Sipas ICGEM, modeli EGM96 është llogaritur për tërë globin, por ajo pjesë që na nevojitet neve për në punimin tonë është territori i Evropës, ku për llogaritje janë përdorur 1047 pika dhe ka shfaqur një gabim 0.493m (<http://icgem.gfz-potsdam.de>).

**Tabela 4.1 Llogaritja e modelit EGM96 për territore të ndryshme të Tokës(<http://icgem.gfz-potsdam.de>)**

Model	Nmax	Australia (201 pika)	Brazil (1112 pika)	Canada (2691 pika)	Europe (1047 pika)	Japan (816 pika)	USA (6169 pika)	Te gjitha (12036 pika)
<b>EGM96</b>	360	0.298m	0.73m	0.353m	0.493m	0.364m	0.379m	0.4267m





Figura 4.3 Modeli gravimetrik i Tokës EGM96 sipas ndarjes 30' (<https://cddis.nasa.gov/926/egm96/egm96.html>).

### 4.1.3 Kuazi-gjeoidi i gravitetit evropian EGG97

Nga viti 1990 deri në vitin 2003, Instituti për Gjeodezi (Institut für Erdmessung-IFE) në Universitetin e Hanoverit kanë punuar si qendër për llogaritjet gravimetrike (kuazi) gjeoidi për Evropën dhe sipërfaqet detare që ka vepruar si qendër e Shoqatës Ndërkombëtare të Gjeodezisë (IAG). Zgjidhje të përkohshme janë hartuar për afërsisht çdo vit (Torge & Denker, 1991; Denker & Torge, 1993; Denker et al., 1995; Denker & Torge, 1998; Roland & Denker, 2005). Sidoqoftë, vetëm modeli i gjeoidit dhe kuazigjeoidit EGG97 (European Gravimetric Geoid, 1997; Denker & Torge, 1998) iu kaluan përdoruesve të jashtëm. Për fushën e gravitetit me gjatësi vale të gjatë, u përdor modeli gjeopotencial EGM96 i plotë për shkallën dhe rendin 360.

Modeli i gjeoidit dhe kuazi-gjeoidit EGG97 është i bazuar në rezolucionin e lartë të gravitetit dhe të gjitha të dhënat e terrenit me rezolucion të lartë të disponueshëm në vitin 1997, si dhe modelin global gjeopotencial të Tokës EGM96 nga NASA/NIMA (360) siç edhe mund të shihet në figurën 4.4.



**Figura 4.4 Modeli i evropian gravimetrik i kuazigjeoidit EGG97.**  
(<http://www.igik.edu.pl/pl/geodezja-i-geodynamika-modele-geoidy1>).

Ky model ofron 3 milionë të dhëna të gravitetit dhe 700 milionë të dhëna të terrenit për Evropën (Denker & Torge, 1998). Zgjidhja e të dhënave të gravitetit ishte më e mirë se 10km për të gjithë zonën e tokës evropiane dhe zgjidhja e modeleve të terrenit ndryshonte nga rreth 30m në disa km. Të dhënat altimetrike përfshinë zonat e detit. Modeli EGG97 është llogaritur si një rrjet me ndarje: 1.0°x1.5° si dhe 1.0°x1.5° dhe mbulon intervalin 25°N deri 77°N dhe 35°W deri 67.4°E.

Modelet e gjeoidit dhe kuazi-gjeoidit janë dhënë në formën e rrjetit të valëzimeve. Llogaritja e valëzimit është bërë duke përdorur gravitetin dhe të dhënat e terrenit, si dhe një shkallë të lartë globale në modelin harmonik sferik sipas procedurës apo teknikës së heqjes-rivendosjes (remove-restore).

Qëllimi kryesor i EGGP (European Gravity and Geoid Project) është të llogarisë një model të përmirësuar të gjeoidit dhe kuazi-gjeoidit Evropian bazuar në grupe të reja dhe të përmirësuar të të dhënave që janë bërë të disponueshme që nga llogaritja e fundit në vitin 1997 (EGG97). Përmirësimet përfshijnë modele më të mira gjeopotenciale globale nga misionet CHAMP dhe GRACE, modele më të mira të lartësisë dixhitale (DEM).

Ky kontribut përshkruan progresin e bërë gjatë një periudhe katërvjeçare, nga viti 2003 deri në vitin 2007, përfshirë zhvillimin e një modeli të ri të gjeoidit dhe kuazi-gjeoidit EGG97 për të gjithë Evropën. Së pari, përshkruhet statusi i grupeve të të dhënave të gravitetit dhe të terrenit, si dhe zhvillimi i modelit EGG97 me metodën e kombinimit spektral. Pastaj, EGG07 dhe modelet e tjera vlerësohen nga GPS të pavarur dhe të dhëna të nivelimit, duke treguar që përdorimi i modeleve gjeopotenciale GRACE, si dhe të dhënat e përmirësuar të gravitetit dhe terrenit çojnë në përmirësime të konsiderueshme në krahasim me EGG97 (Sideris, 2007).



#### 4.1.4 Modeli i gravitetit të Tokës 2008 (EGM08)

Modeli zyrtar i gravitetit tokësor EGM2008 është lëshuar publikisht nga Ekipi Kombëtarë i Zhvillimit të EGM-së Gjeohapësinore të Inteligjencës (NGA) të SHBA-ve. Modeli EGM2008 është një model harmonik sferik i potencialit gravitacional të Tokës. Ky model gravitacioni është i plotë në shkallën harmonike sferike dhe rendin 2159, dhe përmban koeficientë shtesë që shtrihen në shkallën 2190 dhe rendin 2159. Me këtë, misioni satelitor GRACE siguroi një model me rezolucion shumë të lartë të gravitetit global. Mbi zonat e mbuluara me të dhëna të gravitetit të një cilësie të lartë, mospërputhjet midis valëzimit të gjeoidit EGM2008 dhe vlerave të pavarura të GPS/nivelimit janë në rendin prej  $\pm 5\text{cm}$  deri në  $\pm 10\text{cm}$ . Devijimet vertikale të EGM2008 mbi SHBA-të dhe Australinë janë brenda  $\pm 1.1$  deri  $\pm 1.3$  hark-sekonda të vlerave të pavarura astrogeodetike ([earth-info.nga.mil/GandG/wgs84/gravitymod/egm2008](https://earth-info.nga.mil/GandG/wgs84/gravitymod/egm2008)), siç edhe mund të shihet në figurën 4.5.




Figura 4.5 EGM2008 me rezolucion 2.5 minuta (EGM2008-NGA [https://earth-info.nga.mil/GandG///wgs84/gravitymod/egm2008/egm08\\_wgs84.html](https://earth-info.nga.mil/GandG///wgs84/gravitymod/egm2008/egm08_wgs84.html)).

EGM2008 përformon në mënyrë të barabartë me modelet e tjera gravitacionale me bazë të GRACE në llogaritjet e orbitës. Ky model gravitacional është i kompletuar në shkallën harmonike sferike, ku siguron një raster prej 2.5'x 2.5' dhe një saktësi që i afrohet 10cm. Mbi EGM96, EGM2008 paraqet përmirësim me një faktor prej gjashtë në rezolucion dhe nga faktor nga tre në gjashtë në saktësi, në varësi të sasisë gravitacionale dhe zonës gjeografike. (Pavliset al., 2012), siç edhe mund të vërehet në figurën 4.6.






Figura 4.6 Paraqitja gjeografike e disa prej karakteristikave të zonës 5 harkut-minutë nënkupton anomali të e gravitetit në skedarin e shkrirë të përdorur për zhvillimin e modelit EGM2008: (a) Disponueshmëria e të dhënave. (b) Identifikimi i burimit të të dhënave. (<https://agupubs.onlinelibrary.wiley.com/doi/10.1029/2011JB008916>).

Sipas ICGEM, modeli EGM2008 është llogaritur për tërë globin, por si pjesë që na nevojitet neve në punimin tonë është territori i Evropës, ku për llogaritje janë përdorur 1047 pika dhe ka shfaqur një gabim 0.125m (<http://icgem.gfz-potsdam.de/>).

Tabela 4.2 Llogaritja e modelit EGM2008 për territore të ndryshme të Tokës (<http://icgem.gfz-potsdam.de>)

Model	Nmax	Australia (201 pika)	Brazili (1112 pika)	Canada (2691 pika)	Europa (1047 pika)	Japan (816 pika)	USA (6169 pika)	Të gjitha (12036 pika)
EGM2008	2,190	0.217m	0.46m	0.128m	0.125m	0.083m	0.248m	0.239m

#### **4.1.5 Modeli i gravitetit evropian i Tokës 6c4 (EIGEN 6c4)**

Sipas EIGEN, EIGEN-6c4 është një model statik global i gravitetit të kombinuar global deri në shkallën dhe rendin 2190. EIGEN6c4 është përpunuar bashkërisht nga GFZ Potsdam (GFZ Qendra Gjermane e Kërkimeve për Gjeoshkencat (Deutsches GeoForschungsZentrum) dhe GRGS Toulouse (Groupe de Recherche de Géodésie Spatiale). Kombinimi i grupeve të ndryshme të të dhënave satelitore dhe sipërfaqesore është bërë nga një kombinim i kufizuar i brezit të ekuacioneve normale (në shkallën maksimale 370), që gjenerohen nga ekuacionet e vëzhgimit për koeficientët harmonikë sferikë. Një përshkrim i shkurtër i teknikave të aplikuara për gjenerimin e një modeli të tillë të kombinuar të fushës së gravitetit është dhënë në (Shako et al. 2014). Zgjidhja e rezultuar për shkallën/rendin 370 është zgjeruar në shkallën/rendin 2190 nga një zgjidhje diagonale bllok duke përdorur rrjetin e anomalisë së gravitetit global të DTU10.

Modeli i fushës së gravitetit është bërë dhe janë paraqitur krahasimet në mes EGM2008 dhe EIGEN6c4, ku modeli i ri jep përshtatjen më të mirë të orbitës për GOCE (Foerste et al., 2014).

**Tabela 4.3 Krahasimi i Goce dhe Champ sipas modeleve EGM2008 dhe EIGEN6C4**

Gravity Field Model	Max d/o 180 x 180 GOCE	Max d/o 150 x 150 CHAMP
EGM2008 (Pavlis et al. 2012)	2.79	2.68
EIGEN-6C4	1.50	2.50

Sipas ICGEM, modeli EIGEN6c4 është llogaritur për tërë territoret e Tokës, por si pjesë që na nevojitet në punimin tonë është territori i Evropës, ku për llogaritje janë përdorur 1047 pika dhe ka shfaqur një gabim 0.121m (<http://icgem.gfz-potsdam.de>).

**Tabela 4.4 Gabimi i EIGEN6C4 sipas territoreve te caktuara**

Model	Nma x	Australia (201 pika)	Brazil (1112 pika)	Canada (2691 pika)	Europe (1047 pika)	Japan (816 pika)	USA (6169 pika)	Te gjitha (1203 6 pika)
EIGEN -6C4	2,190	0.212 m	0.446 m	0.126 m	0.121 m	0.079 m	0.247 m	0.2361 m

## 5 Shtetet rajonale në aspektin e përcaktimit të modelit të gjeoidit

### 5.1 Vështrim i përgjithshëm

Është e rëndësishme të bëhet paraprakisht një analizë e përgjithshme në aspektin e ndërtimit dhe përcaktimit të modelit të gjeoidit për vendet të cilat e kanë të llogaritur së paku një model të gjeoidit duke përdorur modelet globale gjeopotenciale me qëllim të adoptimit të teknikave të përdorura dhe analizave të kryera në raport me rezultatet e arritura. Në nënkapitujt e mëposhtëm do të paraqesim një pasqyrë të shkurtër të disa shteteve në rajon dhe më gjerë në aspektin e definimit të modelit të gjeoidit për territorin përkatës.

#### 5.1.1 Modeli i gjeoidit për territorin e Republikës së Shqipërisë

Pasi në rastin tonë edhe ne kemi po të njëjtin territor, llogaritjet për këtë territor janë bërë në vitin 2013 me programin DFHBF dhe janë bazuar në përdorimin e vëzhgimeve EGM2008 dhe EGG97, ku sipas William Owusu-Banahene (Jnr.) janë përdorur 109 pika dhe modeli i gjeoidit EGM2008 ka treguar saktësi më të mirë se EGG97, në bazë të pikave të cekura më lartë, saktësia mund të arrihet 1-5cm dhe me gjeoidin EGM2008, paraqitja grafike e këtij modeli mund të shihet në figurën 5.1.




Figura 5.1 Majtas: Dizajni i Patching dhe Meshing për Shqipërinë. Djathtas, vijat e izohipseve të gjeoidit të përputhshëm me RTCM (1-5) cm për Shqipërinë (Owusu-Banahene, 2013).

Gjithashtu edhe në vitin 2015 nga ASIG (Autoriteti Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor) dhe KRGJSH (Korniza Referuese Gjeodezike Shqiptare) është tentuar të bëhet adoptimi lokal i modelit të gjeoidit EGM2008, ku si pika të besuara kanë përdorur 125 pika nga 151 pika të rrjetit të nivelimit, ku ndryshimet në saktësi janë  $\pm 50\text{cm}$  në bazë të llogaritjeve nga një program Albageo03, që mbulon zonën  $39^{\circ}01'$  deri në  $43^{\circ}29'$  të gjerësisë gjeografike dhe  $18^{\circ}01'$  deri në  $21^{\circ}59'$  të gjatësisë gjeografike. Për korrigjim ASIG dhe KRGJSH kanë bërë eliminimin e 8 pikave për të mos pasur gabime më të mëdha se  $\pm 50\text{cm}$ , për të cilat janë ndërtuar edhe harta përkatëse, të cilat mund të shihen në figurat 5.2 dhe 5.3.




Figura 5.2 Mbetjen në kuotë (Asig& Krgjsh, 2015).







Figura 5.3 Grafiku i ndarjeve në kurben e vlerave të barabarta të lartësive gjeoid elipsoid (Asig & Krgjsh, 2015).

## 5.1.2 Modeli i gjeoidit për territorin e Italisë

Si rast studimi ka marrë 11 pika të rrjetit vertikal Evropian (EUVN), që është bazuar në modelin e fundit gjeopotencial EGM2008 dhe është përdorur teknika e heqjes-rivendosjes me ndarjen e rrjetit  $1.5' \times 1.5'$  që mbulon zonën  $37^\circ$  deri në  $48^\circ$  të gjerësisë gjeografike dhe  $6^\circ$  deri në  $19^\circ$  të gjatësisë gjeografike. Për zhvillim topografik ka përdorur SRTM90m dhe modelin dixhital EGM2008. Gjeoidi i ri ITG2009 me rezolucion të lartë dhe gjeoidi global EGM2008 janë krahasuar me valëzimet gjeoide të matura për 11 pikat. Gjeoidi ITG2009 ka një devijim standard më të vogël (12.5 cm) (Corchete, 2010), në krahasim me gjeoidin global më të fundit (EGM2008) dhe në bazë të punimit është paraqitur si gabimi më i vogël për zgjedhjen e një gjeoidi për territorin e Italisë. Sipas punimit nga (Corchete, 2010) ky model mund të përdoret për qëllime gjeofizike, përveç gjeodezisë dhe matjeve të lartësisë, sepse mund të sigurojë një kufizim për shpërndarjen e dendësisë dhe gjendjen termike të litosferës dhe viskozitetit në mantel, siç mund edhe të shihet në figurën 5.4.



**Figura 5.4 Geoid italian i lëshuar në vitin 2009 (ITG2009) (Corchete, 2010).**

### **5.1.3 Modeli i gjeoidit për territorin e Greqisë**

Modeli i parë për territorin e Greqisë u bë nga grupi GeoGrav në Departamentin e Gjeodezisë dhe Sondazhit, Universiteti Aristoteli i Selanikut, të cilin e quajtën GreekGeoid2010. Si rast studimi llogaritjet janë bazuar në teknikën heq-llogarit-rivendos në modelin EGM2008 duke u përdorur si fushë referimi, me ndarjen e rrjetit 2'x2' që mbulon zonën 33° deri në 42° të gjerësisë gjeografike dhe 18.5° deri në 30 ° të gjatësisë gjeografike.

Të dhënat e gravitetit hyrës iu referohen anomalive të gravitetit tokësor, detar dhe ajror për zonën e gjerë helene. Vlerësimi përfundimtar u krye në një hap për të gjithë rajonin duke përdorur 1D FFT dhe bërthamën sferike Stokes. Sipas (GeoGrav Group 2010, GreekGeoid2010([https://www.isgeoid.polimi.it/Geoid/Europe/Greece/greece\\_g.html](https://www.isgeoid.polimi.it/Geoid/Europe/Greece/greece_g.html))). Saktësia mesatare e modelit gjeoid, kur krahasohet me të dhënat e mbledhura GPS/Nivelimin është në nivelin 3-5 cm. Paraqitja vizuale e të cilave mund të vërehet në figurën 5.5.





Figura 5.5 GreekGeoid2010. ([https://www.isgeoid.polimi.it/Geoid/Europe/Greece/greece\\_g.html](https://www.isgeoid.polimi.it/Geoid/Europe/Greece/greece_g.html)).

### 5.1.4 Modeli i gjeoidit për territorin e Maqedonisë së Veriut

Republika e Maqedonisë së Veriut nuk është e përfshirë në llogaritjen e një modeli të gjeoidit.

### 5.1.5 Modeli i gjeoidit për territorin e Kosovës

Republika e Kosovës si rast studimi ka marrë 30 pika të rrjetit të nivelimit dhe GPS për një sipërfaqe 11.000 km<sup>2</sup> me ndarjen e rrjetit 5x5km që mbulon zonën 42° deri në 43.25° të gjerësisë gjeografike dhe 20° deri 22° të gjatësisë gjeografike, Kosova është ndarë në 5 grupe. Në bazë të llogaritjeve të bëra për këtë territor janë llogaritur 4 modele gjeopotenciale: EGG97 me devijim standard 3cm, EGM96 me devijim standard 5cm, EGM2008 me devijim standard 3cm, EIGEN05 me devijim standard 4cm. Këtu si rezultat përfundimtar është përcaktuar gjeoidi model EGM2008 me vlerat minimale -5cm dhe maksimale 7cm dhe devijim standard 3cm. Sipas (Ameti & Jager, 2016) ky model është konsideruar mjaft i saktë dhe si i tillë mund të aplikohet si model referimi i lartësisë në sistemin internet të pozicionimit të Kosovës (KOPOS). Paraqitja vizuale e të cilit është vendosur në figurën 5.6.



**Figura 5.6 Përcaktimi i modelit përfundimtar gjeoid i Kosovës nga koncepti DFHRS (Ameti & Jager, 2016).**

### **5.1.6 Modeli i gjeoidit për territorin e Malit të Zi**


Republika e Malit të Zi nuk është e përfshirë në llogaritjen e një modeli të gjeoidit.

### **5.1.7 Modeli i gjeoidit për territorin e Kroacisë**

Si rast studimi ka marrë rreth 500 pika të rrjetit të nivelimit dhe GNSS me ndarjen e rrjetit 30''x 45'' që mbulon zonën 42° deri në 46.6° të gjerësisë gjeografike dhe 13° deri në 19.5° të gjatësisë gjeografike.

Për territorin e Kroacisë kuazi-gjeoidi rajonal EGM2008 përshtatet shumë mirë në GNSS/ pikat e nivelimit në një pjesë të madhe të Kroacisë kontinentale, që ndryshon vetëm 3-5 cm, përveç disa zonave problematike, kryesisht në kufijtë me Malin e Zi dhe Italinë, ku qëndrueshmëria ndryshon nga 10 në 15cm dhe është quajtur HRG2009. Sipas (Bašić & Bjelotomic, 2014) dallimet që rezultojnë nga HRG2009 kanë një devijim standard prej 3.5 cm mbi të gjithë zonën, duke krahasuar devijimin standard prej 11.4 cm të marrë me modelin e mëparshëm gjeoid kombëtar HRG2000, siç edhe mund të shihet në figurën 5.7.






**Figura 5.7 Modeli i ri gjeoid me rezolucion të lartë HRG2009(Bašić & Bjelotomic, 2014).**

### **5.1.8 Modeli i gjeoidit për territorin e Latvisë**

Është bërë duke krahasuar modelin e gjeoidit Latvian 98 (LV'98), që ky model përdoret nga topografët për shumë vite. Ky model është i bazuar nga hartat e gravitetit nga sateliti mbi Detin Baltik dhe matjet e gravitetit, ndërsa këto llogaritje janë kryer me programin GRAVSOFT me një saktësi të vlerësuar 6-8cm. (Janpaule et al., 2013).

Si një e dhënë hyrëse (N,  $\xi$ ,  $\eta$ ) u përdor Modeli Gjeoid Gravimetrik Evropian 1997 (EGG97). Për llogaritjet e mëtutjeshme janë përdorur 102 pika GPS/nivelim (B, L, h | H) që kanë shërbyer si më të përshtatshme për sipërfaqen e kuazi-gjeoidit. Pikat që merren për llogaritje gjenden më së shumti në Latvi, kurse 3 në Estoni dhe 17 në Lituani. Në programin DFHBR5 janë bërë llogaritjet me rrjetin e projektuar 5x5km, siç edhe mund të shihet në figurën 5.8.




**Figura 5.8** Projektimi i llogaritjes për Letoninë DFHRS-DB(Janpaule et al., 2013).

Për të kontrolluar rezultatet është bërë krahasimi i rezultateve nga TV'98 dhe llogaritjet nga DFHRS. Vlerat në RMS kanë dalë të njëjta, kurse vlerat minimale dhe maksimale ndryshojnë, siç edhe janë paraqitur në tabelë 3.5.

**Tabela 5.1** Ndryshimi mes DFHRS dhe LV'98(Janpaule et al., 2013).

	Min(m)	Max(m)	RMSE (m)
DFHRS	-0,036	0,034	0,016
LV'98	-0,042	0,040	0,016

Sipas (Janpaule et al., 2013) sipërfaqja referuese e lartësisë gjeoidale me saktësi të lartë mund të arrihet me numrin minimal të vëzhgimeve të 102 pikave. Sipërfaqja referuese e lartësisë kuazi-gjeoidi për Latvinë është me gabim mesatar kuadratik prej 1.6cm, e cila është përfituara duke përdorur softuerin DFHBF. Një paraqitje e dallimit midis dy modeleve të llogaritura mund të shihet në figurën 5.9.



**Figura 5.9** Diferenca midis tretjes LV'98 dhe DFHRS(Janpaule et al., 2013).

Krahasimi me modelet globale tregon se modeli LV'98 dhe zgjidhja DFHBF ka marrëveshjen më të mirë me EGG97 dhe EGM2008 - RMS është 4-6cm. Për shkak se modeli EGG97 u zbatua në zgjidhjen DFHRS, gabimi mesatar kuadratik ka rezultuar të jetë: 1.7cm (Janpaule et al., 2013).

### 5.1.9 Modeli i gjeoidit për territorin e Hungarisë

Si rast studimi ka marrë 18 pika të rrjetit të nivelimit dhe GPS me ndarjen e rrjetit 1.5'x1.5' që mbulon zonën 45° deri në 49° të gjerësisë gjeografike dhe 16° deri në 23° të gjatësisë gjeografike. Për territorin e Hungarisë janë bërë llogaritjet dhe është bërë krahasimi për dy modele EGM2008 dhe EGG2013, ku gjeoidi EGG2013 ka dëshmuar që ka saktësi më të mirë se gjeoidi i mëparshëm global EGM2008. Për më tepër EGG2013 ka devijim standard më të vogël (3.6cm) krahasuar me EGM2008 me devijim standard (4.5cm) (Corchete, 2013). Sipas punimit nga (Corchete, 2013) ky është gabimi më i vogël i marrë nga çdo zgjidhje gjeoide për Hungarinë dhe modeli i ri do të jetë i dobishëm për përcaktimin e lartësisë ortometrike në male dhe zona të largëta, në të cilat niveli ka shumë probleme logjistike. Paraqitja vizuale e këtij modeli mund të shihet në figurat 5.10 dhe figurën 5.11.




Figura 5.10 Llogaritjet modeli gjeoid EGM2008 (Corchete, 2013).




Figura 5.11 Gjeoidi Gravimetrik Hungarez i lëshuar në 2013 (HGG2013). (Corchete, 2013).

### 5.1.10 Modeli i gjeoidit për territorin e Polonisë

Modeli i parë rajonal gjeoid astro-gravimetrik për Poloninë u zhvillua në vitin 1961 (Bokun, 1961), ndërsa modeli i fundit gjeoid astro-gravimetrik u llogarit në vitin 2005 në bazë të devijimeve të korigjuara astro-gjeodezike dhe astro-gravimetrike të vertikalisht (Rogowski et al., 2005). Si rast studimi ka marrë 120 pika të rrjetit të nivelimit dhe GPS me ndarjen e rrjetit 1.5' x 3.0' që mbulon zonën 48° deri në 56° të gjerësisë gjeografike dhe 12° deri në 26° të gjatësisë gjeografike. Në llogaritjen është përdorur modeli EGM2008 deri në shkallën 360. Janë bërë llogaritjet dhe është bërë krahasimi për modelin global EGM2008, ky gjeoid ka devijim standard më të vogël (2cm) (Kuczynska-siehiën et al., 2015).

Kjo saktësi e arritur është e krahasueshme me saktësinë e modeleve të fundit kuazi-gjeoidit të llogaritur për Poloninë duke përdorur metodën remove-compute-restore. Një paraqitje e këtij modeli të gjeoidit mund të shihet në figurën 5.12.




Figura 5.12 Modeli gjeoid gravimetrik I përcaktuar (në m).

## 6 Modelimi i gjeoidit për territorin e Republikës së Shqipërisë sipas metodës DFHRS

Për llogaritjen e modelit të gjeoidit për territorin e Republikës së Shqipërisë është përdorur metoda: Sipërfaqja e Referencës së Lartësisë së Elementeve Finite Dixhitale (DFHRS-Digital Finite-Element Height Reference Surface, dfhbf.de). E gjithë zona e territorit të Shqipërisë ka qenë e përdorur për analizë të mëtejshme dhe përcaktimin e zgjidhjes më të mirë të sipërfaqes referente të lartësive (SRL), duke përdorur metodën



DFHRS. Shqipëria ka një sipërfaqe afërsisht prej 28,748km<sup>2</sup> me pjesë të tokës prej 27,398km<sup>2</sup> dhe 1,350km<sup>2</sup> me ujë. Me kufi toke 691km e cila kufizohet me Greqinë 212km, me Kosovën 112km, Maqedoninë e Veriut 181km dhe Malin e zi 186km. Kurse me vija bregdetare 362km. Lartësia e Shqipërisë fillon nga pika më e ulët: Deti Adriatik 0m dhe me pikën më të lartë Maja e Korabit (Golem Korab) 2.764m, ku territori i Republikës së Shqipërisë ka një lartësi mesatare prej 708m ([cia.gov/the-world-factbook](http://cia.gov/the-world-factbook)) (The World Factbook 2020. Washington, DC: Central Intelligence Agency, 2020). Një paraqitje grafike e territorit të Shqipërisë me vendet fqinje është vendosur në figurën 6.1.



**Figura 6.1** Territori i Republikës së Shqipërisë me Shtetet në rajon ([cia.gov/the-world-factbook](http://cia.gov/the-world-factbook))(The World Factbook 2020. Washington, DC: Central Intelligence Agency, 2020).

## **6.1 Të dhënat hyrëse, të cilat do të përdoren për adoptimin e modelit të gjeoidit**

Të dhënat të cilat do të përdoren për analizimin dhe përcaktimin e modelit global gjeopotencial më të përshtatshëm për territorin e Republikës së Shqipërisë në kuadër të kësaj teze të doktoratës, janë të dhënat, të cilat janë siguruar mënyrë zyrtare në formë CD nga: Autoriteti Shtetëror për Informacion Gjeohapësinor-Drejtoria e Gjeodezisë dhe Hartografisë (ASIG) në Tiranë. Këto të dhëna janë nga përmbledhja e relacionit mbi punimet gjeodezike të kryera nga Instituti i Firencës në Shqipëri për llogaritjen e parametrave të transformimit nga referenca lokale ALB86 në referencën evropiane

ETRF2000, epoka 2008.0. Janë të përfshira 151 pika të territorit të Republikës së Shqipërisë, të cilat kanë koordinata tredimensionale të përcaktuara me GPS në ETRF2000, si dhe lartësinë e përcaktuar me nivelim të saktë, paraqitja grafike e të dhënave mund të shihet në figurën 6.2.

Në shtojcat 13.1 dhe 13.2, të kësaj teme të doktoratës janë bashkangjitur koordinatat e të gjitha pikave të territorit të Shqipërisë, të cilat janë përdorur në testimin e modeleve globale gjeopotenciale me qëllim të përcaktimit të modelit të gjeoidit, si dhe përcaktimin e sipërfaqes referente të lartësive për territorin e Republikës së Shqipërisë.



Figura 6.2 Rrjeti statik RGN (ASIG & KRGJSH, 2015)

## 6.2 Modelimi i gjeoidit përmes metodës së elementeve finite (MEF)

Për përdorim praktik, lartësia ( $h$ ) e matur drejtpërdrejt në sipërfaqen e Tokës me anë të GNSS është e nevojshme për t'u konvertuar në lartësi fizike ( $H$ ) e ndërlidhur me një sipërfaqe referente fizike (gjeoidi, kuazi-gjeoidi, etj) (Tranes et al. 2008). Marrëdhënia themelore midis lartësisë së përcaktuar GNSS dhe lartësisë së përcaktuar fizike:

$$N = h - H \quad (6.1)$$

ku:

N qëndron për lartësinë gjeoidale dhe përfaqëson diferencën midis referencës së elipsoidit dhe gjeoidit H. Ky formulim është qasje konvencionale e gjeodezisë fizike dhe kërkon njohuri për dendësinë e masave të jashtme ose bën supozime në lidhje me të (Heiskanen & Moritz, 1967). Për të shmangur këtë çështje, më tutje ne do të trajtojmë zgjidhjen e Molodensky në përcaktimin e anomalive të lartësive në vend të valëzimit (undulacionit) të gjeoidit. Qasja e propozuar në këtë tezë të doktoratës, ka për qëllim llogaritjen e sipërfaqes referencë të lartësisë (SRL), e cila në përgjithësi, duhet të shërbejë si Datum Kombëtar Vertikal dhe posaçërisht për përdoruesit e GNSS në kohë reale. Në këtë kontekst, ndarja e gjeoidit është e përfaqësuar nga Metoda e Elementeve Finite (MEF) me parametra polinom p. Metoda DFHRS është modeluar si një SRL e vazhdueshme në zona të mëdha arbitrare nga polinomi bivariat (bivariate polynomials) mbi një rrjetë të parregullt (Jäger & Schneid, 2001).

Duke supozuar se diferenca në shkallë ( $\Delta m$ ) qëndron për një sipërfaqe referencë të vjetër, atëherë SRL përfaqësohet nga funksioni:  $N_{FEM}(p, \Delta m | \lambda, \varphi, h)$  (Jäger & Schneid, 2002). Vendosja e këtij funksioni në formulën themelore të lartësisë duket kështu (Ameti, 2016):

$$H = h - N_{FEM}(p, \Delta m | \lambda, \varphi, h) \quad (6.2)$$

respektivisht,

$$H = h - N_{DFHRS}(p, \Delta m | \lambda, \varphi, h) \quad (6.3)$$

ku:

$N_{FEM}(p, \Delta m | \lambda, \varphi, h)$  është e përcaktuar nga polinomi bivariat i shkallës n, i cili është i vendosur në rrjeta të rregullta (Jäger & Kälber, 2000). Emërimi i koeficienteve polinomialë ( $a_{00}, a_{11}, \dots$ ) me pi i rrjetit i-të për n rrjeti në total, lartësia  $N_{FEM}(p|x,y)$  e SRL e elipsoidit referues të mësipërm është (Ameti & Jager, 2016):

$$N_{FEM}(p^i | x, y) = f(x, y)^T p^i \quad (6.4)$$

ku:

$$\begin{aligned} p^i &= [a_{j,k}]^i; (j = 0, n; k = 0, n) \text{ dhe } f(x, y)^T \\ &= (1, x, y, x^2, xy, y^2, \dots \dots \dots) \end{aligned} \quad (6.5)$$

Koncepti i metodës DFHRS bazohet në ndarjen e sipërfaqes së vrojtuar në regjione dhe në rrjeta të rregullta të pikave. Secili regjion përmban një datum dhe janë të lidhura me parametrat e transformimit (d) dhe çdo rrjetë e rregullt i ka parametrat SRL (p). Parametrat DFHRS (p) dhe informatat e rrjetës ruhen në një skedar të caktuar në databazën e softuerit DFHRS. Në këtë qasje është konsideruar mundësia e

vazhdimësisë, ku për pikën  $N_{FEM}$  në kufirin midis dy rrjetave të rregullta duhet të jetë në varësi për të dy rrjetave të rregullta (C0-vazhdimësi) dhe pjerrësia në kufirin e rrjetave të rregullta duhet të përfaqësojë të gjithë zonën (C1- vazhdimësi).

Modeli matematik për llogaritjen e lartësive gjeoidale duke përdorur metodën DFHRS përfshin pika identike me lartësi elipsoide ( $h$ ) në sistemin burimor dhe lartësi normale ose ortometrike ( $H$ ) në sistemin e synuar, si dhe komponentët fizik shtesë nga modelet globale apo rajonale gjeopotenciale. Përfaqësimi i polinomit  $N_{FEM}$ , mund të shkruhet në aspektin e matricës së dizajnit  $f$  dhe parametrat vektor  $p$  (Ameti & Jager, 2016):

$$N_{FEM}(p | x, y) = f(x, y)^T p^i \quad (6.6)$$

Modeli matematik për lartësitë në sistemin e synuar mund të shprehet nga formulimi standard (Ameti & Jager, 2016):

$$H + v = H' \quad (6.7)$$

ku:

$H$  – Lartësia në sistemin e synuar

$H'$  – Lartësia e përshtatur në sistemin e synuar

$v$  – mbetja

Në analogji, lartësia elipsoidale duket kështu (Ameti & Jager, 2016):

$$\begin{aligned} h_i + v &= H - h * \nabla \\ h_i + v &= H - h \cdot \Delta m_i + N_{FEM}(\phi, \lambda | p) \\ h + v &= H + h \cdot \Delta m + N_{FEM}(p | \phi, \lambda) \end{aligned} \quad (6.8)$$

Duke përdorur koordinata gjeocentrike. Termi  $N_{FEM}$  mund të shkruhet si vijon (Ameti & Jager, 2016):

$$N_{FEM}(\phi, \lambda | p) = N_{FEM}(X(\phi, \lambda), Y(\phi, \lambda) | p) \quad (6.9)$$

Dhe në termet e polinomeve bivariate duket kështu (Ameti & Jager, 2016):

$$N_{FEM}(\phi, \lambda | p) = \sum_{i=0}^{\infty} \cdot \sum_{j=0}^{\infty} \cdot a_{i,j} x^i y^j = f(x, y)^T \cdot p \quad (6.10)$$

ku:

$h^i$  - lartësia elipsoidale në rrjetin e  $i^{\text{të}}$



$v$  – mbetja

$H$  – lartësia në sistemin e synuar

$\Delta m^i$  - shkalla e faktorit të ndryshimit

$f(x,y)^T$  – koeficientët e funksionit polinomial

$p$  – parametrat e funksionit polinomial

Lartësia gjeoidale nga modelet globale gjeopotenciale mund të shprehet si në vijim (Ameti & Jager, 2016):

$$N_{GPM}^i + v = f(x,y)^T \cdot p + \partial NG(d_j) \quad (6.11)$$

ku:

$N_{GPM}^i$  është lartësia gjeoidale nga modeli global gjeopotencial në rrjetën e rregullt (mashes)  $j^{te}$  dhe  $\partial NG(d^i)$  është Datumi i parametrizimit të tranzicionit nga lartësia gjeoidale në regjonin (patches) e  $j^{te}$ .

Parametrat e tjerë fizikë, të cilët janë nxjerrë nga modelet globale gjeopotenciale, janë devijime (shmangie) vertikale. Modeli matematik duket kështu (Ameti & Jager, 2016):

$$\xi_j + v = -f_\phi^T / (M(\phi) + h) \cdot p + \partial \xi(d_\xi^j) \quad (6.12)$$

$$\eta_j + v = -f_\lambda^T / [(N(\phi) + h) \cdot \cos(\phi)] \cdot p + \partial \eta(d_\eta^j) \quad (6.13)$$

ku:

$\xi_j$  është komponenti Veri-Jug i devijimit vertikal në rrjetën e rregullt  $j^{te}$  dhe  $\eta_j$  është komponenti Perëndim-Lindje i devijimit vertikal në rrjetën e rregullt të  $j^{te}$ .

$f_\phi^T$  dhe  $f_\lambda^T$  - janë funksione polinomiale në gjerësi/gjatësi.

$M, N$ - janë rrezja e lakimit në meridianin/vertikaln kryesor.

$\partial \xi(d_\xi^j)$  ,  $\partial \eta(d_\eta^j)$  - janë Datumi i parametrizimit të tranzicionit në devijimin e komponentit vertikal.

Në mënyrë që të zvogëlohet efekti i valëve me gjatësi të mesme apo të gjata, përdoren devijimet sistematike të formës si në vëzhgimet  $N$  dhe në komponentet e devijimit vertikal që rrjedhin nga modelet globale gjeopotenciale ose burime të tjera. Metoda DFHRS parashikon nënndarjen e secilit model gjeoidal në një numër të quajtur regjione gjeoidale. Koncepti i metodës DFHRS parashikon vazhdimësinë mes rrjeteve të rregullta fqinje në mënyrë që të parashikojnë një sipërfaqe referencë të lartësive unike, e cila është e qëndrueshme në të gjithë zonën.

### **6.3 Kontrolluesi i të dhënave (ang. Data snooping)**

Kontrolluesi i të dhënave mund të përkufizohet si kërkimi i vëzhgimit, në të cilin është bërë një gabim bruto gjatë matjes nëse gabimet llogaritëse lihen jashtë konsideratës, e cila justifikohet në llogaritjen e automatizuar të sotme (Baarda, 1968).

Një nga metodat më të mira për identifikimin e jashtëm në analizën e të dhënave gjeodezike është procedura e testimit të Baarda-s. Kjo metodë është kontrolluesi i të dhënave përsëritëse (ang. Data snooping) është metoda më e mirë e vendosur për identifikimin e gabimeve bruto (Baarda, 1968).

Meqenëse kontrollimi i të dhënave bazohet në një test hipoteze statistikore me një hipotezë alternative për secilin vëzhgim, mund të çojë në një vendim të rremë si më poshtë:


- Gabimi i tipit I ose paralajmërimi i rremë (niveli i probabilitetit  $\alpha$ ) - Mundësia e identifikimit të një anësore kur nuk ka;
- Gabimi i tipit II ose zbulimi i humbur (niveli i probabilitetit  $\beta$ ) - Mundësia e mos-identifikimit të një anëtari kur ekziston të paktën një; dhe
- Gabimi i tipit III ose përjashtimi i gabuar (niveli i probabilitetit  $\kappa$ ) - Mundësia e identifikimit të gabuar të një vëzhgimi jo-largues si një skedar i jashtëm, në vend të një anash. Ky lloj i vendimit të gabimit u prezantua nga (Hawkins, 1980; Förstner, 1983).

Shkalla e gabimit të vendimit të tipit të I-rë në një test hipoteze binare (d.m.th., me një hipotezë të vetme alternative) mund të zgjidhet nga përdoruesi. Shkalla e gabimit të vendimit të tipit të II-të nuk do të mundet. (Lehmann & Voß-Böhme, 2017) gjithashtu tregojnë se një statistikë prove me një normë të ulët të tipit të II-të thuhet se është e fuqishme në rastin e hipotezës binare, kur merret parasysh vetëm një hipotezë alternative. Sidoqoftë, në rast hipotezash të shumta alternative (d.m.th. kontrollimi i të dhënave), pa marrë parasysh gabimin e tipit të III-të, ekziston një rrezik i lartë i mbivlerësimit të probabilitetit të suksesshëm të identifikimit (shih p.sh. Yang et al. 2013). Nga ana tjetër, niveli i besimit është probabiliteti që një vëzhgim jo-largues të injorohet në mënyrë korrekte; fuqia e provës është probabiliteti që një pjesë e jashtme të identifikohet saktë. Prandaj, niveli i besimit dhe fuqia e testit janë gjasat që rezultati i testit të çojë në vendime të sakta, në krahasim me ndodhjen e gabimeve të tipit I, II dhe III (shih, për shembull, Förstner, 1983; Teunissen, 2006; Klein et al., 2015b).

Termi "Kontrolluesi i të dhënave" i referohet testit të mësipërm njëdimensional, duke ekzaminuar vetëm një mbetje të standardizuar (ekuacioni 6.14), në atë kohë.

$$w_i = \frac{v_i}{\sigma_{v_i}} = \frac{v_i}{\sigma_0 \sqrt{q_{v_i}}} \quad (6.14)$$

Me fjalë të tjera  $w_i$  është një mbetje e standardizuar, e cila ka shpërndarjen normale, siç edhe është treguar në figurën 6.3.



**Figura 6.3w-test (Kontrollues i të dhënave)**

Nga kjo shifër mund të shihet lehtësisht fiksimi i nivelit të rëndësisë  $\alpha_0$  dhe fuqia e testit  $\beta_0$ .

(Baarda, 1968) propozoi përdorimin e testit global për zbulimin e gabimeve bruto dhe testin "Kontrollues i të dhënave" për lokalizimin e tyre. Vendimet nga të dy testet duhet të jenë të qëndrueshme, d.m.th., të njëjtat vlera kufitare duhet të gjenden nëse kryhet testi global ose i vetëm. Në praktikë, procedura e kërkimit të të dhënave zbatohet në mënyrë të përsëritur, duke identifikuar dhe hequr një skaj në çdo kohë. Metoda zbatohet derisa të mos identifikohen vëzhgime. Këtu, kjo procedurë do të quhet kontrollues i të dhënave përsëritëse (ang.Snooping Iterative Data).

## **7 Kriteret, analizat dhe rezultatet e arritura nga vëzhgimet e përzgjedhura për llogaritje**

Procesi për zgjedhjen e modelit të gjeoidit më të përshtatshëm fillon me ndarjen e të dhënave që përmbajnë emërtimin e vëzhgimeve me koordinatat gjeografike me lartësitë elipsoidale dhe si e dhënë tjetër që përmbajnë emërtimin e vëzhgimeve me lartësitë e nivelimit, këto të dhëna përdoren për të gjithë modelet që do të vendosen për përpunim të të dhënave. Në softuerin e përdorur DFHRS i gjithë territori i Republikës së Shqipërisë është ndarë në rrjeta të rregullta (ang.mashes) të madhësisë 5kmx5km si dhe për devijimin e gabimeve të mundshme sistematike. Në vazhdim këto rrjeta janë të grumbulluara në 9 regjione (ang.patches), të cilët janë përdorur për të shmangur komponentët e valëve të gjata dhe të mesme në zona regjionale të ndryshme. Për llogaritjen e modelit të gjeoidit për territorin e Republikës së Shqipërisë janë vendosur në përlllogaritje 151 vëzhgime të rrjetit GPS dhe rrjetit të nivelimit si vlerat e synuara të lartësive normale. Këto vëzhgime kanë koordinata tredimensionale të përcaktuara me GPS në ETRF2000 me lartësinë e përcaktuar me nivelim të saktë.

Siç edhe u përmend në kapitullin 3 modelet globale gjeopotenciale, të cilët do të përdoren për analizë në këtë disertacion me qëllim të përcaktimit të sipërfaqes referente të lartësive (SLR), modeli i gjeoidit për territorin e Shqipërisë janë modelet: EGM96,

EGG97, EGM2008, EIGEN04 dhe EIGEN6c4. Këto modele janë të integruara në softuerin DFHRS të cilët na mundësojnë që të vazhdojmë me procedurën e llogaritjeve. Në llogaritjet e para të realizuara në kuadër të tezës janë vendosur të gjitha pikat, 151 vëzhgime të rrjetit GPS/nivelimit, duke mos hequr asnjë vëzhgim në mënyrë që të kemi një rezultat fillestar sa më real në raport me vëzhgimet e përdorura. Paraqitja e 151 vëzhgimeve me rezultatet nga modelet globale shfaqin një fillim për analizë dhe shqyrtim të mëtutjeshëm në procesimin e vëzhgimeve, po ashtu ofrohet një avancim në hulumtim të hollësishëm të këtyre vëzhgimeve për gjetjen dhe definimin se cilat nga vëzhgimet do të jenë të qëndrueshme dhe cilat nga to nuk do të qëndrojnë në llogaritjet e mëtutjeshme.

Pas disa llogaritjeve të realizuara me 151 vëzhgime duke përdorur 5 (pesë) modelet globale gjeopotenciale shohim se kemi rezultate të papranueshme për disa vëzhgime, të përdorura në llogaritje. Kjo vjen si rezultat se ne në fillim nuk kemi vendosur asnjë kriter për përzgjedhje të vëzhgimeve që do të marrin pjesë në llogaritje të modelit të gjeoidit duke e besuar besueshmërinë e 151 vëzhgimeve dhe duke i marrë si të pranueshme të gjitha vëzhgimet.

**Tabela 7.1** Janë paraqitur të dhënat nga vlerat minimale dhe maksimale, mesatarja, devijimi standard dhe gabimi mesatar kuadratik për 5 modelet globale gjeopotenciale të llogaritura nga 151 vëzhgimet.

	EGM96	EGG97	EGM2008	EIGEN04	EIGEN6c4
<b>Nr. i vëzhgimeve</b>	151	151	151	151	151
<b>Vlera minimale (m)</b>	-0.202	-0.133	-0.118	-0.229	-0.112
<b>Vlera maksimale (m)</b>	0.160	0.132	0.136	0.152	0.133
<b>Gabimi mesatar kuadratik</b>	0.080	0.048	0.042	0.074	0.042
<b>Mesatarja (m)</b>	0.000	0.000	0.000	0.000	0.000
<b>Devijimi standard (m)</b>	0.080	0.048	0.042	0.074	0.042

**Diagrami 7.1** Paraqitja grafike e devijimit standard në njësinë cm për 5 modelet e përdorura në llogaritje nga 151 vëzhgime.




Nga rezultatet e pranuar është shtruar nevoja që të analizohen të gjitha vëzhgimet një nga një dhe të vendosen kritere paraprake me qëllim të definimit të vëzhgimeve që do të jenë përfundimtare për llogaritje të modelit të gjeoidit, si dhe që do të kenë shtrirje sa më të mirë topografike në të gjithë territorin.

Atëherë kemi marrë për bazë kriteret e përcaktuara nga vetë softueri për llogaritje të modelit të gjeoidit (Younis, 2013):

- Kushti i parë sipas metodës DFHRS për arritje të saktësisë 1-3 cm të llogaritjes së modelit të gjeoidit për territor të caktuar është që rrjeta (ang.meshesize) duhet të jetë e ndarë në 5kmx5km,
- Kushti i dytë është vendosja e 3-5 vëzhgimeve brenda një regjioni/grupi (ang.paches),
- Kushti i tretë është largësia në mes të pikave të jetë 20-30km.

Pas pranimit të këtyre kriterëve, kemi filluar me procesimin e të dhënave në softuer, me ç'rast është aplikuar kriteri i parë, ku territori është ndarë në rrjeta me ndarje 5kmx5km, për të vazhduar me aplikimin e kushtit të dytë, krijimin e grupeve/regjioneve në rastin tonë është tejkualuar numri maksimal sipas kriterit të parashtruar, ku çdo grup ka maksimumin e kërkuar të vëzhgimeve si dhe në aplikimin e kushtit të tretë që prapë në rastin tonë është tejkualuar distanca e vendosjes së pikave, minimumi 0.3km dhe maksimumi është 319km. Një paraqitje vizuale e tyre mund të shihet në figurën 7.1.



**Figura 7.1** Paraqitja e 151 vëzhgimeve të ndara në rrjeta të rregullta 5kmx5km dhe paraqitja e krijimit të 9 grupeve/regjioneve

Procesi i eliminimit fillestar të vëzhgimeve ka filluar duke e aplikuar metodën remove-restore. Me qëllim të arritjes së rezultateve sa më të besueshme, është shtruar nevoja që të bëhen edhe analiza shtesë dhe të përdoren edhe metoda të tjera me qëllim të eksperimentimeve të mëtutjeshme. Kriter shtesë që kemi vendosur është të kërkohen vëzhgimet, që janë sa më të përshtatshme, por nuk shkaktojnë krijim të modelit të

papërshtatshëm. Metoda më e mirë e vendosur për identifikimin e gabimeve bruto në analizën e të dhënave gjeodezike është kontrolluesi i të dhënave (ang. Data snooping), (Baarda, 1968). Data snooping është proces i cili aplikohet në mënyrë të vazhdueshme, duke identifikuar dhe hequr një në çdo kohë. Metoda zbatohet derisa të mos identifikohen vëzhgime.

Megenëse snooping i të dhënave bazohet në një test hipoteze statistikore, mund të çojë në një vendim të rremë si më poshtë, janë shtruar tipet e llojeve të gabimeve që do të analizohen (Matsuoka et al., 2019):

- Gabimi e tipit I-rë ose paralajmërimi i rremë (niveli i probabilitetit  $\alpha$ ) - Mundësia e zbulimit të një anësore kur nuk ka asnjë;
- Gabimet e tipit II-të ose zbulimi i humbur (niveli i probabilitetit  $\beta$ ) - Mundësia e moszbulimit të një anësore kur ekziston të paktën një; dhe
- Gabimet e tipit III-të ose përjashtimi i gabuar (niveli i probabilitetit  $\kappa$ ) - Mundësia e identifikimit të gabuar të një vëzhgimi jo-largues si një skedar i jashtëm, në vend të një anash.

Në këtë fazë është aplikuar gabimi i I-rë, në procesin e eliminimit të vëzhgimeve të papërshtatshme (të cilat mund të zbulohen kur nuk ka asnjë) janë eliminuar 57 vëzhgime. Pas llogaritjes së të dhënave me softuerin DFHRS dhe përpunimin e këtyre të dhënave kemi llogaritur devijimin standard dhe gabimin mestar kuadratik.

Devijimi standard shpreh një sasi të llogaritur për të treguar shkallën e devijimit për një grup në tërësi.

$$\sigma = \sqrt{\frac{1}{n-1} \sum_{i=1}^n (x_i - \bar{x})^2} \quad (7.1)$$

Ndërsa gabimit mesatar kuadratik është llogaritur në bazë të formulës:

$$RMS = \sqrt{\frac{\sum_i x_i^2}{n-1}} \quad (7.2)$$


Devijim standard i modelit EGM96 është 7.21cm, për modelin EGG97 2.66cm, për modelin EGM2008 1.49cm, për modelin EIGEN04 6.38cm dhe për modelin Eigen6c4, 1.49cm.

Në tabelën 7.2 janë paraqitur rezultatet nga 94 vëzhgimet e realizuara, si dhe janë vendosur vlerat minimale dhe maksimale të cilat janë kusht për përzgjedhje të modelit të gjeoidit.


**Tabela 7.2** Paraqitja tabelare të vlerave minimale dhe maksimale, mesatarja, devijimi standard dhe gabimi mesatar kuadratik për 5 modelet globale gjeopotenciale të llogaritura për territorin e Republikës së Shqipërisë për 94 vëzhgime.

	EGM96	EGG97	EGM2008	Eigen04	EIGEN6C4
<b>Nr. i vëzhgimeve</b>	94	94	94	94	94
<b>Vlera minimale (m)</b>	-0.215	-0.075	-0.030	-0.177	-0.030
<b>Vlera maksimale (m)</b>	0.142	0.066	0.032	0.171	0.029
<b>Gabimi mesatar kuadratik</b>	0.072	0.026	0.015	0.063	0.014
<b>Mesatarja (m)</b>	0.000	0.000	0.000	0.000	0.000
<b>Devijimi standard (m)</b>	0.072	0.027	0.015	0.064	0.014

**Diagrami 7.2** Paraqitja grafike e devijimit standard në njësinë cm për 5 modelet e përdorura në llogaritje.



Paraqitja e vëzhgimeve mund të shihet në figurën 7.2, ku me ngjyrë jeshile janë vizualizuar 94 vëzhgime të llogaritura, kurse me ngjyrë të kuqe janë vizualizuar vëzhgimet e eliminuara.



**Figura 7.2 Modeli i llogaritur nga 94 vëzhgime të përzgjedhura për llogaritje**


Analizat i kemi vazhduar edhe mëtej duke e bërë analizimin e gabimeve të tipit II-të dhe III-të.

Pas mbetjes me 94 vëzhgime të qëndrueshme, nuk mund të themi se vetëm eliminimi i 57 vëzhgimeve është i saktë pasi ato nuk gjenden në të njëjtin territor dhe është shtruar prapë pyetja nëse do të ketë vëzhgime të tjera të cilat janë të qëndrueshme, por që janë eliminuar në mënyrë të gabuar nga llogaritjet. Kështu që kemi filluar t'i testojmë 57



vëzhgimet një nga një pasi që ka vëzhgime shumë afër njëra tjetrës por që gabimi i një pike është shumë i lartë kurse tjetra ka një përputhje shumë të mire me modelet e krahasuara. Nga 57 vëzhgimet e mbetura kemi filluar eksperimentimin e mëtutjeshëm duke vënë në funksion gabimet e tipit të II-të dhe të III-të, ku çdo vëzhgim është vendosur në llogaritje një nga një me qëllim të identifikimit të ndonjë vëzhgimi fqinj të qëndrueshëm, i cili më parë mund të jetë eliminuar nga llogaritjet për shkak se mund të kemi dyshuar që mund ta ketë prishur besueshmërinë e modelit të llogaritit. Për këtë arsye është përdorur metoda kontrolluesi i të dhënave me qëllim që të mund të kemi mundësi të identifikojmë ndonjë vëzhgim të qëndrueshëm që mund të jetë eliminuar në mënyrë të gabuar, në mënyrë që ta kthejmë në llogaritje.

Pas eksperimentimit të bërë me 57 vëzhgimet që ishin paraqitur si të paqëndrueshme, 5 nga vëzhgimet e paqëndrueshme mund të shtohen në të dhënat e 94 vëzhgimeve paraprake, pasi që është arritur në përfundim që saktësia e këtyre 5 vëzhgimeve është ulur nga vëzhgimet fqinje, ky eksperiment ka rezultuar në gabimin e tipit të III-të në përjashtimin e gabuar të vëzhgimeve. Pas eksperimentimit të vëzhgimeve një nga një është shfaqur një vëzhgim i cili ishte në përbërje të llogaritjeve fillestare por që shkaktonte në mosbesueshmëri të modelit, në bazë të gabimit të tipit të II-të, ky vëzhgim është eliminuar nga llogaritjet dhe kemi arritur me një rezultat përfundimtar me 98 vëzhgime të pranueshme për llogaritje, kurse 53 vëzhgime janë eliminuar në pamundësi të integritit të tyre për arsye të gabimeve të mëdha që shfaqin. Në figurën 7.3. është bërë paraqitja vizuale e 98 vëzhgimeve, ku me ngjyrë jeshile janë paraqitur vëzhgimet që ishin në llogaritje, me ngjyrë të kaltër janë vizuelizuar vëzhgimet që janë kthyer në llogaritje, duke vazhduar vizuelizimin e vëzhgimit me ngjyrë vjollcë për vëzhgimin e eliminuar, si dhe me ngjyrë të kuqe vëzhgimet që nuk vendosen fare në llogaritje për shkak të gabimit të madh që japin pas llogaritjeve dhe në këtë mënyrë prishin besueshmërinë e modelit të llogaritit.



**Figura 7.3** Me ngjyrë të kaltër paraqitet integriti i 5 vëzhgimeve të cilat ishin eliminuar nga shpërndarja e gabimit dhe me ngjyrë vjollcë paraqitet largimi i një pike e cila rrit gabimet e vëzhgimeve fqinje.

Analiza përfundimtare e vëzhgimeve me qëllim të përpjekjeve që të mund të integrohen sa më shumë që të jetë e mundur vëzhgime të reja në llogaritje, por që rezultoi vetëm në kthimin e 5 vëzhgimeve në llogaritje dhe largimin e një vëzhgimi nga 94 vëzhgimet e përcaktuara më parë. Rezultatet e arritura janë të kënaqshme, nga të cilat është e mundur të bëhet përcaktimi i modelit gjeoidal më të përshtatshëm për territorin e Shqipërisë. Në vazhdim kemi paraqitur devijimin standard dhe vlerat minimale dhe maksimale nga 98 vëzhgime të pranuar si përfundimtare me qëllim të përcaktimit të


modelit gjeoidal. Për modelin EGM96 vlera e devijimit standard është 7.147cm, për modelin EGG97 vlera e pranuar e devijimit standard është 2.179cm, për modelin EGM2008 devijimi standard është arritur 1.503cm, për modelin EIGEN04 devijimi standard është 6.427cm dhe për modelin e fundit të përdorur në llogaritje devijimi standard pranohet me saktësi 1.425cm.

Në tabelën e mëposhtme janë paraqitur edhe vlerat minimale dhe maksimale që janë vlera të domosdoshme në përzgjedhjen definitive të modelit të gjeoidit.

**Tabela 7.3 Paraqitja tabelare e vlerave minimale dhe maksimale, mesatarja, devijimi standard dhe gabimi mesatar kuadratik për 5 modelet globale gjeopotenciale të llogaritura për territorin e Republikës së Shqipërisë për 98 vëzhgime.**

	EGM96	EGG97	EGM2008	Eigen04	EIGEN6C4
<b>Nr. i vëzhgimeve</b>	98	98	98	98	98
<b>Vlera minimale (m)</b>	-0.213	-0.076	-0.028	-0.172	-0.026
<b>Vlera maksimale (m)</b>	0.151	0.067	0.031	0.170	0.028
<b>Gabimi mesatar kuadratik</b>	0.071	0.027	0.015	0.064	0.014
<b>Mesatarja (m)</b>	0.000	0.000	0.000	0.000	0.000
<b>Devijimi standard (m)</b>	0.071	0.027	0.015	0.064	0.014

**Diagrami 7.3 Paraqitja grafike e devijimit standard në njësinë cm për 5 modelet e përdorura në llogaritje.**



Përzgjedhja definitive e 98 vëzhgimeve nga 151 të mundshme për llogaritje është bërë duke i kryer dy lloje të analizave njëra pas tjetrës për arritjen e rezultatit me saktësi të lartë dhe të pranueshëm në përzgjedhjen e vëzhgimeve dhe më pas në llogaritjen e modelit gjeoidal në mënyrë që të ofrojë përputhje sa më të mirë në mes të modelit gjeoidal të llogaritur dhe sipërfaqes referente të lartësive të Shqipërisë. Përveç këtyre dy llojeve të analizave të realizuara gjithashtu kemi parë me kujdes shtrirje dhe shpërndarje të vëzhgimeve në mënyrë që të jenë sa më homogjene me të dhëna në tërë territorin, siç edhe mund të shihet në figurën 7.3. Shpërndarja e pikave si në anën veriore, jugore, lindore dhe perëndimore ka mbulueshmëri të mjaftueshme me vëzhgime për sipërfaqen/zonën e përzgjedhur për hulumtim. Pas të gjitha analizave dhe verifikimeve të realizuara janë definuar 98 vëzhgime përfundimtare, kurse 53 prej këtyre vëzhgimeve që nuk kaluan pragun për vendosje të mëtutjeshme në llogaritje, me qëllim të përcaktimit të modelit të gjeoidit për territorin e Republikës së Shqipërisë.

## 8 Përcaktimi i sipërfaqes referente të lartësive -modeli i gjeoidit për territorin e Republikës së Shqipërisë

Pas llogaritjeve maratonike dhe analizimit të gjitha kriterëve të parashtruara me të vetmin qëllim të definimit të vëzhgimeve që do të hyjnë në llogaritje për përcaktimin e modelit të gjeoidit më të përshtatshëm për Shqipërinë. Kjo detyrë është realizuar me sukses në kapitullin 7, ku janë definuar 98 vëzhgime nga 151 të mundshme. Tani nëpërmjet metodës DFHRS, në të cilën janë të integruara 5 modele globale gjeopotenciale janë realizuar testimet për 98 vëzhgime të pranueshme me qëllim të synimit të përcaktimit të sipërfaqes referente të lartësive (SLR), modeli i gjeoidit dhe definimit të saj si Datum Kombëtar Vertikal.

Siç edhe u përmend më lartë, e gjithë zona e territorit të Republikës së Shqipërisë është ndarë në rrjeta të rregullta të madhësisë 5kmx5km, në të cilën janë krijuar 9 grupe/regjione, paraqitja grafike e të cilave mund të shihet në figurën 8.1.





Figura 8.1 Paraqitja grafike e 98 vëzhgimeve në softuerin DFHRS të ndara në rrjetin e rregullt 5kmx5km dhe ndarja e regjioneve/ grupeve

## 8.1 Përcaktimi i modelit të gjeoidit duke përdorur modelin global gjeopotencial EGM96

Modeli i parë global i përdorur me qëllim të përcaktimit të modelit të gjeoidit për territorin e Republikës së Shqipërisë është modeli global gjeopotencial EGM96. Për llogaritjen e këtij modeli janë përdorur 98 vëzhgime të përzgjedhura, të cilat i përkasin rrjetit GPS dhe rrjetit të nivelimit. Këto vëzhgime kanë koordinata tredimensionale të përcaktuara me GPS në ETRF2000, si dhe lartësinë e përcaktuar me nivelim të saktë. Bazuar nga rezultatet e nxjerra dhe nga analizat e bëra të këtij modeli del se devijimi standard për modelin EGM96 është 0.071m.

Në vazhdim është paraqitur diagrami për lartësinë gjeoidale  $N$  të modelit EGM96, por në këtë diagram nuk janë të përmbledhura të gjitha vlerat e rezultateve me emërtime por që të njëjta mund të gjenden në shtojcën (13.3).

Diagrami 8.1 Paraqitja e lartësive gjeoidale  $N_{EGM96}$



Në bazë të rezultateve dhe analizave të arritura është përpiluar harta për modelin e përdorur që janë paraqitur në figurën 8.2.







Figura 8.2 Ndërtimi i hartës me të dhëna nga modeli global gjeopotencial EGM96 për territorin e Shqipërisë.

## 8.2 Përcaktimi i modelit të gjeoidit duke përdorur modelin global gjeopotencial EGG97

Për llogaritjen e modelit të dytë të gjeoidit është përdorur modeli global gjeopotencial EGG97. Për llogaritjen e këtij modeli janë përdorur po të njëjtat vëzhgime sikur edhe në modelin e kaluar gjithsej 98 vëzhgime të përzgjedhura, të cilat i përkasin rrjetit GPS/nivelimit. Këto vëzhgime kanë koordinata tredimensionale të përcaktuara me GPS në ETRF2000, si dhe lartësinë e përcaktuar me nivelim të saktë. Bazuar nga rezultatet e nxjerra dhe nga analizat e bëra të këtij modeli del se devijimi standard për modelin EGG97 është 0.027m.

Vlerat e llogaritura të lartësive gjeoidale N janë përmbledhur në diagramin e mëposhtëm të modelit EGG97, por në këtë diagram nuk janë të gjitha vlerat e rezultateve me emërtime, por që të njëjtat mund të gjenden në Shtojcën (13.3).

**Diagrami 8.2 Paraqitja e lartësive gjeoidale N<sub>EGG97</sub>**



Gjithashtu është ndërtuar harta përkatëse për modelin EGG97 në bazë të rezultateve të arritura, të cilat mund të shihen në figurën 8.3.




Figura 8.3 Ndërtimi i hartës me të dhëna nga modeli global gjeopotencial EGG97 për territorin e Shqipërisë


### 8.3 Përcaktimi i modelit të gjeoidit duke përdorur modelin global gjeopotencial EGM2008

Një tjetër model i përdorur për llogaritjen e modelit të gjeoidit për territorin e Republikës së Shqipërisë është modeli global gjeopotencial EGM2008. Për llogaritjen e këtij modeli janë përdorur po të njëjtët vëzhgime sikur në dy modelet e kaluara, gjithsej 98 vëzhgime të përzgjedhura të cilat i përkasin rrjetit GPS dhe rrjetit të nivelimit. Këto vëzhgime kanë koordinata tredimensionale të përcaktuara me GPS në ETRF2000, si dhe lartësinë e përcaktuar me nivelim të saktë. Bazuar nga rezultatet e nxjerra dhe nga analizat e bëra të këtij modeli del se devijimi standard për modelin EGM2008 është 0.015m.



Vlerat e llogaritura të lartësive gjeoidale N janë përmbledhur në diagramin e mëposhtëm të modelit EGM2008, por në këtë diagram nuk janë të gjitha vlerat e rezultateve me emërtime, por që të njëjtat mund të gjenden në shtojcën (13.3).

**Diagrami 8.3 Paraqitja e lartësive gjeoidale N-EGM2008**



Gjithashtu edhe në bazë të rezultateve që janë arritur në llogaritjen e këtij modeli të përdorur është përpiluar harta e cila është paraqitur në figurën 8.4.





Figura 8.4 Ndërtimi i hartës me të dhëna nga modeli global gjeopotencial EGM2008 për territorin e Shqipërisë

## 8.4 Përcaktimi i modelit të gjeoidit duke përdorur modelin global gjeopotencial EIGEN04

Modeli i radhës që është përdorur për llogaritjen e modelit të gjeoidit për territorin e Republikës së Shqipërisë është përdorur modeli global gjeopotencial EIGEN04. Për llogaritjen e këtij modeli janë përdorur po të njëjtat vëzhgime sikur në modelet e kaluara, gjithsej 98 vëzhgime të përzgjedhura që i përkasin rrjetit GPS dhe rrjetit të nivelimit. Këto vëzhgime kanë koordinata tredimensionale të përcaktuara me GPS në ETRF2000, si dhe lartësinë e përcaktuar me nivelim të saktë. Bazuar nga rezultatet e nxjerra dhe nga analizat e bëra të këtij modeli del se devijimi standard për modelin EIGEN04 është 0.064m.

Vlerat e llogaritura të lartësive gjeoidale N janë përmbledhur në diagramin e mëposhtëm të modelit EIGEN04, por në këtë diagram nuk janë të gjitha vlerat e rezultateve me emërtime, por që të njëjtat mund të gjenden në shtojcën (13.3).

**Diagrami 8.4 Paraqitja e lartësive gjeoidale NEIGEN04**



Paraqitja grafike për modelin e llogaritur EIGEN04 është vendosur në figurën 8.5.





Figura 8.5 Ndërtimi i hartës me të dhëna nga modeli global gjeopotencial EIGEN04 për territorin e Shqipërisë

## 8.5 Përcaktimi i modelit të gjeoidit duke përdorur modelin global gjeopotencial EIGEN6c4

Si model i fundit i përdorur për llogaritjen e modelit të gjeoidit për territorin e Republikës së Shqipërisë është përdorur modeli global gjeopotencial EIGEN6c4. Për llogaritjen e këtij modeli janë përdorur po të njëjtat vëzhgime sikurse edhe në të gjitha modelet e përdorura në kuadër të kësaj teze të doktoratës, gjithsej 98 vëzhgime të përzgjedhura të cilat i përkasin rrjetit GPS dhe rrjetit të nivelimit. Këto vëzhgime kanë koordinata tredimensionale të përcaktuara me GPS në ETRF2000, si dhe lartësinë e përcaktuar me nivelim të saktë. Bazuar nga rezultatet e nxjerra dhe nga analizat e bëra të këtij modeli del se devijimi standard për modelin EIGEN6c4 është 0.014m.


Lartësitë gjeoidale N të llogaritura në kuadër të modelit EIGEN6c4 janë përmbledhur në diagramin e mëposhtëm, por në këtë diagram nuk janë të gjitha vlerat e rezultateve me emërtime, por që të njëjtat mund të gjenden në shtojcën (13.3).

**Diagrami 8.5 Paraqitja e vlerave të Lartësive gjeoidale N<sub>EIGEN6c4</sub>**



Paraqitja vizuale e modelit të llogaritur EIGEN6c4 është bërë në figurën 8.6, e cila është modeluar në bazë të rezultateve të arritura pas testeve të këtij modeli.






**Figura 8.6** Ndërtimi i hartës me të dhëna nga modeli global gjeopotencial EIGEN6c4 për territorin e Shqipërisë

## **8.6 Ndërtimi i profileve nga rezultatet e arritura**

Pas përfundimit të analizave, realizimit të detyrave nga kriteret e vendosura, si dhe paraqitjen e rezultateve të arritura, është e nevojshme të paraqiten edhe profilet e ndërtuara nga ndryshimet e valëzimit në raport me lartësitë gjeoidale të llogaritura për 5 modelet globale gjeopotenciale. Një detyrë e tillë e ndërtimit të modelit të gjeoidit nuk do të kishte kuptim pa ndërtim edhe të profileve. Kjo analizë është e rëndësishme jo vetëm për të treguar nevojën për zëvendësimin e modelit të përdorur më parë me modelin e ri, në mënyrë për të arritur saktësi më të mirë në përcaktimin e lartësive ortometrike duke përdorur shërbimet GPS.




Profilet janë ndërtuar me një shtrirje të gjerësisë gjeografike çdo  $15^{\circ}$ , nga të cilat rezultojnë gjithsej 18 profile me të dhënat e të gjitha modeleve të llogaritura, si dhe diagramet e paraqitura me të dhëna për 98 vëzhgime të pranueshme. Largësia midis pikave në shtrirjen e profilit është bërë me një distancë prej 1km në mënyrë që të kemi të dhëna sa më të sakta.

Në vazhdim është paraqitur modelimi vizuel i 18 profileve të ndërtuara nga ndryshimet e valëzimit në raport me lartësitë gjeoidale të llogaritura për 5 modelet globale gjeopotenciale, si dhe modelin digjital të terrenit për të gjitha profilet e ndërtuara. Profilet e ndërtuara paraqesin rrjedhën e ndryshimeve të lartësive gjeoidale të ndërtuara në gjerësi gjeografike të ndryshme. Paraqitja grafike e profileve mund të vërehet në figurën 8.7. Gjithashtu janë ndërtuar edhe 18 diagrame për secilin profil të vendosur në bazë të ndarjes me gjerësi gjeografike duke filluar nga  $42.45^{\circ}$  deri në shtrirjen e fundit të profilit që përfshinë gjerësinë gjeografike  $39.90^{\circ}$ , siç edhe mund të shihen në diagramin 8.6.











**Figura 8.7** Paraqitja grafike e ndërtimit të hartës së profileve





**Diagrami 8.6** Paraqitja e profileve dhe modelet digjitale të terrenit për të gjitha profilet duke filluar nga gjerësia gjeografike  $42.45^{\circ}$  deri në shtrirjen e fundit të profilit që përfshinë gjerësinë gjeografike  $39.90^{\circ}$ .














































Pas shtrirjes së profileve për 5 modelet globale gjeopotenciale të përdorura gjithashtu janë paraqitur edhe vlerat minimale dhe maksimale të llogaritura për të gjitha profilet.

Nga tabela 8.1. mund të vërejmë qartë se gabimi më i madh rezulton të jetë  $\pm 21$ cm për modelin EGM96 , ndërsa ai më i vogël është  $\pm 2.4$ cm për modelin EIGEN6c4. Rezultatet e detajuara nga llogaritja e modeleve për 18 profilet janë të vendosura në shtojcën (13.4).

**Tabela 8.1 Vlerat minimale dhe maksimale të profileve**

	<b>EGM96</b>	<b>EGG97</b>	<b>EIGEN04</b>	<b>EGM2008</b>	<b>EIGEN6c4</b>
<b>Min (cm)</b>	-13.898	-4.894	-13.086	-2.537	-2.543
<b>Max (cm)</b>	20.830	6.061	14.766	2.427	2.356

## **8.7 Përzgjedhja definitive e modelit të gjeoidit të llogaritur me metodën DFHRS për territorin e Republikës së Shqipërisë**

Nga një analizë paraprake e drejtpërdrejtë e problematikës së definimit të një modeli të gjeoidit për territorin e Republikës së Shqipërisë ishte e qartë që ekzistonte nevoja e realizimit të një algoritmi, i cili do të bënte të mundur llogaritjen e një modeli të gjeoidit më të besueshëm.

Një model i besueshëm gjeoidi është pjesë e rëndësishme e infrastrukturës gjeodezike, për t'i shërbyer aplikimeve praktike gjeodezike dhe rievuase. Në përcaktimin e modelit të gjeoidit të territorit duke përdorur një numër të vëzhgimeve të shpërndara në mënyrë homogjene dhe atyre GPS/nivelimi me dendësi të përshtatshme përbënë temën e këtij studimi.

Në këtë hulumtim modeli i gjeoidit për Shqipërinë u përcaktua duke përdorur metodën e njohur DFHRS, në të cilën janë testuar 5 modele globale gjeopotenciale si pjesë të integruara të kësaj metode. Nga rezultatet e arritura pas testeve dhe definimit të vëzhgimeve që do të marrin pjesë në llogaritje të modelit të gjeoidit, si dhe llogaritjes

së vlerave minimale dhe maksimale, të cilat janë kusht për definimin e modelit të gjeoidit më të përshtatshëm për territorin e Shqipërisë.


Saktësia e modeleve të llogaritura të paraqitura në tabelën 6.3, që vijnë si rezultat i llogaritjeve lehtë mund të vëhet në dukje një diferencim në mes të modeleve që kanë dhënë rezultate më të mira.

Duke u nisur nga modeli EGM96, i llogaritur nga 98 vëzhgime të pranueshme, devijimi standard është 7.147cm, pastaj modeli EIGEN04 është llogaritur me devijim standard 6.427cm, për të vazhduar me modelin EGG97 me devijim standard prej 2.719cm, pastaj devijimi standard i modelit EGM2008 është 1.503cm dhe saktësia e devijimit standard të modelit të fundit EIGEN6c4 të përdorur në llogaritje është 1.425cm.

Është e qartë se kemi një diferencim në mes të 3 modeleve: EGM96, EIGEN04 dhe EGG97, për të cilët besueshmëria e llogaritjes së devijimit standard është më e dobët. Kështu që këto 3 modele nuk do të trajtohen mëtej për shkak se devijimet e tyre e tejkalojnë saktësinë e pritshme.

Mbeten dy modele të qëndrueshme EGM2008 dhe EIGEN6c4 për të cilat devijimi standard është realizuar me saktësi mjaft të lartë dhe rezultatet e arritura janë shumë të përafërta në mes të këtyre dy modeleve. Atëherë përzgjedhja definitive e modelit të gjeoidit kërkohet më në bërthamë të llogaritjeve të realizuara duke marrë për bazë vlerat minimale dhe maksimale të këtyre dy modeleve, të cilat do të bëjnë të mundur përzgjedhjen e modelit më të përshtatshëm për sipërfaqen/zonën e hulumtuar, si dhe llogaritjet, të cilat dalin nga llogaritja e profileve të ndërtuara. Fillimisht do t'i analizojmë vlerat minimale dhe maksimale nga llogaritjet e modelit EGM2008, ku janë arritur me këto rezultate: vlera minimale është: -2.8cm, ndërsa ajo maksimale është 3.1cm, kurse minimumi dhe maksimumi i modelit EIGEN6c4 është arritur me këtë performancë: vlera minimale është -2.6cm dhe vlera maksimale 2.8cm., pastaj, duke vazhduar me analizimin e saktësisë së arritur nga ndërtimi i 18 profileve. Rezultatet e arritura nga ndërtimi i profileve janë paraqitur prapë me vlerat minimale dhe maksimale për 18 profilet e ndërtuar, ku shohim që gabimi më i madh rezulton të jetë  $\pm 21$ cm për modelin EGM96 ndërsa ai më i vogël është  $\pm 2.4$ cm për modelin EIGEN6c4. Një paraqitje grafike në formë diagrami nga rezultatet për 5 modeleve të llogaritura mund të shihet në diagramin 8.7.

**Tabela 8.2 Paraqitja e rezultateve nga 5 modelet globale gjeopotenciale të llogaritura**



Nga performanca e treguar e këtyre dy modeleve vërehet që kemi një diferencim të lehtë të modelit EIGEN6c4 nga modeli EGM2008, jo vetëm nga llogaritja e devijimit standard por edhe nga llogaritja e vlerave minimale dhe maksimale që janë kusht i definimit të modelit të gjeoidit për sipërfaqe të caktuar, gjithashtu edhe rezultatet nga profilet e nxjerra tregojnë që modeli EIGEN6c4 ka dhënë rezultate më të mira në raport me modelin EGM2008.

Rrjedhimisht modeli global gjeopotencial EIGEN6c4 ka dhënë performancë më të mirë në të gjitha fazat e llogaritjes së tij duke përdorur 98 vëzhgime të pranueshme për llogaritje dhe kështu definohet si model më i përshtatshëm për territorin e Republikës së Shqipërisë. Gjithashtu ky model ka shpërndarje topografike dhe përshtatet mjaft mirë në shtrirjen e territorit.

Zgjedhja përfundimtare e modelit të gjeoidit për Shqipërinë ofron saktësi prej 1cm. Synimi ynë në përcaktimin e një zgjidhje më të besueshme për sipërfaqen referuese të lartësive është realizuar me sukses të plotë, ku është arritur një saktësi e pa realizuar deri më tani prej 1cm për territorin e Republikës së Shqipërisë. Një rezultat i tillë i arritur na jep të drejtën e hulumtimeve të mëtejshme me qëllimi të deklarimit zyrtar të këtij modeli si një e dhënë Vertikale Kombëtare për Lartësi në sistemin e pozicionimit të Shqipërisë (ALBPOS).

## **9 Rezultatet dhe përfundimet**

Duke pasur parasysh që teknologjia kohëve të fundit ka avancuar shumë dhe disa prej metodave klasike dalë nga dalë po dalin nga përdorimi për shkak të kohëzgjatjes që marrin në realizimin e matjeve si dhe përpunimin e dhënave.

Për përcaktimin e modelit të gjeoidit për një territor të caktuar janë të njohura tri metoda si: metoda e matjeve gravimetrike tokësore, pastaj gravimetria ajrore e deri tek përdorimi i modeleve globale gjeopotenciale.

Në ditët e sotme, modelet e gravitetit satelitor përdoren në mënyrë rutinore për të siguruar informacion të fushës së gravitetit me gjatësi vale të gjatë për modelimin rajonal të gjeoidit, ndërsa të dhënat e gravitetit tokësor dhe ajëror kontribuojnë në gjatësinë e valës së mesme dhe të shkurtër të fushës së gravitetit. Sfida kryesore për modelimin e gjeoideve në këtë zonë është kombinimi i duhur i modelit të gravitetit satelitor, me të dhëna të gravitetit tokësor dhe të dhëna nga graviteti ajëror.

Duke marrë për bazë të dhënat gravimetrike tokësore që i kemi për Shqipërinë na i kufizojnë përdorimin e metodave të sipërpërmendura.

Siç edhe dihet matje gravimetrike tokësore për Shqipërinë janë realizuar në vitin 2015 dhe janë të matura tri pika gravimetrike tokësore, në Tiranë, Sarandë dhe në Shkodër, të cilat janë të pamjaftueshme për përcaktimin e modelit të gjeoidit.

Ndërsa sa i përket matjeve gravimetrike ajrore deri më tani nuk ka të dhëna që është realizuar një gjë e tillë për Shqipërinë.

Në këtë rast duke pasur parasysh se kemi mungesë të dhënave gravimetrike tokësore dhe ajrore ose të dhëna të pamjaftueshme, si alternativë e vetme na mbete që të përdorim modelet globale gjeopotenciale për llogaritje të sipërfaqes referente të lartësive për Shqipërinë duke përdorur të dhënat nga GPS/nivelim.

Ndërmjet matjeve me GNSS dhe modeleve globale gjeopotenciale është krijuar mundësia e përcaktimit të modelit të gjeoidit mjaft të saktë për një territor të caktuar. Por gjithashtu duke pasur parasysh trendet dhe zhvillimet që ndodhin si në rajon po ashtu edhe më gjerë, vazhdimisht shtrohet kërkesa për të ndjekur hapat e tyre. Duke pasur në konsideratë këtë që u tha më lartë dhe duke përcjellë zhvillimet e fundit në rajon dhe Evropë që kanë ecur në zhvillimin e modelit të gjeoidit ose edhe duke e përditësuar modelin paraprak, natyrisht që edhe për Shqipërinë është evidentuar një kërkesë e tillë, përcaktimi i një modeli të gjeoidit, të cilin deri më tani nuk e ka pasur të definuar.

Në kuadër të tezës së doktoratës është blerë softuer DFHRS (Digital Finite Element Height Reference Surface) ([www.dfhb.de](http://www.dfhb.de)), i zhvilluar nga Universiteti i Shkencave të zbatuara të Karlsruhe, Fakulteti i Gjeomatikës (Jäger, 1999), në Gjermani, me të cilin janë kryer të gjitha llogaritjet për përcaktimin e sipërfaqes referente të lartësive të Shqipërisë. Pjesë përbërëse e këtij softeri janë 5 (pesë) modele globale gjeopotenciale EGM96, EGG97, EGM2008, EIGEN04 dhe EIGEN6c4.

